



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 161 Akti**

**Nr. 196 Vendimi  
Tiranë, më 13.9.2019**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Xhensila Pine</b>	Kryesues
<b>Olsi Komici</b>	Relator
<b>Suela Zhegu</b>	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Fiorela Mandro, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 30.7.2019, ora 14:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, (underground), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Gjovalin Përnoça**, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë.

**OBJEKTI:** Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Olsi Komici, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, z. Gjovalin Përnoca, vëzhguesin ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore publike në tërësinë e tij vlerësimin kalimtar ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Gjovalin Përnoca, i cili kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

#### I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, z. Gjovalin Përnoca, ushtron detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë dhe në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtuar rivlerësimit, *ex officio*.

Subjekti i rivlerësimit u është nënshtuar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.5.2018, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, short nga i cili rezultoi se subjekti do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 3, i përbërë nga komisionerët Xhensila Pine, Suela Zhegu dhe Olsi Komici. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioneri Olsi Komici.

Me vendimin nr. 2, datë 6.6.2019, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Gjovalin Përnoca, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe rivlerësimin e aftësisë profesionale, si dhe caktoi kryesuesin e trupit gjykues, komisioneren Xhensila Pine. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes.

Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Theo Jacobs.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” në Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Grupi i Punës në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Këto raporte janë administruar nga relatori në fillim të procesit të hetimit administrativ.

ILDKPKI-ja, pasi ka kryer procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar<sup>1</sup>, duke konkluduar se:

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë ndër vite;
- ka kryer fshehje të pasurisë;
- ka kryer deklarim të rremë;

---

<sup>1</sup>Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.1.2018, të përbërë nga 18 fletë, është dërguar raporti i ILDKPKI-së, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016.

➤ *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar<sup>2</sup>, duke konkluduar mbi *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit, z. Gjovalin Përnoça.*

Grupi i Punës në Këshillin e Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, si dhe pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar<sup>3</sup> mbi subjektin e rivlerësimit.

Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenin 14, të ligjit nr. 84/2016.

Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, në datën 8.7.2019, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Gjovalin Përnoça, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 8.7.2019, mbi përbërjen e trupit gjykues, mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/sqarime shtesë, apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e përfutura nga hetimi kryesisht i zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

Në datën 17.7.2019, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar zgjatje të afatit me qëllim përgatitjen e një mbrojtje të mirë dhe grumbullimin e provave të nevojshme. Trupi gjykues ka pranuar kërkesën e subjektit duke vendosur zgjatjen e afatit deri në datën 26.7.2019

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë në rrugë elektronike, në datën 29.7.2019.

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në datën 30.7.2019, ora 14:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs.

Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht dhe i shoqëruar nga përfaqësuesi i tij ligjor, av. S.A. Në fillim të seancës, subjekti i rivlerësimit parashitroi se përsëri koha e lënë në dispozicion nga trupi gjykues nuk ishte e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen, si dhe për

---

<sup>2</sup>Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 31.10.2017, dërgohet raporti i DSIK-së për subjektin e rivlerësimit në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016.

<sup>3</sup>Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.02.2019, dërgohet raporti i Grupit të Punës pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

të siguruar prova nga institucione të treta. Trupi gjykues vendosi ndërprerjen e seancës dëgjimore dhe rifillimin e saj në datën 10.9.2019. Në seancën dëgjimore subjekti i rivlerësimit parashtrij shpjegimet e tij, si dhe i depozitoi ato me shkrim në Komision.

Në përfundim, subjekti i rivlerësimit, z. Gjovalin Përnoca, kërkoi konfirmimin në detyrë.

### **III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

Z. Gjovalin Përnoca, ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Subjekti ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

### **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Për subjektin e rivlerësimit, z. Gjovalin Përnoca, bazuar në nenin 179/b, në nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit përfshin të tria kriteret e vlerësimit: vlerësimin e pasurisë; kontrollin i e figurës; dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

Pavarësisht se në kreun IV të ligjit nr. 84/2016 2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të kryer vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me këtë vlerësim pasuror, referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetues dhe kreut II të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

#### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

##### **A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.5.2018, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Gjovalin Përnoca, i cili është subjekt deklarues në ILDKPKI që prej vitit 2003, me numër indeksi \*\*\*, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave private nga viti 2003 deri në vitin 2016 dhe, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë - shtojca 2 në datën

30.1.2017. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për çdo aset të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ILDKPKI-ja ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

## **A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

Bazuar në ligjin nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të kontrollit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij. Referuar neneve 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- b) deklaratën e pasurisë - shtojca 2 dhe deklaratat periodike të pasurisë ndër vite;
- c) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI;
- ç) provat shkresore/dokumentet, të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, si nga: Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, Banka e Shqipërisë dhe të gjitha bankat e nivelit të dytë, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, drejtoritë rajonale të tatimeve, Qendra Kombëtare e Biznesit, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., shoqëria “Ujësjellës-Kanalizime” sh.a., zyra noteriale dhe Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore etj.;
- d) deklarime dhe prova të dërguara nga subjekti i rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- e) shpjegimet me shkrim të subjektit, si dhe shpjegimet në seancën dëgjimore.

Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, si dhe të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të pasurive në pronësi apo përdorim; dhe (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë situatë konflikti interesi, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016.

Në lidhje me dorëzimin e deklaratës së pasurisë - shtojca 2, në zbatim të nenit 31/1<sup>4</sup>, rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Gjovalin Përnoca, e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë (duke përfshirë edhe personat e lidhur me të), në bazë të ligjit nr. 84/2016, datë 30.1.2017, brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi.

---

<sup>4</sup> Subjekti i rivlerësimit ka detyrim të plotësojë deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon atë në ILDKPKI.

## Pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë - shtojca 2

1. **Apartament dhe dy garazhe blerë në bashkëpronësi me z. A.G.**, sipas kontratës së porosisë, datë 31.12.2005, me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., z. P.F., për vlerën 49.860 euro të cilat janë likjuar po atë ditë nga z. G. Apartamenti në të cilin subjekti jeton që nga viti 2008 është regjistruar në ZVRPP-në Tiranë me certifikatë provizore datë 2.10.2016. Vlera: 49.860 euro. Pjesa takuese: 50 %.

Burimi i krijimit: pagesë totale e apartamentit nga z. A.G. (në formë huaje), i cili më pas hoqi dorë, duke e lënë subjektin porositës të vetëm.

### Hetimi i kryer nga Komisioni

Komisioni ka kryer korrespondencë me ZVRPP-në Tiranë, QKB-në dhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve Tiranë<sup>5</sup>.

**ZVRPP-ja Tiranë**, konfirmon se në emër të subjektit të rivlerësimit, z. Gjovalin Përnoca, rezultojnë të regjistruara:

- Pasuria e llojit apartament, me sip. 108.4 m<sup>2</sup>, e regjistruar me numër pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, dhe me sip. 108.4 m<sup>2</sup>, kati i \*\*\*, sipas shënimeve në kartelën e pasurisë.
- Dy garazhe me sip. 19.2 m<sup>2</sup>, secili, me numër pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, dhe numër \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*.

Këto pasuri janë përfituar nga kontrata e sipërmarrjes.

Kontrata e sipërmarrjes<sup>6</sup> e datës 31.12.2005 është lidhur me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe me porositës A.G. dhe Gjovalin Përnoca. Objekt i kësaj kontrate është ndërtimi i një apartamenti me sip. 119.6 m<sup>2</sup>, kati i \*\*\*, përkundrejt çmimit 41.800 euro, si dhe dy garazhe në katet nëntokë me nr. \*\*\* dhe \*\*\*, për çmimin 8.000 euro, në adresën Rr. \*\*\*.

Në pikën 3 të kontratës së sipërmarrjes “mënyra e pagesës” deklarohet se: *“Pagesa për vlerën e apartamentit dhe garazhit objekt i kësaj kontrate është likuiduar krejtësisht nga porositësit dhe se pala sipërmarrëse i ka marrë të gjitha lekët jashtë kësaj zyre”*.

Pagesa konfirmohet me mandatarkëtimin nr. \*\*\*, datë 31.12.2005, ku është pasqyruar se nga z. A.G. është arkëtuar shuma 49.860 euro me përshkrimin “*për apartament, kati \*\*\*, objekti \*\*\* - katësh + garazh*”, për shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k.

Subjekti ka depozituar edhe certifikatën provizore të pronësisë lëshuar nga ZVRPP-ja Tiranë, datë 2.10.2006, për apartamentin me sip. 133 m<sup>2</sup>, kati i \*\*\*, në emër të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

Kalimi i pronësisë për apartamentin me sip. 108.40 m<sup>2</sup> është finalizuar me kontratën e shitblerjes me nr. \*\*\*, datë 7.6.2017, me shitës shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe me blerës Gjovalin Përnoca përkundrejt çmimit 41.860 euro.

<sup>5</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 11.1.2019, e ZVRPP-së Tiranë drejtuar Komisionit; shkresa nr. \*\*\* prot., datë 23.5.2019, e QKB-së; shkresa nr. \*\*\* prot., datë 23.5.2019, e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

<sup>6</sup> Kontratë e depozituar nga subjekti.

Kalimi i pronësisë për dy garazhet me sip. 19.20 m<sup>2</sup> secili, është finalizuar me kontratën e shitblerjes me nr. \*\*\*, datë 14.11.2017, me palë shitëse shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe blerës Gjovalin Përnoca, për çmimin 4.000 euro secili.

Me deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 5.4.2006, z. A.G., deklaroi ndër të tjera se ka paguar shumën prej 49.860 euro sipas mandatit të sipërpërmendur, dhe se: “*Sot, më datë 24.3.2006, heq dorë plotësisht nga kontrata e sipërmarrjes, duke ia kaluar të gjitha të drejtat dhe detyrimet mbi këto pasuri, z. Gjovalin Përnoca*”.

Gjithashtu, z. A.G., deklaroi se: “*... sot mora në praninë e noteres shumën prej 15.000 euro, dhe diferenca tjetër do të likuidohet me pjesë sipas mundësisë nga z. Gjovalin Përnoca, por jo më vonë se momenti i marrjes së çelësave në dorë*”, ndërkohë që, z. Gjovalin Përnoca, ka shprehur dakordësinë në lidhje me këtë deklaram.

Me deklaratën noteriale datë 31.1.2007<sup>7</sup>, z. A.G., deklaroi ndër të tjera se sasia tjetër e të hollave, në vlerën prej 34.860 euro, i është likuiduar nga z. Gjovalin Përnoca, pjesë-pjesë ku kësti i fundit është likuiduar në dhjetor të vitit 2006 jashtë kësaj zyre.

Komisioni ka hetuar dhe njëkohësisht i ka kërkuar subjektit të provojë me dokumentacion ligjor aftësinë paguese dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave të shtetasit A.G., për pagimin e shumës 49.860 euro.

**QKB-ja**, ka konfirmuar se shtetasi A.V.G. ka rezultuar ortak, aksioner i vetëm, anëtar i këshillit mbikëqyrës dhe administrator në disa shoqëri<sup>8</sup>.

**Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë**, në përgjigje të saj, ka vënë në dispozicion informacionin në lidhje me detyrimet në kohë reale, deklaramet e tatimit mbi fitimin për vitet 2010 – 2017 dhe historikun e punësimit të personit për vitet 2012 – 2018 për shtetasin A.V.G.

Pavarësisht shumave të mëdha monetare të konstatuara si të qarkulluara në shoqëritë ku bën pjesë z. A.G., nga Komisioni nuk u konstatua shpërndarje *dividenti* apo përfitim page, deri në momentin e kryerjes së transaksionit, në mënyrë që të justifikohet aftësia paguese e këtij personi.

---

<sup>7</sup> Deklarata noteriale nr. \*\*\*, datë 31.1.2007.

<sup>8</sup> Ortak me 50 % i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me NIPT \*\*\*. Aktualisht ky subjekt figuron me statusin “pezulluar” (kjo shoqëri është krijuar datë 16.6.2017).

Ortak me 40 % i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me NIPT \*\*\*, krijuar në datën 30.4.2012.

Ka qenë aksioner i shoqërisë “\*\*\*\*” Durrës me NIPT \*\*\*, larguar në datën 12.7.2017.

Anëtar i Këshillit të Administrimit në këtë shoqëri (kjo shoqëri është krijuar në datë 20.7.2016).

Aksioner i vetëm në shoqërinë “\*\*\*\*” sh.a., me NIPT \*\*\*.

Anëtar i Këshillit Mbikëqyrës në shoqërinë “\*\*\*\*”, me NIPT \*\*\*.

Ka qenë ortak i vetëm i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., e cila aktualisht rezulton me status “çregjistruar pa likuidim” krijuar në datën 10.3.2005.

Ka qenë administrator i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me NIPT \*\*\*.

Ortak i vetëm i shoqërisë \*\*\* sh.p.k., me NIPT \*\*\*, larguar si administrator në datën 13.5.2019.

Ka qenë ortak me 50 % në shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., me NIPT \*\*\*. Është larguar nga kjo shoqëri në datën 15.1.2003, dhe si administrator në datën 27.8.2003.

Administrator dhe ortak me 50 % në shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., regjistruar në vitin 1998 për të cilën nuk u gjet NIPT.

Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit, përveç informacioneve dhe dokumenteve të tjera edhe pesë kontrata shitjeje<sup>9</sup> të datës 30.6.2003 të pasurive të paluajtshme me shitës z. A.G., me një vlerë prej 2.000.000 lekësh, për secilën kontratë, duke rezultuar me një total prej 10.000.000 lekësh.

Komisioni i ka kërkuar shpjegime, në lidhje me arsyen e porositjes së apartamentit dhe dy garazheve nga dy porositës solidarë, ku njëri prej tyre është vetë subjekti: përse z. A.G. bëri pagesën e të gjithë vlerës së apartamentit dhe të garazheve dhe më pas hoqi dorë thujse menjëherë nga këto pasuri; cili është burimi i krijimit të vlerës 15.000 euro e paguar në datën 24.3.2006 dhe e vlerës 34.860 euro paguar pjesë-pjesë, si dhe këstin e fundit të paguar në dhjetor të vitit 2006 nga z. A.G.

Gjithashtu, subjekti i është kërkuar të dokumentojë me dokumentacion justifikues ligjor dy shumat e paguara nga z. A.G., si dhe të shpjegojë se në ç'rrethana është njohur me të.

Subjekti në përgjigje të tij ka deklaruar se për pikën (a) ka deklaruar se: “... z. A.G. më kishte premtuar që të më shiste një banesë në atë pallat dhe do të më priste që ta paguaja me këste. Në fund të vitit 2005, ai dhe ish-ortaku i tij në firmën e ndërtimit, z. P.F., kishin përfunduar ortakërinë dhe kishin ndarë edhe pasuritë e tyre, mes tyre edhe banesat e përfunduara dhe në proces. Banesa në fjalë kishte qëlluar pjesë e z. F., të cilit z. A.G. i kishte thënë që do t'ia blinte e do të ma shiste mua...”

“...banesa u ble (u bë kontrata e porosisë datë 31.12.2005) me porositës nga unë dhe A.G. sepse në momentin e përpilimit të kontratës së porosisë unë nuk kisha asnjë mundësi financiare, gjithë shumën do ta likuidonte ai dhe do më priste që ta likuidoja çmimin e banesës pjesë-pjesë duke mbetur unë pronari i vetëm i saj. Këtë veprim, z. A.G. e bëri, meqenëse më parë se të ndahej nga ortaku, (më kishte premtuar që do më shiste një banesë në atë pallat, pra për të mbajtur premtimin e tij), për të më krijuar mundësinë që ta blej këtë shtëpi me çmim të arsyeshëm dhe me mundësi pritjeje për likuidim, me qëllim që pas lidhjes së kontratës të hiqte dorë nga bashkëpronësia dhe do mbetesha pronar i vetëm i saj”.

“...në lidhje me burimin e krijimit të shumës 15.000 euro që i kam paguar z. A.G. në datën 24.3.2006 dhe të shumës prej 34.860 euro që i kam paguar në dhjetor 2006, ashtu siç janë relatuar hollësisht në deklarinimin vjetor për vitin 2005 dhe 2006, si dhe në deklarinimin e përgjithshëm të pasurisë, të vitit 2017....., por që të gjitha e kanë origjinën tek kursimet nga pagat vjetore të mia dhe bashkëshortes. Si dokumentacion ligjor kam kontratat dhe deklaratat noteriale të përmendura”.

“...me z. A.G. njihem që në vitet 2000, në rrethana që nuk i mbaj mend saktësisht, por nga shokë të përbashkët, besoj se kolegë të mi nga Shkodra, të cilët i kishin transmetuar për mua opinione pozitive. Nuk kemi frekuentim të rregullt shoqëror, pasi secili ka angazhimet e tij, por nëse shihemi ndonjëherë, ruajmë konsiderata reciproke”.

---

<sup>9</sup> Kontratë shitje nr. \*\*\*, datë 30.6.2003, për apartamentin me sip. 110 m<sup>2</sup>, në vlerën 2.000.000 lekë; kontratë shitje nr. \*\*\*, datë 30.6.2003, për apartamentin me sip. 110 m<sup>2</sup>, në vlerën 2.000.000 lekë; kontratë shitje nr. \*\*\*, datë 30.6.2003, për apartamentin me sip. 160 m<sup>2</sup>, në vlerën 2.000.000 lekë; kontratë shitje nr. \*\*\*, datë 30.6.2003, për apartamentin me sip. 136 m<sup>2</sup>, për 2.000.000 lekë; kontratë shitje nr. \*\*\*, datë 30.6.2003, për katin \*\*\* holli i hyrjes me sip. 21.5 m<sup>2</sup>, dhe katin e \*\*\* ambienti me sip. 228.2 m<sup>2</sup>, në vlerën 2.000.000 lekë.



- ✓ **Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2005 “trajtimin preferencial”<sup>10</sup> që i është bërë nga shtetasi A.G., duke i siguruar subjektit një apartament me çmim të arsyeshëm, duke e paguar vetë të gjithë çmimin e apartamentit, si dhe duke i dhënë mundësi subjektit të shlyejë çmimin e apartamentit me mundësi pritjeje për likuidimin e tij.**

Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka dhënë shpjegime se ka bindjen që e ka blerë këtë pasuri me pothuaj dyfishin e kostos reale dhe për pasojë e ka deklaruar në deklaratën e pasurisë të vitit 2005, si një kontratë të thjeshtë porosie, veprim juridik i zakonshëm, dhe jo si “trajtim preferencial që duhej deklaruar në faqen nr. \*\*\* të formularit të deklarimit të pasurisë dhe nuk duhet konsideruar as si “*fshetje e pasurisë*”, as si “*deklarim i rremë*” apo “*i pasaktë*”.

### **Në lidhje me çmimin e blerjes së apartamentit**

Udhëzimi nr. 5, datë 23.11.2005, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave, dhe të koeficientit ‘k’ për vitin 2005”, ka përcaktuar se kostoja mesatare e shitjes së apartamenteve në tregun e lirë për vitin 2005 për qytetin e Tiranës është në vlerën 77.452 lekë.

Çmimi i apartamentit i përlllogaritur sipas këtij udhëzimi rezulton të jetë  $119.6 \text{ m}^2 \times 77.452 \text{ lekë/m}^2 = 9.263.259 \text{ lekë}$ , i konvertuar me kursin e këmbimit të datës 31.12.2005 është 75.593 euro. Pra, rezulton se çmimi i blerjes së apartamentit, nga subjekti Gjovalin Përnoca, në vlerën 41.860 euro, është shumë më i ulët se çmimi mesatar i shitjes në tregun e lirë i miratuar nga Enti Kombëtar i Banesave, konkretisht rreth 33.733 euro më lirë.

### **Në lidhje me këtë konstatim subjekti ka shpjeguar:**

Së pari: pavarësisht se në kontratën e porosisë është shënuar sipërfaqja e banesës prej  $119.6 \text{ m}^2$ , në kontratën përfundimtare të shitblerjes së datës 7.6.2017, apartamenti ka sip.  $108.40 \text{ m}^2$ . Pra, me këtë sipërfaqe banesa është shitur me  $386.16 \text{ euro/m}^2$ , ose referuar kursit të euros në atë kohë (1.230 lekë) me vlerë totale  $47.500 \text{ lekë/m}^2$ .

Së dyti: konkluzioni se *çmimi i apartamentit të blerë në vlerën 41.860 euro, është shumë më i ulët se çmimi referues i miratuar nga Enti Kombëtar i Banesave*, nuk është i saktë, pasi në atë vit, nuk ka pasur çmim të referencës për shitjet e pronave, sepse çmimi i referencës i përcaktuar në vitin 2005 nuk ka qenë i zbatueshëm (udhëzimi nr. 5, datë 23.11.2005), pasi nuk ka pasur ndarje të zonave. Vetëm me udhëzimin nr. 1, datë 20.8.2008, është bërë për herë të parë ndarja e çmimit të referencës sipas zonave të qytetit të Tiranës. Gjithashtu, duhet pasur parasysh se ky ishte një çmim referues, jo i detyrueshëm për t’u zbatuar.

Së treti: subjekti është mjaftuar me bindjen se po e blen mbi koston reale të ndërtimit, kosto e cila, sipas Udhëzimit nr. 5, datë 23.11.2005, ka qenë  $28.756 \text{ lekë/m}^2$ , pra, blerja ka qenë sa dyfishi i koston së ndërtimit të kësaj banese ( $47.500 - 28.756 = 28.744 \text{ lekë}$ ), për të cilën nuk ka pasur pengesë morale apo ligjore, për më tepër që kjo ofertë nuk lidhej me asnjë lloj kompromisi me detyrën e subjektit, siç edhe është verifikuar nga Komisioni.

Së katërti: nga subjekti sipërmarrës, si nga ndërtuesi P.F., por edhe nga A.G., ka pasur edhe raste të tjera me klientë të ndryshëm të cilët të kenë bërë kontrata me çmim të ulët. Sipas

<sup>10</sup> Referuar f. \*\*\* të rubrikës “dhurata dhe trajtime preferenciale”, te deklarata periodike e vitit 2005, e cila është lënë pa u plotësuar nga subjekti.

deklaratës noteriale nr. \*\*\*, datë 24.7.2019, të z. A.G., dhe pesë kontratave bashkëlidhur rezulton se në datën 30.6.2003 ka bërë shitje për apartamente, me çmime më të ulët sesa vlera për të cilën subjekti ka blerë apartamentin, pra, rasti i subjektit nuk ishte i veçantë. Edhe nga shkresa datë 15.7.2019, e shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., të z. P.F. dhe kontratës bashkëlidhur del e njëjta gjë, se ka pasur raste që janë bërë edhe shitje me çmime të ulëta.

Së pesti: në rastet kur shuma monetare e vënë si çmim i banesës, likuidohet menjëherë, që në datën e lidhjes së kontratës, është normale që edhe çmimi të jetë më i ulët sesa kur likuidohet me këste derisa të përfundojë objekti. Për ilustrim, edhe Enti i Banesave, me akte nënligjore, bënte zbritje të 30 % të çmimit në rast të likuidimit të menjëhershëm. Me këtë logjikë, që duhet pranuar, pasi funksionon si në shtet edhe në privat dhe është parim i përbotshëm në tregti, i bie që realisht apartamenti i subjektit përlllogaritet si i marrë me çmimin prej  $41.860 + 30\% = 54.418$  euro, pjesëtuar me sip.  $108.40 \text{ m}^2 = 502 \text{ euro/m}^2$ , ose e kthyer në lekë ( $502 \times 1.230$ ) =  $61.747 \text{ lekë/m}^2$ , pra, një çmim jo i ulët.

Së gjashti: apartamenti në momentin e blerjes nuk ka pasur certifikatë pronësie. Duke nënshkruar vetëm kontratën e sipërmarrjes, subjekti e ka nënshkruar kontratën e shitjes në qershor të vitit 2017, pas 12 vjetësh nga momenti i porosisë. Për gjithë këtë periudhë 12-vjeçare, nga subjekti nuk ka qenë e mundur që ta trajtojë këtë pronë si kapital dhe nuk ka pasur mundësi që të kreditohej nga banka (për shkak të mungesës së pronësisë), si dhe nuk ka mundur ta shesë me çmim tregu, zgjidhje kjo e marrë fund vetëm pas ndryshimeve ligjore të vitit 2017, kur sot askush nuk hyn në transaksion për blerjen e pasurive të paluajtshme në rast se pasuria nuk ka dokument pronësie.

Komisioni, në lidhje me argumentet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, sqaron se:

- Pavarësisht se kontrata e shitblerjes është lidhur për apartamentin me sipërfaqe prej  $108.40 \text{ m}^2$ , është fakt se kontrata e sipërmarrjes datë 31.12.2005, është lidhur për apartamentin me sipërfaqe  $119.6 \text{ m}^2$  dhe çmimi i blerjes prej  $41.860$  euro, sipas mandatarkëtimit nr. \*\*\*, datë 31.12.2005, për sipërfaqen  $119.6 \text{ m}^2$ .
- Subjekti në mënyrë të gabuar i referohet krahasimit të çmimit të blerjes së apartamentit me vlerën e kostos së ndërtimit pasqyruar në Udhëzimin nr. 5, datë 23.11.2005, të Këshillit të Ministrave, që është  $28.842 \text{ lekë/m}^2$  (çmimi për njësi për sipërfaqe shfrytëzimi), për arsye se nuk kemi të bëjmë me një apartament të ndërtuar nga subjekti, përkundrazi, duke marrë në konsideratë të dhënat në lidhje me çmimet në tregun e lirë të apartamenteve të përcaktuara në këtë udhëzim, konstatohet se për qytetin e Tiranës çmimi mesatar i shitjes të jetë  $77.452 \text{ lekë/m}^2$ , dhe vlera totale e apartamentit të jetë  $119.6 \text{ m}^2 \times 77.452 \text{ lekë/m}^2 = 9.263.259$  lekë, e konvertuar me kursin e këmbimit të datës 31.12.2005 është  $75.593$  euro, vlerë kjo dukshëm më e lartë krahasuar me çmimin e blerjes së apartamentit prej  $41.860$  euro, pasqyruar në kontratën e sipërmarrjes datë 31.12.2005.
- Në lidhje me argumentin e dhënë nga subjekti, se si shtetasi A.G., ashtu edhe P.F. kanë kryer shitje apartamentesh me një çmim edhe më të vogël se çmimi i blerjes së apartamentit nga subjekti, duke vënë në dispozicion të Komisionit kontrata shitblerje, sqarojmë se subjekti nuk ka vënë në dispozicion të Komisionit kontratat fillestare përkatëse të porosisë në mënyrë që të evidentohet dhe analizohet çmimi fillestar real në momentin e kryerjes së porosisë.

- Argumentimi i dhënë nga subjekti se pagimi i menjëhershëm i çmimit të kontratës ka sjellë dhe aplikimin e një çmimi më të ulët sesa në rast se pagesa do të kryhej me këste, duke bërë analogji me legjislacionin që aplikohet nga Enti Kombëtar i Banesave, nuk mund të merret në konsideratë për arsye se për subjektet që trajtohen në bazë të legjislacionit që operon EKB-ja, aplikohen kritere shumë lehtësuese dhe favorizuese krahasuar me subjekte të tjera të së drejtës që operojnë si shitës apo blerës në tregun e lirë të shitblerjes së pasurive të paluajtshme.

Komisioni ka hetuar në lidhje me ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit me subjektet<sup>11/12</sup> me të cilët ka pasur marrëdhënie të ndryshme pasurore, duke përfshirë shtetasin P.F. dhe A.G., si dhe për shoqëritë ku kanë qenë ortakë, administratorë etj., dhe nga hetimi nuk ka rezultuar ndonjë situatë e tillë.

Komisioni, gjithashtu ka konstatuar mospërputhje për sa i përket sipërfaqes së apartamentit, katit në të cilin ndodhet dhe numri i apartamentit, si më poshtë:

Dokumenti	Sipërfaqja m <sup>2</sup>	Kati i apartamentit	Numri i apartamentit
Kontrata sipërmarrje, datë 31.12.2005	119.6 m <sup>2</sup>	***	Nuk është shënuar
Kontrata e shitjes, datë 7.6.2017	108.40 m <sup>2</sup>	----	***
Certifikata provizore, datë 2.10.2006	133 m <sup>2</sup>	***	***
ZVRPP Tiranë	108.40 m <sup>2</sup>	***	***

Subjekti në shpjegimet e tij ka argumentuar se mospërputhjet nuk janë përgjegjësia e tij, pasi këto dokumente nuk janë prodhuar prej tij, megjithatë, pas verifikimit nga ZVRPP-ja Tiranë është regjistruar sipërfaqja e saktë, prej 108.40 m<sup>2</sup>.

### **Burimi i krijimit të shumës 15.000 euro dhe 34.860 euro paguar nga subjekti Gjovalin Përnoça shtetasit A.G. në vitin 2006.**

Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar si burim krijimi për blerjen e apartamentit kursimet e akumuluar dhe të ardhurat e vitit 2006.

Komisioni ka analizuar mundësinë financiare në momentin e blerjes së apartamentit sipas burimit të krijimit të deklaruar nga subjekti.

	Përshkrim	Vlera në lekë
<b>A</b>	<b>Të ardhurat</b>	<b>7,605,543</b>
1	Likuiditete në <i>cash</i> (kursime) 31.12.2005	1,400,000
2	Likuiditete në banka (kursime) 31.12.2005	567,797

<sup>11</sup> Shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.; A.L.; Gj.L., Gj.K.; O.P.; A.G.; \*\*\* sh.a; shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k; shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.; shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.; P.F.; M.T.; Z.L. dhe N.D.

<sup>12</sup>Shkresa nr. \*\*\*prot., datë 13.5.2019, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; shkresa nr. \*\*\* prot., datë 17.5.2019, e Gjykatës së Apelit Shkodër; shkresa nr. \*\*\* prot., datë 20.5.2019, e Gjykatës së Shkallës së Parë Për Krime të Rënda.

3	Të ardhura nga shitja e apartament Golem	3,400,000
4	Të ardhura nga interesat	1,149
5	Të ardhura nga pagat subjekti	1,662,253
6	Të ardhura nga pagat bashkëshortja	574,344
<b>B</b>	<b>Pasuri</b>	<b>6,720,544</b>
1	Blerje mjeti më 20.2.2006	200,000
2	Pagesë 15,000 euro x 122.54	1,838,100
3	Pagesë 34,860 euro 31.12.2006	4,271,744
4	Likuiditete në <i>cash</i> (kursime) 31.12.2006	0
5	Likuiditete në banka (kursime) 31.12.2006	410,700
<b>C</b>	<b>Shpenzime</b>	<b>652,933</b>
1	Shpenzime jetike	547,785
2	Shpenzime udhëtimi	105,148
	<b>Mundësia financiare në momentin e blerjes së apartamentit (A-B-C)</b>	<b>232,066</b>

Në total, subjekti ka pasur në dispozicion shumën 7.605,543 lekë, nga të cilat 1.400.000 lekë kursime *cash* dhe 567.797 lekë kursime në bankë të akumuluar në vitin 2005 dhe 5.637.746 lekë të ardhura të krijuara gjatë vitit 2006.

Subjekti, me shumën prej 7.603.543 lekësh, ka kryer pagesat për blerjen e apartamentit në shumat 15.000 dhe 34.860 euro, ka blerë automjetin, ka krijuar likuiditetet në bankë, si dhe ka paguar shpenzimet e udhëtimit dhe ato jetike, duke rezultuar me mundësi financiare në momentin e shlyerjes përfundimtare të apartamentit në shumën +232,066 lekë.

Komisioni ka analizuar mundësinë e krijimit të kursimeve të akumuluar në vitin 2005.

Nga analiza e vitit 2005 subjekti rezultoi me pamjaftueshmëri burimesh financiare të ligjshme për të mbuluar shpenzimet, krijuar pasurinë dhe kursimet në shumën – 385.951 lekë.

<b>Përshkrimi</b>	<b>2005</b>
<b>Të ardhurat</b>	<b>2,697,947</b>
Të ardhura nga paga e subjektit	1,510,634
Të ardhura nga paga bashkëshortes	783,182
Të ardhura nga interesat	4,131
Të ardhura nga shitja e makinës	400,000
<b>Detyrime</b>	<b>0</b>
<b>Shpenzime</b>	<b>743,849</b>
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI -së	547,785
Shpenzime udhëtimi	196,064
<b>Pasuri</b>	<b>2,340,049</b>
Likuiditete (kursime)	440,049
Apartament Golem 1+1	1,900,000
<b>Të ardhura + detyrime - shpenzime – pasuri</b>	<b>-385,951</b>

Kjo do të thotë se subjekti ka përdorur si burim krijimi për blerjen e apartamentit, kursimet e akumuluar në vitin 2005, të cilat janë krijuar me të ardhura jo të ligjshme në vlerën - 385.951 lekë.

Me kursimet e deklaruara nga subjekti dhe të ardhurat e vitit 2006, mundësia financiare në momentin e blerjes së apartamentit rezulton në vlerën + 232,066 lekë. Duke qenë se nga kursimet e akumuluar, vlera prej 385,951 lekësh janë më të ardhura jo të ligjshme, mundësia financiare me burime të ligjshme për blerjen e apartamentit është -153.885 lekë (232.066 - 385.951).

Subjekti nuk ka pasur burime të ligjshme në vlerën -153.885 lekë për blerjen e apartamentit.

**Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka kundërshtuar analizën financiare të vitit 2005, duke argumentuar se:**

1. Për pagesat e kryera prej tij në monedhë të huaj duhet marrë në konsideratë kursi i këmbimit në datën e blerjes së pasurisë 1USD = 100,45 lekë;
2. Duhet rillogaritur të ardhurat nga interesat e depozitës në vlerën 12.000 USD.

Komisioni ka marrë në konsideratë pretendimet e subjektit në lidhje me kursin e këmbimit dhe rillogaritjen e të ardhurave nga interesat e depozitës duke pasqyruar ndryshimet përkatëse në analizën financiare të ripunuar për vitin 2005.

3. Subjekti ka pretenduar përfshirjen në analizën financiare të të ardhurave nga paga e bashkëshortes pranë shoqërisë “\*\*\*\*” në shumën 270.000 lekë, duke vënë në dispozicion të Komisionit vërtetim nga shoqëria për përfitimin e shumës 270.000 lekë nga bashkëshortja e tij. Në lidhje me këto të ardhura nuk konfirmohet si nga shoqëria ashtu edhe nga subjekti pagesa e tatimit mbi të ardhurat referuar ligjit nr. 8438 “Për tatimin mbi të ardhurat personale”.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit pas dërgimit të rezultateve të hetimit, arrin në konkluzionin se kjo e ardhur nuk është e ligjshme sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, pasi nuk provohet pagesa e tatimit mbi të ardhurat.

Komisioni, pasi vlerësoi pretendimet e subjektit, i reflektoi ato në analizën financiare të vitit 2005.

<b>Përshkrimi</b>	<b>2005</b>
<b>Të ardhurat</b>	<b>2,794,096</b>
Të ardhura nga paga e subjektit	1,510,634
Të ardhura nga paga bashkëshortes	783,182
Të ardhura nga interesat	12,230
Të ardhura nga shitja e makinës	400,000
Të ardhura nga kursi i këmbimit	88,050
<b>Detyrime</b>	<b>0</b>
<b>Shpenzime</b>	<b>682,579</b>
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI -së	547,785
Shpenzime jetese për diferencë deklaruar nga subjekti	0
Shpenzime udhëtimi	134,794

<b>Pasuri</b>	<b>2,340,049</b>
Likuiditete	440,049
Apartament, Golem 1+1	1,900,000
<b>Të ardhura + detyrime - shpenzime – pasuri</b>	<b>-228,532</b>

## Konkluzion

Komisioni, në lidhje me sipërfaqjen dhe me numrin e katit të apartamentit, bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga institucionet shtetërore, deklarimet, si dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion nga subjekti, i gjen deklarimet e subjektit të bazuara dhe të mjaftueshme.

Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2005 një “trajtimin preferencial”<sup>13</sup> që i është bërë nga shtetasi A.G. i cili i ka siguruar subjektit një apartament me çmim të favorshëm<sup>14</sup>, duke paguar fillimisht personalisht të gjithë çmimin e apartamentit megjithëse ishte bashkporositës me subjektin e rivlerësimit, duke i dhënë subjektit si mundësi shlyerjen e çmimit të apartamentit, me mundësi pritjeje për likuidimin, duke qënë kështu në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016.

Komisioni, bazuar në dokumentacionin e administruar dhe në udhëzimin e EKB-së, vlerëson se çmimi i blerjes së apartamentit deklaruar nga subjekti dhe i pasqyruar në kontratën e sipërmarrjes të datës 31.12.2005, në vlerën 41.860 euro, nuk është çmimi real i blerjes së apartamentit nga subjekti, për arsyen se ky çmim rezulton të jetë shumë më i ulët krahasuar me çmimin e referencës të pasqyruar në Udhëzimin nr. 5, datë 23.11.2005, të Këshillit të Ministrave, që rezulton i përlogaritur në vlerën 75.593 euro, çka përforcon bindjen se kemi të bëjmë me një situatë trajtimi preferencial dhe të padeklaruar nga subjekti i rivlerësimit.

Komisioni nuk ka konstatuar ndonjë situatë konflikti interesi ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe shtetasve A.G. dhe P.F., si individë apo si subjekte tregtare.

Shtetasi A.G., ka pasur të ardhura financiare të mjaftueshme dhe nga burime të ligjshme për të përballuar pagesën e vlerës prej 49.860 euro për blerjen e apartamentit + dy garazhe në vitin 2005.

Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk kanë pasur burime të mjaftueshme të ligjshme financiare për të justifikuar investimet, kursimet dhe shpenzimet e kryera për vitin 2005 duke rezultuar me balancë financiare negative në vlerën – 228.532 lekë.

Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë pasur burime të mjaftueshme të ligjshme financiare për blerjen e apartamentit në vlerën 49.860 euro në vitin 2006.

<sup>13</sup> Referuar fq. \*\*\* të rubrika “dhurata dhe trajtime preferenciale” tek deklarata periodike e pasurisë e vitit 2005 e cila është lënë pa u plotësuar nga subjekti.

<sup>14</sup> Neni 15, pika 1, germa b, e ligjit 9367, datë 7.4.2005 parashikon: “... nuk deklarohen dhurata ose trajtimi preferencial kur vlera e tyre është më e vogël se 10.000 (dhjetë mijë) lekë, si dhe kur dy e më shumë dhurata ose trajtime preferenciale, të dhëna nga i njëjti person, së bashku, nuk e kalojnë këtë vlerë, gjatë së njëjtës periudhë deklarimi”.

➤ **Apartament 1+1, i blerë në Golem për shumën 1.900.000 lekë më datë 29.7.2005 dhe shitur më datë 9.2.2006 në shumën 3.400.000 lekë.**

Burimi i krijimit i deklaruar në deklaratën “Vetting”: kursimet para e gjatë vitit 2004 dhe nga shitja e automjetit tip “Mercedez Benz”, me targa \*\*\*, për vlerën 200.000 lekë.

**Hetim i kryer nga Komisioni**

ZVRPP-ja Kavajë<sup>15</sup> konfirmon blerjen e apartamentit nga bashkëshortja e subjektit, znj. A.P., shtetasve S. dhe I.K. me kontratën e shitblerjes, si më lart për çmimin 1.900.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

Në deklaratën periodike të pasurisë së vitit 2005 subjekti ka deklaruar: *“Blerje e një apartamenti me sip. 58 m<sup>2</sup> 1+1 në Golem, Kavajë, kontrata nr. \*\*\*, datë 29.7.2005, në vlerën 1,900,000 lekë, e regjistruar në ZVRPP-në Kavajë”*.

Subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit.

Udhëzimi nr. 5, datë 23.11.2005, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banësive dhe koeficientit ‘K’ për vitin 2005”, në tabelën nr. 2 të “të dhënat në tregun e lirë të apartamenteve” ka përcaktuar se për qytetin e Kavajës, kosto e shitjes lekë/m<sup>2</sup> sipërfaqe shfrytëzimi për tregun e lirë është 42.037 lekë/m<sup>2</sup>. Sipas këtij udhëzimi, vlera e këtij apartamenti, rezulton të jetë 58 m<sup>2</sup> x 42.037 lekë/m<sup>2</sup> = 2.438.146 lekë.

Rezulton që apartamenti të jetë blerë në vlerën 538.146 lekë (2.438.146 lekë – 1.900.000 lekë = 538.146 lekë), më lirë se çmimi i tregut i përcaktuar në Udhëzimin nr. 5, datë 23.11.2005, të Këshillit të Ministrave, diferencë kjo e konsiderueshme në raport me vlerën totale të blerjes së apartamentit.

Me kontratën e shitblerjes të datës 9.2.2006, shitësit A. dhe Gjovalin Përnoca ia shesin apartamentin blerësit N.D. për çmimin 3.400.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

Udhëzimi nr. 5, datë 7.9.2006, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banësive dhe koeficientit ‘K’ për vitin 2005”, në tabelën nr. 2 të “Të dhënat në tregun e lirë të apartamenteve” ka përcaktuar se për qytetin e Kavajës, kosto e shitjes lekë/m<sup>2</sup>, sipërfaqe shfrytëzimi për tregun e lirë është 48.738 lekë/m<sup>2</sup>.

Sipas këtij udhëzimi, vlera e apartamentit rezulton të jetë 58 m<sup>2</sup> x 48.738 lekë/m<sup>2</sup> = 2.826.804 lekë.

Nga njëra anë rezulton që apartamenti të jetë shitur nga subjekti dhe personi i lidhur në vlerën 573.196 lekë (3.400.000 lekë – 2.826.804 lekë = 573.196 lekë), më shtrenjtë se çmimi i përcaktuar në udhëzimin e mësipërm dhe nga ana tjetër rezulton që të jetë shitur për vlerën 1.500.000 lekë më shtrenjtë se çmimi i blerjes (blerë për 1.900.000 lekë), brenda pothuaj 7 muajve, një çmim pothuajse dy herë më i lartë se çmimi i blerjes brenda një periudhe shumë të shkurtër kohore nga data e blerjes.

Si në procesin e blerjes së apartamentit ashtu edhe në atë të shitjes, veprimet financiare janë kryer jashtë zyrës noteriale dhe nuk është provuar kryerja e tyre me ndonjë dokument tjetër justifikues ligjor.

<sup>15</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot, datë 7. 1. 2019, e ZVRPP-së Kavajë.

Referuar kartelës së pasurisë së paluajtshme të lëshuar për këtë apartament nga ZVRPP-ja Kavajë, rezulton se:

- shtetasit S.dhe I.K., i kanë shitur këtë apartament znj. A.P. me çmimin 1.900.000 lekë, regjistruar në datën 16.9.2005;
- znj. A.P. dhe subjekti ia kanë shitur apartamentin z. N.D. për çmimin 3.400.000 lekë me kontratën e shitblerjes, datë 9.2.2006, me datë regjistrimi 16.3.2006;
- z. N.D. ua ka shitur apartamentin e mësipërm blerësve P. dhe S.S. për çmimin 1.950.000 lekë, me datë regjistrimi në ZVRPP-në Kavajë, datë 5.9.2006.

Konstatohet që blerësi N.D. e ka blerë apartamentin për çmimin 3.400.000 lekë nga znj. A.P., në datën 9.2.2006 dhe pas 6 muajve e ka shitur këtë apartament për çmimin 1.950.000 lekë, duke humbur kështu brenda 6 muajve shumën prej 1.450.000 lekë.

Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit në lidhje me rrethanat e njohjes dhe lidhjet që ka me shtetasin N.D., si dhe arsyen e blerjes së apartamentit me vlerë 1.900.000 lekë dhe pas 5 muajsh u shit për vlerën 3.400.000 lekë dhe më pas, pas 5 muajsh blerësi e shet me vlerë 1.950.000 lekë (pra, me humbje në shumën 1.450.000 lekë).

Subjekti ka shpjeguar se shtetasin N.D. e njeh për shkak se janë rritur të dy në qytetin e Kukësit, .... dhe se *nuk ka pasur kurrë kontakte pune me të....*

Në lidhje me çmimin e blerjes dhe shitjen e banesës në plazhin e Malit të Robit, subjekti ka shpjeguar se: *“... është blerë për nevojat e pushimit të familjes, me një çmim shumë të favorshëm për shkak të njohjes me shitësin, shtetasin H.K.*

*Banesës i janë bërë përmirësime, pajisje me mobilje të përdorura e të lira, .... Këto punime, (të cilat janë më shumë punë njerëzore sesa shpenzime), i kam pasur parasysh në shpenzimet e vitit 2005, si dhe i kam përmendur dhe llogaritur edhe në deklarimin vjetor të pasurisë të vitit 2006, (fq. \*\*\*), ku arsyetoj se me kontratën nr. \*\*\*, datë 9.2.2006, shtëpia u shit bashkë me pajisjet dhe orenditë. Prandaj, diferenca midis blerjes dhe shitjes është për shkak të çmimit të favorshëm të blerjes, përmirësimeve dhe pajisjes elementare, prej faktit se blerësit i pëlqeu objekti, si dhe tendencës së kohës, kur kushdo që kishte mundësi, donte të kishte një shtëpi në plazh. Arsyen se përse z. N.D. e ka shitur më vonë këtë banesë dhe më lirë nga sa e ka blerë, këtë nuk mund ta di, pasi nuk kam mbajtur lidhje me të....”.*

Në lidhje me provueshmërinë, me dokumentacion justifikues ligjor të shpenzimeve që subjekti dhe bashkëshortja kanë bërë tek apartamenti në Golem, përmirësime të cilat i kanë rritur vlerën dhe që u shit me çmimin 3.400.000 lekë, subjekti ka shpjeguar se: *“....diferenca midis blerjes dhe shitjes është: për shkak të çmimit të favorshëm të blerjes, por pa pajisje, nga përmirësime të brendshme të banesës, nga vlera e mobileve dhe pajisjeve, nga fakti se blerësit i pëlqeu banesa, nga tendenca e kohës, që kush kishte mundësi, e blinte një shtëpi në plazh.*

*Lidhur me vlerën e shpenzimeve, pas kaq vitesh, nuk mund të jem i saktë për të detajuar shpenzimet e bëra dhe vlerat për përmirësimin e banesës, si dhe nuk është mbajtur dokumentacioni ligjor justifikues i shpenzimeve që kam bërë për këtë shtëpi, pasi këto nuk i kam bërë me ndonjë firmë ndërtimi, por me njerëz të afërt dhe ndonjë usta, por edhe sipas konceptit të ligjit “Për deklarimin e pasurive” ....nuk ka qenë detyrim që të deklarojmë shpenzime etj...”*



➤ **Analizë financiare e kursimeve, të deklaruara si burim krijimi për pasurinë e apartamentit të ndodhur në Golem.**

Në deklaratën periodike vjetore të pasurisë së vitit 2005, subjekti nuk ka deklaruar burim krijimi të ardhurash për blerjen e apartamentit në Golem.

Në deklaratën “Vetting”, subjekti nuk ka deklaruar në mënyrë të specifikuar burimin e krijimit të të ardhurave, por ka llogaritur mundësinë financiare për blerjen e shtëpisë, duke marrë në konsideratë kursimet dhe të ardhurat e vitit.

Në tabelën e mëposhtme është analizuar mundësia financiare e subjektit në momentin e krijimit të pasurisë (blerja e apartamentit në Golem), sipas sqarimeve të dhëna prej tij në lidhje me burimet e përdorura për krijimin e kësaj pasurie:

	<b>Përshkrim</b>	<b>Vlera në lekë</b>
<b>A</b>	<b>Të ardhurat</b>	<b>2,883,994</b>
1	Likuiditete në <i>cash</i> (3,000 USD) 1.1.2005	283,740
2	Likuiditete në bankë (12,000 USD) 1.1.2005	1,135,562
3	Likuiditete në bankë lekë, datë 1.1.2005	108,446
4	Të ardhura nga shitja e mjetit, datë 24. 6.2005	200,000
5	Të ardhura nga paga subjekti, datë 31.7.2005	888,805
6	Të ardhura nga pagat bashkëshortja, datë 31.7.2005	267,441
<b>B</b>	<b>Pasuri</b>	<b>2,223,396</b>
1	Blerje apartamenti në Golem më 29.7.2005	1,900,000
2	Likuiditete në bankë më 31.7.2005	323,396
<b>C</b>	<b>Shpenzime</b>	<b>464,138</b>
1	Shpenzime jetike për 7 muaj, më 31.7.2005	319,541
2	Shpenzime <i>TIMS</i> , 31.7.2005	144,597
3	<b>Mundësia financiare në momentin e blerjes së apartamentit (A-B-C)</b>	<b>196,460</b>

Komisioni ka analizuar ligjshmërinë e burimeve financiare të përdorura për blerjen e kësaj pasurie.

Likuiditetet në bankë në shumën prej 12.000 USD të deklaruara nga subjekti në deklaratën periodike të vitit 2004, kanë si burim kursimet e deklaruara në vitin 2003 në shumën 15.000 USD.

Në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, subjekti ka deklaruar se kursimet prej 15.000 USD kanë si burim kursimet ndër vite.

Komisioni ka analizuar mundësinë e subjektit dhe të personit të lidhur me të për të krijuar kursime për periudhën 1982 – 2002.

<b>Data</b>	<b>Përshkrim</b>	<b>Vlera</b>
	Të ardhurat nga pagat 1982 –1997	1 129 345

20.12.1993	Blerje banese Rrëshen	-28 214
	Shpenzime jetike 1982-1997	-790 542
6.11.1997	Blerje banese në Shkodër	-1 248 167
	<b>Gjendja financiare në 6.11.1997</b>	<b>-937 578</b>
11.11.1997	Shitje banese në Shkodër	4 395 000
27.6.1998	Blerje shtëpi Rr. “***”	-3 150 000
	<b>Gjendja financiare në 27.6.1998</b>	<b>307 422</b>
	Të ardhurat nga pagat për 1998	497 300
	Shpenzime jetike për 1998	-260 000
7.6.1999	Shitje banese Rrëshen	750 000
	Të ardhura nga pagat për periudhën 1999 – 31.7.2002	2 563 351
	Shpenzime jetike për periudhën 1999 – 31.7.2002	-1 075 000
16.7.2002	Depozitë në Bankën Italo-Shqiptare 11.700 euro x 138.14	-1 616 238
	<b>Gjendja financiare në krijimin e depozitës 16.07.2002</b>	<b>1 166 835</b>
	Të ardhura nga pagat 1.8.2002 – 30.9.2002	204 929
	Shpenzime jetike 1.8.2002 – 30.9.2002	-50 000
20.9.2002	Depozitë në Bankën Italo-Shqiptare 3.200.000	-3 200 000
	<b>Gjendja financiare në krijimin e depozitës më 20.9.2002</b>	<b>-1 878 236</b>
	Të ardhura nga pagat 1.10.2002 – 31.12.2002	337 493
	Shpenzime jetike 1.10.2002 – 31.12.2002	-75 000
	Gjendja financiare më 31.12.2002	<b>-1 615 743</b>

Nga analiza financiare për këtë periudhë, subjekti dhe personi i lidhur me të rezultojnë me balancë financiare negative në shumën -1.615.743 lekë, duke pasur mungesë burimesh të ligjshme financiare për krijimin e kursime ndër vite (periudha 1982 – 2002), të deklaruara këto në deklaratën e pasurisë për vitin 2003.

#### **Pas kalimit të barrës së provës, subjekti:**

- Në lidhje me ekzistencën e dyshimeve për veprime fiktive për caktimin e çmimeve fiktive, të blerjes dhe të shitjes së apartamentit në Golem, ka sqaruar se...*kontrata është provë shkresore me fuqi të plotë provuese.*
- Në lidhje me çmimin e shitjes së apartamentit prej 3.400.000 lekësh, subjekti, veç argumenteve të cituara më sipër, që kanë të bëjnë me fuqinë ligjore provuese të kontratës së shitblerjes, arsyet e blerjes së këtij apartamenti, mobilimin e tij me mobilje të lira, kryerjen e punimeve me çmime të lira, shitjen e tij bashkë me mobilje, etj., argumenton se nuk është ndonjë diferencë e jashtëzakonshme si çmimi i blerjes së apartamentit prej tij në shumën 1.900.000 lekë krahasuar me çmimin e referencës sipas Udhëzimit nr. 5, datë 5.11.2005, të Këshillit të Ministrave, ashtu edhe me çmimin e shitjes pas 6 muajsh për vlerën 3.400.000 lekë, krahasuar me Udhëzimin nr. 5, datë 7.9.2006, të Këshillit të Ministrave.
- Në lidhje me mundësinë financiare për të krijuar kursimet ndër vite me burime të ligjshme financiare, Komisioni:
  - a) Në lidhje me pretendimin e subjektit, për të konsideruar si të ardhura shtesë për periudhën 1982 – 1997, të ardhurat nga paga të bashkëshortes në shumën 190.065 lekë, pasi administroi dhe analizoi dokumentacionin e vënë në dispozicion nga subjekti: (i)

librezën e punës së bashkëshortes, znj. A.P.; (ii) vërtetimin datë 23.7.2009, nga Zyra e Punësimit Mirditë; (iii) akt verifikimin për vjetërsinë në punë për periudhën 14.2.1988 – 30.9.1996 lëshuar nga DRSSH-ja Lezhë, e konsideroi të plotë dhe bindës dhe për rrjedhojë pranoi pretendimet e subjektit për sa më lart.

a/1 Në lidhje me pretendimin e subjektit për të marrë në konsideratë të ardhurat në shumën 90.000 lekë nga dietat e përfituara për një periudhë 6-mujore, sipas VKM-së nr. 549, datë 7.11.1994, duke qenë se ishte emëruar në një rreth tjetër jashtë vendbanimit dhe pa strehim (si provë për pretendimin e tij ka vënë në dispozicion të Komisionit deklaratën e lëshuar nga z. N.M. (M.) në atë kohë, Drejtor i Drejtorisë Ekonomike të Ministrisë së Drejtësisë), Komisioni nuk e mori në konsideratë këtë pretendim në respektim të standardit të vendosur nga Kolegji i Apelit me vendimin nr. \*\*\*, datë 5.4.2019, duke vlerësuar se dieta është një e ardhur e cila referuar qëllimit për të cilin jepet (për shpenzime jetike thelbësore), nuk mund të kursehet.

- b) Në lidhje me pretendimin e subjektit për llogaritjen e shpenzimeve jetike në vlerën 395.823 lekë dhe jo 790.542 lekë, Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, i gjen të pabazuara dhe për këtë arsye nuk u morën në konsideratë.
- c) Në lidhje me huan e marrë të vëllait në shumën 200.000 lekë<sup>16</sup> në nëntor të vitit 1997, dokumentuar me deklaratën noteriale të datës 24.7.2019 dhe e deklaruar nga subjekti si e kthyer në datën 30.11.1997, Komisioni, pasi administroi provat e depozituara nga subjekti, i konsideroi të mjaftueshme duke pranuar pretendimin e tij. Komisioni, pasi administroi provat e depozituara nga subjekti si: vërtetim page<sup>17</sup> dhe asistencë<sup>18</sup> për z. V.P.; vërtetim asistence dhe raport të lindjes për bashkëshorten e tij<sup>19</sup>; dokumentacionin provues ligjor për ushtrimin e aktivitetit “\*\*\*”; dhe se autoshkolla “\*\*\*” ka pasur të regjistruar për pajisjen me leje drejtimi 562 kursantë për periudhën 1996 –1999, por nuk konfirmohet pagesa e tatimit për të ardhurat e krijuara, kontratën e shitjes<sup>20</sup> së apartamentit, i konsideroi ato të mjaftueshme duke pranuar pretendimin e tij.
- ç) Në lidhje me shumën prej 2.400 USD, të pretenduar të kursyer nga subjekti në vitin 1993 nga trajnimi njëmuor në SHBA, si burim i ligjshëm të ardhurash, subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit programin e vizitës në SHBA dhe tri vërtetime<sup>21</sup> të kolegëve pjesëmarrës, në të cilat deklarohet për mundësinë e kursimit të shumës prej 2.400 USD. Subjekti ka dhënë sqarime se gjatë kësaj kohe ka qëndruar 1 javë tek të afërmit e tij. Dieta e përfituar në ditë deklarohet prej tyre në 140 USD/dita.

Komisioni, pasi administroi provat e sjella nga subjekti dhe analizoi shpjegimet e dhëna prej tij, duke marrë në konsideratë edhe qëndrimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit në vendimin nr. \*\*\*, datë 5.4.2019 dhe 22.5.2019, të cilët e konsiderojnë dietën si shpenzim dhe shpenzimet ditore kur subjekti qëndron te një i afërm në masën 5 USD në

<sup>16</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 24.7.2009.

<sup>17</sup> Vërtetim me nr. \*\*\*prot., datë 23.5.2019, nga ISSH-ja Kukës për vlerën 92,2 08 lekë, 1.1.1994 – 15.4.1995.

<sup>18</sup> Vërtetim me nr. \*\*\*prot., datë 23.5.2019, nga ISSH-ja Kukës për vlerën 49,300 lekë 16.04.1995 – 15.04.1997.

<sup>19</sup> Vërtetim me nr. \*\*\*prot., datë 23.5.2019, nga ISSH-ja Kukës për vlerën 58,398 lekë 01.01.1993 – 10.11.1995.

<sup>20</sup> Kontratë shitblerje me nr. \*\*\*, datë 30.8.1995 me çmimin në vlerën 1.050.000 lekë

<sup>21</sup> Vërtetim i datës 18.7.2019, i A. H., A. H. dhe Th. S.

ditë, arrin në konkluzionin se subjekti ka pasur mundësi të kursejë për 7 ditë ( koha e qëndrimit të të afërmit) shumën prej 135 USD.

- d) **Në lidhje me depozitën në emër të bashkëshortes së subjektit, znj. A.P., në shumën 3.200.000 lekë**, subjekti pretendon se kjo depozitë i përket znj. M.V. ( sqaruar në mënyrë të detajuar në pikën E, faqe (55- 58)).

Komisioni vlerësoi përgjigjet e subjektit dhe dokumentacionin përkatës, duke konstatuar mospërputhje të deklarimeve të tij në lidhje me shumën e depozituar nga bashkëshortja e tij për llogari të shtetas M.V. (3.200.000 lekë apo 35.000 USD) dhe kryerjes së veprimeve paraprake përgatitore për depozitim e kësaj shume *(është bërë depozitimi në datën 20.9.2002 nga bashkëshortja ime në shumën 3.200.000 lekë, pasi edhe të hollat e tjera të dërguara nga M. ishin konvertuar në lekë, apo pasi i kishte kthyer të gjitha në dollarë, P. i ka sjellë A. 35.000 USD për t'ia ruajtur).*

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe dokumentacionin përkatës, arriti në konkluzionin se pretendimi i subjektit për shumën prej 3.200.000 lekësh depozituar në emër të znj. A.P. nuk i përket asaj, por mbesës së saj, znj. M.V., nuk është bindës dhe gjithashtu është i pa mbështetur në prova.

Komisioni, pasi vlerësoi pretendimet e subjektit pas dërgimit të barrës së provës, për analizën financiare për periudhën 1982 – 2002, i reflektoi ato në pasqyrën e mëposhtme:

<b>Data</b>	<b>Përshkrim</b>	<b>Vlera</b>
	Të ardhurat nga pagat 1982 - 1997	1.319.409
20.12.1993	Blerje banese Rrëshen	-28.214
	Shpenzime jetike 1982 - 1997	-923.586
2.11.1997	Marrë hua vëllait, V.	200.000
6.11.1997	Blerje banese në Shkodër	-1.248.167
6.11.1997	Kursime nga udhëtimi në USA 7 ditë * 135 USD/dita me kurs këmbimi 143.85	135.938
	<b>Gjendja financiare më 6.11.1997</b>	<b>-544.620</b>
11.11.1997	Shitje banese në Shkodër	4.395.000
30.11.1997	Kthim borxhi vëllait	-200.000
27.6.1998	Blerje shtëpi Rr. “***”	-3.150.000
	<b>Gjendja financiare më 27.6.1998</b>	<b>500.380</b>
	Të ardhurat nga pagat për 1998	497.300
	Shpenzime jetike për 1998	-260.000
7.6.1999	Shitje banese Rrëshen	750.000
	Të ardhura nga pagat për periudhën 1999 – 31.7.2002	2.563.351
	Shpenzime jetike për periudhën 1999 – 31.7.2002	-1.075.000
16.7.2002	Depozitë në bankën Italo-Shqiptare 11.700 euro x 138,14	-1.616.238
	<b>Gjendja financiare në krijimin e depozitës më 16.7.2002</b>	<b>1.359.793</b>
	Të ardhura nga pagat për periudhën 1.8.2002 – 30.9.2002	204.929
	Shpenzime jetike për periudhën 1.8.2002 – 30.9.2002	-50.000
20.9.2002	Depozitë në bankën Italo-Shqiptare 3,200,000	-3,200,000
	<b>Gjendja financiare në krijimin e depozitës më 20.9.2002</b>	<b>-1.685.278</b>

	Të ardhura nga pagat për periudhën 1.10.2002 – 31.12.2002	337.493
	Shpenzime jetike për periudhën 1.10.2002 – 31.12.2002	-75.000
	<b>Gjendja financiare më 31.12.2002</b>	<b>-1.422.785</b>

## Konkluzion

**Komisioni, bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga ZVRPP-ja, dokumentacionin e vënë në dispozicion nga subjekti, si dhe udhëzimit të EKB-së, arrin në përfundimin se nga subjekti dhe personi i lidhur me të, si dhe nga pala tjetër në kontratën përkatëse, janë caktuar çmime fiktive në kontratat përkatëse të blerjes dhe të shitjes të apartamentit në Golem, i cili është blerë dhe shitur brenda një periudhe të shkurtër kohe me diferenca shumë të konsiderueshme çmimi të pasqyruara në dy kontratat duke i krahasuar ato edhe me çmimet referuese sipas udhëzimeve të EKB-së (apartamenti është blerë nga personi i lidhur me subjektin në datën 29.7.2005, për çmimin 1.900.000 lekë, i është shitur nga subjekti dhe personi i lidhur me të në datën 9.2.2006, blerësit N.D. për shumën 3.400.000 lekë dhe ky blerës e shet në datën 5.9.2006 për shumën 1.950.00 lekë).**

**Komisioni, duke marrë në konsideratë faktin se në datën 31.12.2002, subjekti rezulton me balancë financiare (të ardhura – shpenzime – pasuri) negative prej - 1.422.785, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime të ligjshme financiare për krijimin e kursimeve ndër vite (12.000 USD të deklaruar në deklaratën e pasurisë së vitit 2004, me origjinë të pretenduar nga gjendja *cash* e deklaruar në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, me burim nga totali i të ardhurave para vitit 2003), që kanë shërbyer si burim krijimi për blerjen e apartamentit të ndodhur në Golem, në shumën (+196.460 – 1.135.562) - 939.102 lekë.**

- **Analizë për automjetin tip “Mercedes-Benz” i vitit 1995, shitur në shumën 200.000 lekë, që ka shërbyer si burim krijimi për blerjen e apartamentit të ndodhur në Golem, në shumën 1.900.000 lekë.**

Nga korrespondenca që Komisioni ka kryer me DPSHTRr-në<sup>22</sup>, konfirmohet dokumentacioni përkatës për shitblerjen e këtij automjeti<sup>23</sup>.

Subjekti ka deklaruar si burim krijimi të ardhurat nga pagat e tij dhe të bashkëshortes.

## Konkluzion

**Komisioni e konsideroi të plotë dokumentacionin dhe nuk konstatoi ndonjë problematikë në lidhje me këtë pasuri.**

**Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë pasur burime të ligjshme dhe të mjaftueshme financiare për të krijuar këtë pasuri.**

2. **Oborr truall, me sip. 105 m<sup>2</sup> dhe 70 m<sup>2</sup> truall ndërtese (pra, gjithsej sip. 175 m<sup>2</sup> truall) dhe banesën në katin e \*\*\* me 2+1 etj., dhe kati i \*\*\* 1 dhomë, me çmimin 3.150.000 lekë, të cilat do të jepeshin në datën 1.8.1998 (blerë me kontratën e**

<sup>22</sup> Shkresa me nr. \*\*\*prot., datë 14.5.2019, nga DPSHTRr-ja drejtuar Komisionit.

<sup>23</sup> Kontrata e shitblerjes, datë 29.3.2004, ku shtetasi Z. K., ia ka shitur mjetin “Mercedes-Benz” me targa \*\*\*, subjektit Gjovalin Përnoca me çmimin 500.000 lekë; kontratën e shitblerjes, datë 24.6.2005, të subjektit Gjovalin Përnoca, ia shet këtë automjet shtetasit M. T., me çmimin 200.000 lekë.

shitblerjes nr. \*\*\*, datë 27.6.1998, midis shitësit Q.Z. dhe blerësit Gjovalin Përnoça, me adresë në Rr. “\*\*\*”, nr. \*\*\*).

Vlera: 3.150.000 lekë. Pjesa takuese: 50 % me bashkëshorten.

Burimi i krijimit: të ardhura nga shitja e shtëpive në Shkodër dhe Rrëshen.

### Hetimi i kryer nga Komisioni

Komisioni ka kryer korrespondencë me ZVRPP-në Tiranë, ALUIZNI-n, UKT-në dhe OSHEE-në<sup>24</sup>.

Në deklaratën e pasurisë të vitit 2003 subjekti ka deklaruar: “*shtëpi banimi, 2+1, vlera 3.500.000 lekë, Pjesa takuese: 50 %, me adresë Rr. \*\*\*, Nr. \*\*\*, Alias, Tiranë, e blerë në vitin 1998, me burim krijimi nga shitja e shtëpisë së mëparshme e privatizuar dhe kursimet nga pagat*”.

ZVRPP-ja Tiranë ka konfirmuar se në emër të z. Gjovalin Përnoça rezultojnë e regjistruar:

- pasuria e llojit “ndërtesë”, me sip. 151.8 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, e regjistruar në bazë të lejes së legalizimit nr. \*\*\*, datë 29.9.2016 (godinë banimi \*\*\* kate + papafingo, sip. kati \*\*\* =151.8 m<sup>2</sup>, sip. kati \*\*\* =151.8 m<sup>2</sup>, sip. \*\*\*=51.7 m<sup>2</sup>), regjistruar në z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, Tiranë, në bashkëpronësi me z. B.P.; si dhe
- pasuria e llojit “truall”, me sip. 175 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, Tiranë.

Kjo pasuri është përfituar nga kontrata e shitblerjes me nr. \*\*\*, datë 27. 6.1998, me shitës Q.Z. dhe blerës Gjovalin Përnoça.

Objekti i kësaj kontrate është shitja e truallit oborrit me sip. 105 m<sup>2</sup> dhe 70 m<sup>2</sup> truall ndërtesë dhe katin e \*\*\* të përbërë prej dy dhomash një kuzhinë, aneks, korridor, tualet dhe verandë dhe katin e \*\*\*, të përbërë prej një dhomë me përmasa 6m x 5m të banesës së sipërpërshkruar kundrejt çmimit 3.150.000 lekë, çmim i cili likuidohet në datën 1.8.1998 me deklaratë noteriale.

Me kontratën nr. \*\*\*, datë 26.6.1998, shitësi Q.Z. i shet blerësit B.P. truall me sip. 105 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë kati \*\*\* (2+1), duke mbetur në bashkëpronësi me katin tjetër të ndërtesës, për çmimin 1.950.000 lekë. Pagesa do të bëhet në dy këste: kësti i I-rë në shumën 800.000 lekë, i cili likuidohet përpara nënshkrimit të kontratës; dhe kësti i II-të prej 1.150.000 lekësh do të likuidohet në datën 1.8.1998.

Në datën 4.8.1998 bëhet interpretimi i kontratës me nr. \*\*\*, me palë shitëse Q.Z. dhe blerës B.P. Në këtë dokument noterial pasqyrohet se: “*Likuidimi i çmimit të plotë të blerjes është bërë me kushte sipas deklaratave noteriale (nr. \*\*\* datë 9.7.1998; nr. \*\*\* datë 14.7.1998; nr. \*\*\* datë 18.7.1998) dhe ka mbetur pa likuiduar edhe shuma prej 500.000 lekësh dhe sot bëhet likuidimi i plotë i çmimit dhe i shumës 500.000 lekë, në prezencë të noteres*”.

Në emër të z. B.P. (babai i subjektit) rezultojnë e regjistruar pasuria e llojit “truall” me sip. 175 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, e regjistruar në z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, Tiranë.

<sup>24</sup> Shkresa nr. \*\*\*, datë 11.1.2019, e ZVRPP-së Tiranë; shkresa nr. \*\*\*, datë 28.12.2018, e ALUIZNI-t; shkresa nr. \*\*\*, datë 11.2.2019, e ALUIZNI-t; shkresa nr. \*\*\*, datë 5.6.2019, shkresa nr. \*\*\*, datë 21.6.2019, e ALUIZNI-t; shkresa nr. \*\*\*, datë 18.1.2019, e OSHEE-së; shkresa nr. \*\*\*, datë 16.1.2019, e UKT-së.

ZVRPP-ja Tiranë ka lëshuar:

- certifikatën për vërtetim pronësie datë 26.5.2015 në emër të z. B.P., për pasurinë nr. \*\*\*, e llojit truall me sip. truall 175 m<sup>2</sup>;
- certifikatën për vërtetim pronësie datë 26.5.2015 në emër të z. Gjovalin B. Përnoça për pasurinë me nr. \*\*\*, e llojit truall me sip. truall 175 m<sup>2</sup>;
- certifikatën për vërtetim pronësie datë 23.12.2016 në emër të z. Gjovalin Përnoça dhe z. B.P. për pasurinë me nr. \*\*\*, e llojit ndërtesë, me sip. 151.80 m<sup>2</sup>.

Në kartelën e pasurisë është pasqyruar ndërtesa me sip. 151.80 m<sup>2</sup> dhe te përshkrimi i veçantë pasqyrohet “leje legalizimi nr. \*\*\*, datë 29.9.2016, godinë banimi \*\*\* kate + papafingo; sip. e katit \*\*\* 151.8 m<sup>2</sup>; sip. e katit të \*\*\* 151.8 m<sup>2</sup> dhe sip. e papafingos 51.7 m<sup>2</sup>”.

ALUIZNI Tiranë ka dërguar dokumentacionin e të gjithë praktikës së legalizimit<sup>25</sup>.

Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit në lidhje me: dokumentacionin justifikues ligjor për vlerën e investimit të kryer në këtë banesë; dokumentacionin ligjor justifikues për mundësitë financiare të babait të subjektit, z. B.P., për blerjen e katit përdhe dhe truallit në shumën 1.950.000 lekë, datë 26.6.1998; mospërputhjen e çmimit të blerjes së kësaj banese nga subjekti, pasi në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 ka deklaruar çmimin 3.500.000 lekë, ndërsa çmimi i pasqyruar në kontratën e shitblerjes është në vlerën 3.150.000 lekë; mospërputhjen për sipërfaqen e ndërtimit, deklaruar nga subjekti në deklaratën “Vetting”, prej 70 m<sup>2</sup>. Ndërkohë, referuar lejes së legalizimit të datës 29.9.2016 sipërfaqja e ndërtimit është 151.8 m<sup>2</sup>.

Subjekti, në lidhje me dokumentacionin justifikues ligjor për vlerën e investimit që ka bërë në këtë banesë, ka deklaruar se me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 27.6.1998, ka blerë nga shitësi Q.Z. në Rr. “\*\*\*\*”, nr. \*\*\*, Allias, Tiranë, oborrin truall prej 105 m<sup>2</sup> dhe 70 m<sup>2</sup> truall ndërtesë (pra, gjithsej 175 m<sup>2</sup> truall), dhe banesën në katin e \*\*\* me 2+1, etj., dhe kati i \*\*\*, 1 dhomë, me çmimin 3.150.000 lekë. Në deklaratën noteriale, datë 4.8.1998, del se është likuiduar plotësisht vlera e saj.

➤ **Në lidhje me mundësitë financiare të babait të subjektit për blerjen e shtëpisë në Rr. “\*\*\*\*”, nr. \*\*\*, Allias, Tiranë, në shumën 1.950.000 lekë**

---

<sup>25</sup> 5 (pesë) formularë vetëdeklarimi të objektit në legalizim ku subjekti dhe babai i tij kanë deklaruar si vit ndërtimi vitin 1979; foto të objektit \*\*\*-katësh nga ku dallohet qartë se kemi të bëjmë me ndërtim të ri dhe joekzistues; leja e legalizimit nr. \*\*\* prot., datë 29.9.2016, për objektin godinë banimi \*\*\* kate + papafingo, sipërfaqja e parcelës ndërtimore 335.3 m<sup>2</sup>, sipërfaqja e ndërtimit 151.8 m<sup>2</sup> me \*\*\* kate mbi tokë, në emër të B. dhe Gjovalin Përnoça; procesverbali i verifikimit në terren i datës 2.5.2016, ku pasqyrohet banesa me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 335.3 m<sup>2</sup>, me sipërfaqe të bazës së objektit 151.8 m<sup>2</sup> me \*\*\* kate mbi tokë + papafingo ku kati \*\*\* 155.1 m<sup>2</sup>, kati i \*\*\* 151.8 m<sup>2</sup> dhe papafingo 51.7 m<sup>2</sup>; formulari i pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet informale lëshuar nga ALUIZNI për objektet informale përcakton vlerën e investimit 356,3 x 28.333 = 10.095.047,9 lekë; deklaratë noteriale e datës 11.5.2016 (nr. \*\*\*), me deklarues B. P. dhe Gjovalin Përnoça, ku deklarojnë se: “...nga ana jonë në vetëdeklarim për legalizimin e banesës tonë të ndodhur në Tiranë në Rr. \*\*\*, banesë private z. k. \*\*\* etj..., gabimisht në formularin përkatës kemi deklaruar sikur ketë objekt e kemi ndërtuar në vitin 1979. Për efekt saktësimi për sa më sipër deklarojmë se ndërtimi i banesës tonë prej \*\*\*-katesh dhe me papafingo, siç është përshkruar, matur dhe fotografuar dhe në gjendjen që është sot është bërë dhe transferuar pjesë-pjesë nga ne në gjendjen që është aktualisht, por pas vitit 1998 e në vijim”.

Subjekti, pas kërkesës së Komisionit në lidhje me dokumentacionin ligjor justifikues për mundësitë financiare të babait të tij, z. B.P., për blerjen e katit përdhe dhe truallit\_oborr dhe nënobjekt, në shumën 1.950.000 lekë, datë 26.6.1998, ka shpjeguar si më poshtë:

*“Siç kam shpjeguar në deklarinimin “Vetting”, me kontratën e privatizimit, datë 20.12.1993, me Komunale Banesa Mirditë kam blerë një banesë 2+1, etj., me çmimin 28.214 lekë, të cilën unë me gruan dhe dy prindërit (në një certifikatë familjare), me kontratën nr. \*\*\*, datë 7.6.1999, e kemi shitur për vlerën 1.500.000 lekë, nga të cilat gjysmën e shumës, vlerën 750.000 lekë i kemi marrë vetë, ndërsa gjysmën tjetër e kanë mbajtur prindërit.*

*Me kontratën e privatizimit, datë 16.4.1993, me shitës Komisionin e Privatizimit të Banesave Kukës dhe blerës z. V.P. (vëllai), me të drejta të barabarta me gruan e tij, znj. Sh.P., me babanë, z. B.P. dhe me nënën znj. P.P., kanë blerë një shtëpi banimi, 2+1, me vlerën 29.980 lekë, e cila është hipotekuar po atë ditë.*

*Me kontratat e shitjes nr. \*\*\*, datë 30.8.1995, nga shitësit V. dhe Sh.P. i është shitur kjo banesë blerësit Xh.K. në çmimin prej 1.050.000 lekësh, të cilat vëllai i ka mbajtur për vete. Në qershor të vitit 1998, në momentin që prindërit do të blinin shtëpinë në Tiranë, këto lekë ua kanë dhënë prindërve B. dhe P.P., madje ka banuar në të njëjtën banesë me ta që nga blerja e saj e deri në vitin 2007 (gjë që vërteton vetë vëllai me deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 20.5.2019, që do të gjeni bashkëlidhur). Nga këto dy kontrata shitjeje, prindërit kanë siguruar shumën 1.800.000 lekë.*

- *Ndërsa shumën prej 100.000 lekësh e kanë pasur vetë...”*

Subjekti ka depozituar deklaratën noteriale të datës 20.5.2019, me deklarues shtetasit V. dhe Sh.P., të cilët deklarojnë se shitjen e banesës në datën 30.8.1995, në vlerën 1.950.000 lekë (lapsus, duhet 1.050.00 lekë) dhe se këto lekë ia kanë dhënë babait të tij, z. B.P.

Subjekti gjithashtu ka shpjeguar se: *“Shumën prej 1.050.000 lekësh të përfutur nga shitja e banesës në Kukës, në vitin 1995 vëllai V.P. i ka mbajtur në shtëpi apo i ka përdorur për punët e tij sipas rastit qëkur i ka marrë në datën 30.5.1995 e deri kur bleu babai shtëpinë në Tiranë në datën 26.6.1998, ndërsa babai sapo i ka marrë ia ka dhënë shitësit.*

*Pas shitjes së banesës në Kukës në vitin 1995, vëllai V.P. me gruan, djalin dhe prindërit kanë ardhur në Rrëshen dhe kanë banuar në shtëpinë e tij deri në vitin 1998, ku është blerë shtëpia e babait në Tiranë, ku përsëri vëllai familjarisht ka ardhur bashkë me prindërit dhe kanë jetuar rreth 10 vjet pas blerjes së saj.”*

Subjekti, në lidhje me mospërputhjen në deklarinim për sa i përket çmimit të blerjes së shtëpisë prej tij, ka deklaruar se çmimi i blerjes është 3.150.000 lekë, duke e konsideruar një pakujdesi dhe të paqëllimshme shënimin e vlerës 3.500.000 lekë, në deklaratën e pasurisë së vitit 2003.

Komisioni, me pyetësorin nr. 4 dhe 5, i ka kërkuar subjektit që të shpjegojë mospërputhjen në lidhje me sip. 70 m<sup>2</sup> truall nën ndërtesë deklaruar në deklaratën “Vetting” me sipërfaqen e ndërimit 151.8 m<sup>2</sup>, pasqyruar në lejen e legalizimit; të përcaktojë sesa ka qenë sipërfaqja e ndërtesës sipas kontratës së shitblerjes; nëse janë bërë shtesa apo ndryshime në këtë banesë dhe përse ALUIZNI ka bërë legalizimin e kësaj ndërtese.



Subjekti, në përgjigje të tij, ka deklaruar se: “Nuk ka mospërputhje...nga përshkrimi i dy kontratave të blerjes së këtyre dy shtëpive nga babai dhe unë del se secili ka blerë nga 175 m<sup>2</sup> truall (105 m<sup>2</sup> truall i lirë + 70 m<sup>2</sup> truall ndërtesë, pra truall mbi të cilin ka ndërtesë)..”

*Meqenëse e gjithë ndërtesa shkel (zë, është ndërtuar) mbi 140 m<sup>2</sup> truall, si në rastin kur përshkruhet shtëpia e babait ashtu dhe për shtëpinë time, në kontratat respektive të shitjes është shkruar se blemë pasuritë respektive.....nuk thuhet sesa është sipërfaqja e ndërtimit apo e banesës së secilit pasi këtë banesë shitësi Q. Z. e ka pasur ndërtuar pa leje... Ndërsa, sipas lejes së legalizimit, për banesën time sipërfaqja e ndërtimit është 151.8 m<sup>2</sup> ku është llogaritur banesa ime dhe një dhomë në katin e tretë, por unë nuk kam asnjë mospërputhje pasi vetëm sa kam cituar kontratën e shitblerjes së shtëpisë”.*

Lidhur me pyetjen se a janë bërë ndryshime apo shtesa në këtë ndërtesë, subjekti ka deklaruar: “...nga ana ime nuk është bërë asnjë ndërhyrje apo shtesë në strukturën e ndërtesës, vetëm sa kam riparuar herë pas here çatinë...”.

Lidhur me pyetjen se përse ALUIZNI ka legalizuar ndërtesën objekt dykatësh + papafingo subjekti deklaroi se: “Mendoj se tashmë është e qartë se unë kisha blerë një banesë e cila ishte bërë pa leje nga shitësi në vitet 1994, pra, i hipotekuar ishte vetëm trualli...prandaj bëmë legalizimin e banesës mbi truall, duke u përcaktuar tashmë pronësia ime edhe mbi sipërfaqen e ndërtimit prej 151.8 m<sup>2</sup>”.

### **Në përfundim, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit në lidhje me:**

1. Mospërputhje deklarimi, pasi në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 subjekti ka deklaruar “shtëpi banimi 2+1”, ndërkohë që sipas kontratës së shitblerjes të vitit 1998, si edhe në deklaratën “Vetting”, subjekti ka deklaruar “oborr truall me sip. 105 m<sup>2</sup> dhe 70 m<sup>2</sup> truall ndërtesë (pra, gjithsej 175 m<sup>2</sup> truall) dhe banesën në katin e \*\*\* me 2+1 etj., dhe kati i \*\*\* 1 dhomë, me çmimin 3.150.000 lekë.

2. Mosdeklarim i ndërtimit pa leje në deklaratat periodike nga viti 2006 kur është bërë vetdeklarimi i kësaj pasurie pranë ALUIZNI-t Tiranë, deri në deklaratën “Vetting”, konkretisht:

a) Mosdeklarim në deklaratat periodike vjetore 2006 – 2016 i pjesës së ndërtimit me sip. 11.8 m<sup>2</sup> të ndërtesës 3-katëshe në Rr. “\*\*\*”, që rezulton si sipërfaqe shtesë, marrë në konsideratë se sipërfaqja totale e ndërtesës së blerë në vitin 1998 është 140 m<sup>2</sup>, ndërsa sipërfaqja e legalizuar e ndërtesës është 151.8 m<sup>2</sup>.

b) Mosdeklarim në deklaratën “Vetting” i pjesës së ndërtimit prej 21.7 m<sup>2</sup> të papafingos në katin e \*\*\* të subjektit (në kontratën e vitit 1998 është e pasqyruar dhomë me përmasa 5x6 m<sup>2</sup> = 30 m<sup>2</sup>, në deklaratën “Vetting” subjekti deklaroi vetëm 1 dhomë në katin e tretë pa përmasa. Dokumentacioni i përcjellë nga ALUIZNI dhe ZVRPP-ja Tiranë pasqyron papafingo me sip. 51.7 m<sup>2</sup> dhe, rrjedhimisht, diferenca prej 51.7 m<sup>2</sup> - 30m<sup>2</sup> = 21.7 m<sup>2</sup>, rezulton e padëklaruar).

3. Mospërputhje deklarimi për sa i përket vitit të ndërtimit të shtëpisë:

a) Në pesë formularët e vetëdeklarimit të paraqitur pranë ALUIZNI-t, është deklaruar si vit ndërtimi – viti 1979.

- b) Në deklaratën noteriale të datës 11.5.2016, gjatë procesit të legalizimit subjekti me babanë kanë deklaruar: “... gabimisht në formularin përkatës kemi deklaruar sikur këtë objekt e kemi ndërtuar në vitin 1979... deklarojmë se ndërtimi i banesës tonë prej dykatësh dhe me papafingo, siç është përshkruar, matur dhe fotografuar dhe në gjendjen që është sot është bërë dhe transferuar pjesë-pjesë nga në gjendjen që është aktualisht, por pas vitit 1998 e në vijim”.
- c) Në pyetësin nr. 5 subjekti ka deklaruar: “... mendoj se tashmë është e qartë se unë kisha blerë një banesë e cila ishte bërë pa leje nga shitësi në vitin 1994.”

4. Mungesë burimi të të ardhurave me të cilat babai i subjektit, z. B.P., ka blerë shtëpinë në datën 26.6.1998, në vlerën 1.950.000 lekë, ku shuma 800.000 lekë, si këst i parë, është paguar në datën 26.6.1998, ndërsa shuma prej 1.150.000 lekësh, si këst i dytë, është paguar në datën 1.8.1998.

Referuar deklarimit të subjektit se “...me shitjen e shtëpisë (përfitur nga privatizimi) në Rrëshen në datën 7.6.1999, në vlerën 1.500.000 lekë i kam dhënë babait B.P. gjysmën e shumës 750.000 lekë, pasi pagesat nga babai janë bërë në vitin 1998”, ndërkohë që shtëpia në Rrëshen është shitur në qershor të vitit 1999, pra, shuma prej 750.000 lekësh nuk justifikohet prej babait të subjektit.

5. Mungesë burimi justifikues i të ardhurave të përdorura për blerjen e shtëpisë në Rr. “\*\*\*\*” në vitin 1998, deklaruar në deklaratën “Vetting” si burim krijimi “nga shitja e shtëpive në Rrëshen dhe Shkodër”, kur nga kontrata e shitjes rezulton se shtëpia në Rrëshen është shitur në datën 7.6.1999.

6. Mospërputhje deklarimi në lidhje me burimin e krijimit të të ardhurave për blerjen e shtëpisë në Rr. “\*\*\*\*”, pasi në deklaratën e vitit 2003 subjekti ka deklaruar si burim krijimi “të ardhurat nga shitja e shtëpisë së mëparshme, e përfitur nga privatizimi dhe kursimet nga pagat”, ndërsa në deklaratën “Vetting” ka deklaruar si burim krijimi shumën prej 17.000 USD (konvertuar në 2.490.000 lekë) nga shitja e shtëpisë në Shkodër dhe shuma 750.000 lekë nga shitja e shtëpisë në Rrëshen.

7. Nëse i referohemi burimit të deklaruar në deklaratën “Vetting” nga shitja e dy shtëpive (në Rrëshen dhe në Shkodër), duket se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare për blerjen e shtëpisë, për diferencën prej 660.000 lekësh.

Pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime, si më poshtë:

**Në lidhje me pikën 1 të barrës së provës, subjekti ka shpjeguar** se nuk ka mospërputhje deklarimi, por e shumta mund të konsiderohet një deklaram i së njëjtës pasuri, por i padetajuar me imtësi.

**Në lidhje me pikën 2,** subjekti ka shpjeguar se: “... që nga blerja e shtëpisë, as unë dhe as babai, nuk kemi bërë asnjë metër katror ndërtim, asnjë lloj shtese, as anësore të strukturës së murit, që nga kati përdhe dhe as në papafingo, nuk kemi pasur se çfarë të deklarojmë në deklaratat periodike. ...Kur përshkruhet shtëpia e babait, ashtu dhe për shtëpinë time, në kontratat respektive të shitjes nuk thuhet se sa është sipërfaqja e ndërtimit apo e banesës së secilit, pasi këtë banesë, shitësi Q. Z., e ka ndërtuar pa leje që më përpara se ta blinim ne.”

- Subjekti ka dhënë shpjegime të mëtejshme të detajuara në lidhje me pretendimet e tij se deklarimet për këtë pasuri (kati i \*\*\* + papafingo + truall nën objekt + oborr) i ka bërë mbështetur në të dhënat e kontratës së shitblerjes së shtëpisë së banimit dhe truallit në vitin 1998 dhe lejes së legalizimit të datës 20.9.2016.
- Gjithashtu, edhe me deklaratën noteriale nr. \*\*\*, të datës 22.7.2019, shitësi Q.Z., i cili banon ngjitur me këtë shtëpi, ka deklaruar, pasi e ka parë banesën në të gjitha pjesët e saj, se, pavarësisht se janë bërë suvatime, shtrime pllakash, ndërrime dritaresh apo dyersh, etj., nuk i është bërë asnjë ndryshim strukturës së jashtme të banesës, si dhe nuk është shtuar askund asnjë m<sup>2</sup> sipërfaqe ndërtimi, pra, banesa është në gjendjen e lënë prej tij. Ai ka deklaruar se ndërtimin e objektit, në gjendjen që e ka marrë subjekti, ashtu siç është edhe sot si strukturë, e ka përfunduar në vitet 1994 – 1995.
- Së fundmi, me aktekspertimin e ekspertit të licencuar, ing. ndërtimi, z. J.Sh., datë 24.7.2019, subjekti pretendon se shpjegohet në mënyrë të detajuar dhe shkencore fakti se: *“... nga momenti i blerjes së ndërtesës dhe deri në ditët e sotme, banesa është mirëmbajtur në pjesët banuese dhe nga jashtë, ndërsa dhoma në papafingo dhe shkallët në papafingo nuk kanë pësuar ndryshime që nga blerja”*.

**Në lidhje me pikën 3 të barrës së provës,** subjekti ka shpjeguar se: *“Në deklarinimin për sa i përket vitit të ndërtimit të shtëpisë nuk ka asnjë mospërputhje për këtë arsye:*

*Në formularët e vetëdeklarimit të paraqitur pranë ALUIZNI-t, me të drejtë kemi deklaruar si vit ndërtimi vitin 1979, pasi në këtë vit e ka filluar vërtetë ish-pronari, gjë që e dinim edhe nga vendimit gjyqësor nr. \*\*\*, datë 12.7.1994, sipas të cilit z. Q.Z. ka vërtetuar faktin juridik të ndërtimit të banesës në fjalë që nga viti 1979.*

*Në deklaratën noteriale të datës 11.5.2016, gjatë legalizimit ne me të drejtë kemi deklaruar se: ...gabimisht në formularin përkatës kemi deklaruar sikur këtë objekt e kemi ndërtuar në vitin 1979... pasi siç e thamë më lart, objektin pa leje nuk e kemi ndërtuar ne, por ish-pronari.*

*Lidhur me shprehjen se: ...ndërtimi i banesës...siç është përshkruar, matur dhe fotografuar dhe në gjendjen që është sot është bërë dhe transferuar (këtu kemi dashur të themi ‘transformuar’) pjesë-pjesë nga ne në gjendjen që është aktualisht, por pas vitit 1998 e në vijim”, e kemi fjalën për suvatimin e fasadës, dyert, dritaret, pllakat, etj., pra, riparimet dhe përmirësimet e jo ndërtimin strukturor, pasi as nuk ka logjikë që ne të deklarokemi se e bëmë vetë shtëpinë, pas vitit 1998, kur në fakt në po atë vit e blemë..!*

*Lidhur me deklarinimin në pyetësin nr. 5, se: “...tashmë është e qartë se unë kisha blerë një banesë e cila ishte bërë pa leje nga shitësi në vitin 1994’, as ky deklarim nuk vjen në kundërshtim me deklaratat e tjera dhe as me faktin, pasi, siç u sqarua, ish-pronari e ka filluar ndërtimin që në vitin 1979 dhe e ka përfunduar, siç na ka thënë, në vitet 1994 – 1995, pra, përpara se ta blinim ne. Faktin nëse ka ndërtim pa leje apo jo, e ka sqaruar aktekspertimi, i cili ka konkluduar se nga ne nuk është bërë ndërtim pa leje”.*

**Në lidhje me pikat 4, 5, 6, 7 të barrës së provës,** subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *“Deklarimi si burim financiar për blerjen e shtëpisë në Rr. \*\*\*, në vitin 1998, të shumës monetare prej 1.500.000 lekësh, të përfutuar nga shitja e shtëpisë në Rrëshen në vitin 1999, është bërë një gabim formal në deklarim, për pakujdesi dhe nxitim, por që nuk e ndryshon*

*aspak logjikën e krijimit të të ardhurave dhe justifikimin e saktë të këtyre blerjeve... Babait do t'i jepte vëllai të gjitha lekët e shtëpisë së Kukësit (1.050.000 lekë), ndërsa unë do t'i jepja gjysmën e parave nga shitja e shtëpisë në Mirditë, shtëpi për të cilën blerësi ishte në pritje që sapo të ikte babai nga Mirdita, do ta blinte.*

*Në momentin që neve na u deshën paratë për të blerë shtëpitë, unë kisha të lira 30.000 USD, që mora nga shitja në vitin 1997 të shtëpisë në Shkodër. Me këto lekë kam likuiduar banesën time prej 3.150.000 lekësh, si dhe i kam dhënë babait sasinë prej 750.000 lekësh, 100.000 lekë i kishte vetë, ndërsa shumën prej 1.050.000 lekësh, ia ka dhënë vëllai, duke iu plotësuar shuma prej 1.800.000 lekësh... Me t'u shitur shtëpia e Mirditës, kam marrë gjithsej edhe 1.500.000 lekë... Sqaroj se, kërkimi i shpjegimeve të sakta për periudha kohore të largëta e për më tepër kur nuk kemi pasur asnjë detyrim ligjor për të mbajtur evidenca, shënime e llogari (si ngatërresa e vitit 1998 me 1999), është shumë i vështirë... ”.*

## **Konkluzion**

**Komisioni, pasi mori në konsideratë provat, si dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, arriti në përfundimin se:**

- **Në lidhje me pikën 1 të barrës së provës:**
- Subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer deklarim të plotë të pasurisë së paluajtshme të blerë në Rr. “\*\*\*”, Tiranë, konkretisht, të katit të parë dhe të papafingos së ndërtesë përfshirë dhe truallin nëndërtesë dhe oborrin, si dhe sipërfaqet përkatëse.
- **Në lidhje me pikën 2:**
- Subjekti nuk ka deklaruar sipërfaqet shtesë në pasurisë nr. \*\*\*, e regjistruar në vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, Tiranë, me sipërfaqe ndërtimi 151.8 m<sup>2</sup>, (godinë banimi \*\*\* + papafingo, sip. kati \*\*\* = 151.8 m<sup>2</sup>; sip. kati \*\*\* = 151.8 m<sup>2</sup>; sip. \*\*\* = 51.7 m<sup>2</sup>), përfutur me lejen e legalizimit nr. \*\*\*, datë 29.9.2016, dhe pajisur me certifikatë për vërtetim pronësie nr. \*\*\*, lëshuar në datën 23.12.2016 nga ZVRPP –ja Tiranë, në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit me babanë e tij, z. B. P.
- Rezultojnë pasaktësi deklarimi në deklaratën “Vetting” ku subjekti i rivlerësimit vetëm sa i përmend katin e \*\*\* dhe \*\*\*, por pa specifikuar sipërfaqet përkatëse.
- **Në lidhje me pikën 3:**
- Subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime të plota dhe bindëse në lidhje me kohën e ndërtimit përfundimtar të shtëpisë së banimi që rezulton të jetë përfunduar pas vitit 1994.
- **Në lidhje me pikat 4, 5, 6, 7 të barrës së provës:**
- Subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh të ligjshme financiare, në shumën 660.000 lekë (3.150.000 – 2.490.000 lekë (17.000 USD) = 660.000 lekë), për blerjen e shtëpisë së banimit në Rr. “\*\*\*”, Tiranë në vitin 1998 për shumën 3.150.000 lekë (pjesa e vet takuese), për arsye se njëri nga burimet financiare, konkretisht të ardhurat nga shitja e shtëpisë në Rrëshen, është krijuar në vitin 1999, pra, pas blerjes së shtëpisë në Tiranë në vitin 1998.
- Gjithashtu, marrë shkas nga deklaratimet e subjektit, pjesa e të ardhurave në shumën prej 750.000 lekësh, të siguruar nga shitja e shtëpisë në Rrëshen në vitin 1999, për

shumën 1.500.000 lekë, nuk mund të shërbejnë si burim i ligjshëm i të ardhurave me të cilat babai i subjektit të rivlerësimit ka blerë katin \*\*\* dhe truallin nënobjekt dhe oborr në shtëpinë në Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë, për shumën 1.950.000 lekë, për arsye se ky burim është krijuar më vonë në kohë (viti 1999) se blerja e shtëpisë, e realizuar në vitin 1998.

- Subjekti i rivlerësimit ka ndryshuar deklarimin e tij duke qenë në kushtet e deklarimit të rremë, në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë së paluajtshme shtëpi banimi dhe truall të blerë në vitin 1998, në Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë, pasi fillimisht në deklaratën e pasurisë të vitit 2003 ka deklaruar si burim krijimi të ardhurat nga shitja e shtëpisë së mëparshme e përfituar nga privatizimi dhe kursimet nga pagat, në deklaratën “Vetting” ka deklaruar si burim krijimi për blerjen e kësaj pasurie (pjesa e tij dhe e babait) të ardhurat e siguruar nga shitja e shtëpive në Shkodër dhe në Rrëshen, ndërkohë që gjatë hetimit administrativ, ka ndryshuar deklarimin duke deklaruar si burim krijimi të ardhurat e siguruar nga shitja e shtëpisë në Shkodër, si dhe të ardhurat e përfituara nga i vëllai nga shitja e shtëpisë në Kukës.
- Analizë e burimit të krijimit të mjeteve financiare për blerjen e shtëpisë së banimit me adresë: Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë, blerë në datën 27.6.1998, me sip. truall për ndërtesë 70 m<sup>2</sup> dhe 105 m<sup>2</sup> truall, ku si burim ka shërbyer shitja e shtëpive në Rrëshen dhe në Shkodër.

#### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Komisioni ka kryer korrespondencë me Entin Kombëtar të Banesave<sup>26</sup>.

- ✓ **Në lidhje me apartamentin e shitur në Rrëshen, që ka shërbyer si burim krijimi për blerjen e shtëpisë së banimit në Tiranë**

Me kontratën për privatizimin e banesës, e lidhur në datën 20.12.1993 ndërmjet shitësit, Ndërmarrja Komonale Banesa, dhe blerësit, Gjovalin Përnoca, është bërë privatizimi i banesës nr. \*\*\*, p. \*\*\*, shk. \*\*\*, k. \*\*\*, me sip. 108.9 m<sup>2</sup>, me vlerë 35.267 lekë. Çmimi i paguar nga blerësi është në vlerën 28.214 lekë.

Me kontratën e shitblerjes datë 7.6.1999, shitësit P., Gj., A. dhe B.P. ia shesin këtë apartament blerësit Gj.K., me çmimin 1.500.000 lekë.

**Komisioni, referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, e konsideron të plotë dhe nuk vëren ndonjë problematikë në lidhje me këtë pasuri.**

- ✓ **Në lidhje me apartamentin e shitur në Shkodër, që ka shërbyer si burim krijimi për blerjen e shtëpisë së banimit në Tiranë**

Kjo pasuri është përfituar nga kontrata e përkohshme datë 25.9.1996, e shitjes së apartamentit, e lidhur ndërmjet Entit Kombëtar të Banesave Shkodër, në cilësinë e shitësit, dhe Gjovalin Përnoca, në cilësinë e blerësit, për blerjen e apartamentit 2+1 me sip. 69.20 m<sup>2</sup> në Rr. “\*\*\*\*”, Shkodër duke u paguar si paradhënie shuma prej 35.000 lekësh.

---

<sup>26</sup> Shkresa nr. \*\*\*prot., datë 21.5.2019, e EKB-së, bashkë me dokumentacionin bashkëngjitur.

Në datën 6.11.1997 është lidhur kontrata përfundimtare e shitjes së apartamentit me pagesë të menjëhershme. Vlera e apartamentit është 11.625 USD ose 1.703.062 lekë (konvertuar me kursin ditor 146.5 lekë).

Pas aplikimit të zbritjes së cmimit me 30 %, për shkak të pagesës së menjëhershme, blerësi ka paguar çmimin përfundimtar 1.248.167 lekë, ose 8.603 USD, konvertuar me kursin ditor të pagesës së faturës nr. \*\*\*, datë 25.9.1996 dhe nr. \*\*\*, datë 11.11.1997.

Me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 11.11.1997, shitësi Gjovalin Përnoca ia shet apartamentin blerësit, shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në vlerën 30.000 USD, me lekë në dorë.

1. Komisioni ngriti dyshime në lidhje me ligjshmërinë e përfitimit të këtij apartamenti nga subjekti; çmimin e shitjes së apartamentit shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.; pagesën e tatimit në burim; dhe mundësinë financiare për blerjen e kësaj pasurie nga subjekti.

Referuar faktit nëse subjekti duhej të përfitonte apartamentin në Shkodër nëpërmjet procedurave të privatizimit nga Enti Kombëtar i Banesave, datë 25.9.1996, ndërkohë që kishte përfituar më parë dhe kishte ende në pronësi apartamentin në Rrëshen me privatizim nga Ndërmarrja Komunale Banesa (me statusin si i pastrehë) në datën 20.12.1993, Komisioni i është drejtuar Entit Kombëtar të Banesave (EKB), ku i ka kërkuar shpjegime për mënyrën e përfitimit të apartamentit të dytë në Shkodër.

EKB-ja, në përgjigje të saj, ka bashkëngjitur dokumentacionin ligjor mbi kriteret ku është bazuar për dhënien e banesës subjektit Gjovalin Përnoca, me statusin si i pastrehë në qytetin e Shkodrës.

Pas kalimit të barrës së provës subjekti ka argumentuar: *“Jam transferuar me detyrën e kryetarit të Gjykatës së Apelit Shkodër, që më 1.11.1993 dhe duke qenë pa banesë, duke bërë punën e shtetit larg familjes, që nga nëntori 1993 – 25 shtator 1996, Këshilli i Bashkisë Shkodër më trajtoi me banesë nga Enti i Banesave... Unë privatizimin e banesës në Rrëshen e kam bërë sipas ligjit, por duke qenë në një certifikatë familjare edhe me prindërit. Më vonë, meqë mbeta në Shkodër dhe nuk po transferohesha dot, jam ndarë nga prindërit dhe kam kërkuar banesë nga Bashkia Shkodër, si familje më vete, duke e konsideruar veten të pastrehë në Shkodër, si i transferuar (me detyrim nga shteti dhe jo me kërkesë). Pra, e kam konsideruar veten jo në kushtet e ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, por si i pastrehë, në kushtet e VKM-së nr. 49, datë 19.1.1993, dhe të VKM-së nr. 291, datë 21.6.1994, pika 2, ku thuhet: ‘Për qytetarët që kanë përfituar nga ligji nr. 7652, datë 23.12.1992, ‘Për privatizimin e banesave shtetërore’, si ushtarake, të transferuar, persona shtetërorë, etj., vlera e apartamentit të ri do të llogaritet sipas kostos reale të ndërtimit në momentin e shitjes, e konvertuar me vlerën e dollarit në atë moment.*

*Nga interpretimi i këtij ligji kuptoj se bëhet fjalë për persona që ndonëse kanë përfituar një herë nga ligji për privatizimin, e fitojnë statusin si të pastrehë kur janë në kushte detyrimi për të kryer shërbimin si: ushtarakë, të transferuar, persona shtetërorë, etj., Prandaj, në këto raste, vlera e apartamentit të ri (aty ku i dërgon shteti për interesin publik dhe pa u marrë pëlqimin) do të llogaritet sipas kostos reale. Për më tepër, me të njëjtën logjikë, në pikën 3 të kësaj VKM-je, thuhet se: ‘Për qytetarët që kanë përfituar nga ligji nr. 7652, datë 23.12.1992, ‘Për privatizimin e banesave shtetërore’ dhe që i dorëzojnë apartamentin Entit Kombëtar të Banesave, vlera e apartamentit të ri do të llogaritet si në pikën 2, duke zbritur vlerën e*

*apartamentit të dorëzuar, të rivlerësuar sipas çmimeve të Entit Kombëtar të Banesave.’ Pra, personi që ka përfituar njëherë nga privatizimi, nëpërmjet transferimit fiton statusin si i pastrehë dhe nëse dorëzon banesën e mëparshme, përfiton zbritje në banesën e re.*

*Për sa më sipër, nga Komisioni i është kërkuar mendim, informacion dhe dokumentacion edhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Entit Kombëtar të Banesave, Drejtorisë Ekonomike, ku në përgjigje, nga Drejtori i Përgjithshëm, në vlerësimin tim, nuk ka referuar asnjë shkelje ligjore në bërjen e kësaj blerjeje nga ana ime. Konkretisht, pasi janë cituar kontratat përkatëse, ku drejtori ka konkluduar: ‘Referuar pikës 1 të shkresës suaj, ju bëjmë me dije se në VKM-në nr. 291, datë 21.6.1994, i ndryshuar, mbi bazën e të cilit është lidhur kontrata me z. Gjovalin Përnoca, konkretisht në pikën 2, është përcaktuar: ‘Qytetarët që kanë përfituar nga ligji nr. 7652, datë 23.12.1992, ‘Për privatizimin e banesave shtetërore’, si ushtarakë, të transferuar, persona shtetërorë, etj., vlera e apartamentit të ri do të llogaritet sipas kostos reale të ndërtimit në momentin e shitjes, e konvertuar me vlerën e dollarit në atë moment.*

*Referuar pikës 2 të shkresës suaj, në legjislacionin në fuqi, në periudhën që z. Gjovalin Përnoca ka përfituar apartamentin nëpërmjet EKB-së Shkodër, nuk ka pasur kufizime ligjore për sa i përket tjetërsimit të banesës, pas përfitimit të pronësisë mbi të nga ana e qytetarit.*

*Pra, nga vetë organi kompetent për administrimin e banesave të Entit, nuk konsiderohem që të jem në shkelje të ligjit.”*

### **Konkluzion (në lidhje me ligjshmërinë e privatizimit të apartamentit në Shkodër)**

**Shumica e trupit gjykues, pasi mori në analizë shpjegimet dhe provat e vëna në dispozicion nga subjekti, konkludon se subjekti i rivlerësimit arriti të shpjegojë bindshëm përfitimin në mënyrë të ligjshme të apartamentit në qytetin e Shkodrës.**

2. Në lidhje me dyshimet e Komisionit për caktimin e një çmimi fiktiv prej 30.000 USD në kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 11.11.1997, midis subjektit dhe shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në një kohë kur, referuar VKM-së nr. 13, datë 5.1.1998, për caktimin e kostove mesatare vjetore të ndërtimit për vitet 1996, 1997, apartamenti vlerësohej në vlerën 14.250 lekë/m<sup>2</sup> x sip. 78.5 m<sup>2</sup> = 1.118.625 lekë, subjekti ka shpjeguar dhe dokumentuar se: “Apartamenti në qytetin e Shkodrës është blerë nga EKB-ja, fillimisht me kontratën e përkohshme të shitblerjes datë 25.9.1996, duke u paguar si paradhënie (me mandatarkëtim) shuma prej 35.000 lekësh dhe më pas me kontratën për shitje apartament banimi me pagesë të menjëhershme në datën 6.11.1997, për vlerën 1.248.167 lekë, duke përfituar edhe 30 % të vlerës, për shkak të pagesës së menjëhershme të çmimit, sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 4, datë 9.1.1995.

*Në datën 11.11.1997, me kontratën nr. \*\*\*, apartamenti i është shitur shoqërisë ‘\*\*\*\*’ sh.p.k., me vlerën prej 30.000 USD.*

*Vendimin për ta shitur shtëpinë e morëm pasi me situatën e vitit 1997, si i huaj në qytetin e Shkodrës, nuk e shikoja me perspektivë punën dhe jetesën në këtë qytet. Administratori i entit blerës, z. Gj.L., e kishte prezantuar me blerësit që ishin investitorë italianë, të cilëve iu përshtatej pozicioni i apartamentit pranë një fabrike fasonerie ku ata ushtronin aktivitetin e tyre, për interesat e biznesit dhe sidomos për sigurinë fizike të tyre, në kushtet e mungesës së rendit... Pra, ishte kjo situatë e jashtëzakonshme e rendit, që i bëri investitorët italianë që ta blejnë realisht më shtrenjtë këtë banesë, vetëm se ajo ishte pranë repartit të punës së tyre.”*

Subjekti ka depozituar në cilësinë e provës certifikatën për vërtetim pronësie, të lëshuar në datën 12.5.2009 për apartamentin me sip. 78.5 m<sup>2</sup>, me të cilën kjo pasuri është e regjistruar si pronë e subjektit “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe në kartelën e pasurisë, bashkëlidhur certifikatës, në rubrikën “shuma e paguar”, është shënuar shuma 30.000 USD, gjë që rikonfirmon të njëjtin çmim real të kontratës datë 11.11.1997 të shitjes së kësaj banese.

**3.** Në lidhje me dyshimet e Komisionit mbi pagesën e tatimit në burim mbi të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. në datën 11.11.1997, me çmimin 30.000 USD, subjekti, pas kalimit të barrës së provës, ka argumentuar: *“Lidhur me detyrimin për pagesën e tatimit në burim për këtë transaksion pranë ZVRPP-së, kontrata e shitjes së apartamentit në Shkodër me blerëse firmën italiane ‘\*\*\*’ sh.p.k., e lidhur në datën 11.11.1997, menjëherë, në datën 12.11.1997 është bërë regjistrimi i kësaj prone në hipotekë, në favor të firmës ‘\*\*\*’, çka provohet me dokumentin e depozituar si provë, vërtetim pronësie datë 12.11.1997, i lëshuar nga zyra e hipotekës Shkodër, me të cilën është regjistruar (nr. \*\*\* pronësie, datë 12.11.1997) banesa në fjalë, në pronësi të ndërmarrjes ‘\*\*\*’ sh.p.k. Me këtë dokument vërtetohet se nga njëra prej palëve (shitësi ose blerësi), është paguar tatimi mbi shitjen, pasi në të kundërt, nuk mundet që të nesërmen e kontratës së shitjes të bëhet edhe regjistrimi në hipotekë në favor të blerësit.”*

### **Konkluzion**

**Në lidhje me pikat 2 dhe 3 të barrës së provës, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dokumentoi dhe shpjegoi në mënyrë të qartë dyshimet e ngritura nga Komisioni në lidhje me çmimin e pasqyruar në kontratën e shitblerjes së subjektit me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., si dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga subjekti nëpërmjet kësaj kontrate shitblerjeje.**

Analizë financiare për blerjen e shtëpisë së banimit në Shkodër me vlerë 1.248.167 lekë.

Viti	Të ardhurat subjekti	Të ardhurat bashkëshortja	Total	Shpenzime	Kursime
1982	2,330		2,330	1,631	699
1983	7,360		7,360	5,152	2,208
1984	8,160		8,160	5,712	2,448
1985	8,260		8,260	5,782	2,478
1986	8,400		8,400	5,880	2,520
1987	8,440		8,440	5,908	2,532
1988	8,640		8,640	6,048	2,592
1989	9,120		9,120	6,384	2,736
1990	9,440		9,440	6,608	2,832
1991	10,975		10,975	7,683	3,293



1992	24,834		24,834	17,384	7,450
1993	73,032		73,032	51,122	21,910
1994	76,500	52,274	128,774	90,142	38,632
1995	228,000	15,842	243,842	170,689	73,153
1996	276,023	18,191	294,214	205,950	88,264
1997	283,524		283,524	198,467	85,057
Total	1,043,038	86,307	1,129,345	790,542	338,804

Në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 subjekti ka deklaruar si burim krijimi kursimet e 15 viteve punë, si dhe shumën e kursyer nga dietat e përfituara për periudhën maj – qershor 1993 nga shërbimi në SHBA.

Në tabelën e mësipërme janë marrë në analizë të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortes, referuar vërtetimeve përkatëse të depozituara nga subjekti.

Për vitin 1994 paga mujore është përlllogaritur sa paga e tetorit të vitit 1993, ndërsa për vitin 1995 paga mujore është përlllogaritur sa paga e janarit të vitit 1996, për shkak të djegies së arkivës së institucionit gjatë trazirave të vitit 1997.

Sipas analizës rezulton se mundësia për të kursyer për periudhën 1982 – 1997 është në shumën 338.804 lekë. Kjo shumë nuk shërben si burim i mjaftueshëm financiar për blerjen nga privatizimi i shtëpisë në Shkodër në vlerën 1.248.167 lekë.

**Subjekti, pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni në lidhje me:** “Mungesë të ardhurash të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e shtëpisë në Shkodër referuar analizës financiare në rend kronologjik”, ka shpjeguar po në rend kronologjik të ardhurat e përfituara prej tij dhe personit të lidhur me të bashkëshortes së tij<sup>27</sup>:

**Subjekti ka vijuar me shpjegime në lidhje me shpenzimet jetike:** “... shpenzimet jetike më janë përlllogaritur sa 70 % e pagës, kur normalisht, referuar viteve që ju perkasin, ato nuk mund të ishin më të mëdha se 30% e pagës (subjekti jep si argumenta bashkëjetesën me

<sup>27</sup> “Nga ana ime, si në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003 ashtu edhe në atë “Vetting”, të vitit 2017 kam deklaruar si burim krijimi kursimet e 15 viteve punë si dhe shumën prej 2.400 USD, të kursyer nga dietat e përfituara për periudhën maj-qershor 1993 nga shërbimi në USA ku jam trajtuar me një dietë ditore prej 140 USD në ditë...Për të njëjtin qëllim, kam sjellë si provë edhe një vërtetim, datë 8.8.2019, të zj. M.P. (gruaja e kushëririt tim Z.P., i cili është në spital dhe nuk mund të lëshojë vetë vërtetim) e shoqëruar me fotokopje të pasaportës Amerikane të saj, me të cilën ajo ka vërtetuar se unë kam qenë mysafir në banesën e tyre në Neë York në maj të vitit 1993. Kjo tregon se për një javë nuk kam shpenzuar për fjetje dhe ushqim...

Lidhur me periudhat e punësimit që provojnë të ardhurat e mia dhe bashkëshortes time, unë kam marrë prova të reja që rapojnë se në Aktverifikimin e vjetërsisë për punë para vitit 1994, Lezhë, A.P. figuron në punë nga 14.2.1988 - 30.06.1990, 1.7.1990 - 5.2.1991, 26.3.1991 - 30.9.1991, 1.10.1991 - 31.9.1996, por nuk ka bordoro të Ndërmarrjes Elektrike për vitet 1988-1993. Për këtë periudhë, duhet përlllogaritur paga e saj me përfaqësi. Po ashtu, sipas Vërtetimit dt.23.7.2019 të Zyres Vendore të Punësimit, Mirditë, del se A.P. është paguar nga tetori i vitit 1996 - shtator 1997, gjithsej 49.200 lekë. Mendoj se për periudhat e tjera të pretenduara, të cilat janë të shënuara në librezën e punës dhe të konfirmuara edhe për ato duhet përlllogaritur paga e saj me përfaqësi, pasi librezë e punës është dokument zyrtar”.

prindërit, konsum të ulët dhe kostot e ulëta të jetesës në Kukës dhe Mirditë, ndihma me produkte bujqësore të siguruara nga një tokë në pronësi të babait në fshatin \*\*\*, Mirditë).

*“...në vitin 1995, përveç pagës, kam përfitur edhe dietë për një periudhë 6-mujore, sipas VKM nr. 549, datë 7.11.1994, pasi isha emëruar në një rreth tjetër jashtë vendbanimit tim, vërtetuar me deklaratë noteriale, datë 9.8.2019, të ish -Drejtorit të Drejtorisë Ekonomike të Ministrisë së Drejtësisë, z. N.M. (M.).”*

Sipas deklaramentit të tij, subjekti, e ka disponuar këtë shumë (për blerjen e apartamentit) nga të ardhurat e kursimet e familjes, për një periudhë 15-vjeçare që prej vitit 1982, duke i shtuar kësaj shume edhe rreth 200.000 lekë të cilat deklaroi se ia ka marrë të vëllait V., i cili, i kishte të lira paratë e shitjes së shtëpisë së Kukësit, në vlerën prej 1.050.000 lekësh që prej datës 30.8.1995, çka e vërteton me deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 24.7.2019, të cilën do ta gjeni bashkëlidhur. Prandaj mendoj se provohet se ka ekzistuar mundësia për të kursyer për periudhën 1982 – 1997, në vlerën prej 1.248.167 lekësh.

Subjekti ka vijuar me shpjegime për sa i përket shpenzimeve, të ardhurave ndër vite, si dhe kursimeve të tij<sup>28</sup>: *“...nisur nga mundësia për të kursyer shumën prej 923.587 lekësh për periudhën 1982 – 1997 duke shtuar edhe dietat e përfituara në periudhën maj – qershor 1993 në shumën 2.400 USD këmbyer me kursin e datës 6.11.1997, 143.85, vlera e konvertuar është 345,240 lekë, si dhe dietat e llogaritura më lartë në vlerën 90.000 lekë, rezultoi se kam pasur mundësi kursimi në shumën 1.358.847 lekë, duke përballuar pagesën për apartamentin në Shkodër në vlerën 1.248.167 lekë dhe diferenca 110.680 lekë ka shërbyer si kontribut për blerjen e apartamentit në Rrëshen. Megjithatë, duke marrë parasysh edhe borxhin e marrë nga*

---

<sup>28</sup> *“Për periudhën 2003 – 2008 shpenzimet jetike nuk kanë zënë më shumë se 30 % të të ardhurave dhe për efekt të llogaritjes së tyre duhet të merret si raport 30% ndaj të ardhurave ashtu siç rezultoi edhe nga minimumi jetik sipas ILDKPI-së në raport me të ardhurat familjare nga paga për periudhën 2003 – 2008 por edhe nga shpenzimet e llogaritura nga Komisioni për vitin 2002, ku paga 1.8.2002 rezultoi të jetë 204.929 lekë dhe shpenzimet 50.000 lekë me një koeficient 24.4 % të raportit shpenzime /të ardhura. Për periudhën 1.10.2002 – 31.12.2002 të ardhurat nga paga janë në shumën 337.493 lekë ndërkohë shpenzimet e llogaritura nga Komisioni 75.000 lekë, duke zënë rreth 22.2 % të të ardhurave. Për këtë arsye duke qënë se raporti i shpenzimeve ndaj të ardhurave sipas shpenzimeve jetike të ILDKPI-së janë rreth 30 % deri në vitin 2008 duhet që edhe për periudhën 1982 – 1997 (ku deri në vitin 1996 kam jetuar sëbashku me prindërit) të llogariten 30% të të ardhurave nga paga për mua dhe bashkëshorten time.”*

*“Kam siguruar si provë Aktverifikim i vjetërsisë në punë para vitit 1994 me nr. \*\*\* prot., datë 24.7.2019 i Arkivës DRSSH-së Lezhë ku vërtetohet se bashkëshortja ime A.P. ka qënë e punësuar, por që nuk disponon bordero për periudhën 1988 – 1993 për të vërtetuar bazën e të ardhurave për këtë periudhë. Në mungesë të këtij dokumentacioni dhe për të kryer një analizë sa më afër realitetit kam llogaritur se të ardhurat e bashkëshortes time për vitin 1994 kanë qënë 52.274 lekë ose rreth 70 % të pagës time për këtë vit 76.500 lekë. Kështu që për periudhën mars 1988 – dhjetor 1993 pagën e bashkëshortes po e llogaris sa 70 % e pagës sime. Me vërtetimin për bazën e vlerësueshme për periudhën 1.1.1994 – 30.9.1996 të datës 19.7.2019 vërtetohet se për periudhën maj 1995 – mars 1996 bashkëshortja ka përfitur lejelindje. Për këtë periudhë llogaris përfitimet nga lejelindjes si 80 % të pagës bruto të vitit 1994, dhe të ardhurat për vitin 1995 të bashkëshortes janë 15.842 lekë + 33.923 lekë (63.605 paga bruto 1994 \* 80 %\*8muaj/12muaj), total 49.765 lekë. Për vitin 1996, përfitimet nga lejelindje për janar – mars 1996 janë 12.721 lekë (63.605 paga bruto 1994 \* 80%\*3muaj/12muaj) + 18.191 lekë +12.300 lekë (sipas vërtetimit nr. \*\*\*, datë 23.7.2019), në total të ardhurat e bashkëshortes për vitin 1996 janë 43.212 lekë. Për vitin 1997 sipas vërtetimit nr. \*\*\*, datë 23.7.2019 janë 36.900 lekë.*

vëllai V., tregohet qartë se kam pasur mundësi financiare dhe të ardhura të ligjshme për të blerë apartamentin në Shkodër.”

Pas vlerësimit të shpjegimeve dhe dokumentacionit të depozituar nga subjekti, në lidhje me mundësinë financiare për blerjen e apartamentit në Shkodër, të sqaruara në pikat a-d në faqen 20-11 të vendimit, analiza financiare ndryshon, si më poshtë:

Data	Përshkrim	Vlera
	Të ardhurat nga pagat 1982 – 1997	1.319.409
20.12.1993	Blerje banese Rrëshen	-28.214
	Shpenzime jetike 1982 – 1997	-923.586
2.11.1997	Marre hua vëllait, V. P.	200.000
6.11.1997	Blerje banese në Shkodër	-1.248.167
6.11.1997	Kursime nga udhëtimi në SHBA 7 ditë * 135 USD/dita me kurs 143.85	135.938
	<b>Gjendja financiare më 6.11.1997</b>	<b>-544.620</b>

### Konkluzion

**Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë pasur burime financiare të ligjshme të pamjaftueshme, për blerjen e apartamentit të banimit në Shkodër, në shumën - 544.620 lekë.**

**Subjekti i rivlerësimit dhe babai tij kanë pasur burime financiare të ligjshme të pamjaftueshme, për blerjen e banesës në Rr. “\*\*\*\*” në shumën totale - 1.410.000 lekë.**

**3. Automjeti tip “Kia”, me targa \*\*\*, me kontratë shitblerje nr. \*\*\*, datë 28.1.2008, me shitës B.Z.**

Vlera: 500.000 lekë. Pjesa takuese: 50 % me bashkëshorten.

Burimi i krijimit: nuk deklarohet burim krijimi.

### Hetimi i kryer nga Komisioni

Komisioni ka kryer korrespondencë me DPSHTRR-në<sup>29</sup>.

Në deklaratën periodike të vitit 2008 subjekti ka deklaruar: “Autoveturë ‘KIA’, me targa \*\*\*, blerë me çmimin 500.000 lekë”. Subjekti nuk ka deklaruar burim krijimi.

Nga dokumentacioni i përcjellë nga DPSHTRR-ja rezulton se mjete tip “KIA” është shitur nga shoqëria “\*\*\*\*” në Seul Korea shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., për vlerën 8.189 euro, në datën 31.7.2006 (8.189 euro x 122.75 lekë kursi ditor = 1.005.199 lekë). Shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., ka paguar edhe doganën për këtë mjet në shumën 230.663 lekë.

Shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., ia ka shitur këtë automjet shtetasit B.Z. në shumën 1.386.450 lekë, në datën 28.2.2007.

Shtetasi B.Z. ia ka shitur këtë automjet subjektit Gjovalin Përnoca në datën 28.1.2008 (me kontratën nr. \*\*\*), me çmimin 500.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

<sup>29</sup> Shkresa nr. \*\*\*prot., datë 14.1.2019, e DPSHTRR-së; shkresa nr. \*\*\*prot., datë 31.12.2018.

Pra, pas 11 muajsh shtetasi B.Z. ia ka shitur subjektit Gjovalin Përnoça automjetin për 886.450 lekë më pak se vlera që e ka blerë vetë më parë.

Subjekti ka dhënë shpjegime në lidhje me burimin e krijimit të të ardhurave për blerjen e automjetit në shumën 500.000 lekë, datë 28.2.2008, duke identifikuar si burim *kursimet nga pagat e vitit 2007*.

Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007 subjekti deklaroi kursime në *cash* në shumën 900.000 lekë. Kjo shumë është burim i mjaftueshëm për blerjen nga subjekti të automjetit me targa \*\*\*, për shumën 500.000 lekë, në datën 28.1.2008. Pas hetimit të Komisionit u konstatua se deklarimi i subjektit është i saktë. Sipas analizës financiare subjekti rezultoi me balancë pozitive për vitin 2007.

Komisioni ngriti dyshime për veprim fiktiv në lidhje me përcaktimin e çmimit prej 500.000 lekësh në kontratën e shitblerjes së automjetit datë 28.1.2008, krahasuar me çmimin e blerjes së këtij automjeti nga shitësi dhe kohën e shkurtër brenda të cilit ky automjet i është shitur subjektit.

Subjekti ka shpjeguar se arsyet e shitjes me këtë çmim prej blerësit kanë të bëjnë me gjendjen teknike dhe vizuale të automjetit, kilometrat e shumta që kishte bërë krahasuar me kohën e përdorimit, si dhe fakti se automjeti ishte blerë nga shitësi për motrën e tij, por duke qenë me kambio manuale nuk ishte i preferueshëm për femrat.

### **Konkluzion**

**Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë pasur mjetet e duhura financiare për kryerjen e këtij investimi.**

**Subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me dyshimin e ngritur nga Komisioni mbi caktimin e një çmimi fiktiv midis shitësit dhe blerësit në kontratën e shitblerjes së këtij automjeti.**

- 4. Pyll me sip. 1.000 m<sup>2</sup>, në Malin e \*\*\*, në emër të bashkëshortes A.P., blerë në datën 15.7.2010 me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, me shitës O.P**  
Vlera: 186.000 lekë. Pjesa takuese: 50 % me bashkëshorten.

Burimi i krijimit: nga të ardhurat për vitin 2010, në vlerën 2.794.849 (ndërsa shpenzimet ishin 1.700.000 lekë bashkë me pyllin).

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Komisioni ka kryer korrespondencë me ZVRPP-në Lezhë<sup>30</sup>, e cila ka përcjellë dokumentacionin për regjistrimin e pasurisë “pyll” me sip. 1.000 m<sup>2</sup>, në emër të znj. A.P.

Sipas kontratës së shitblerjes së pasurisë nr. \*\*\*, datë 15.7.2010, shitësi O.P. i shet blerëses A.P. pasurinë e llojit “pyll”, me sip. 1000 m<sup>2</sup>, e ndodhur në Malin e \*\*\*, e regjistruar në ZVRPP-në Lezhë me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, për çmimin 186.000 lekë.

---

<sup>30</sup> Shkresa nr. \*\*\*prot., datë 12.6.2019, e ZVRPP-së Lezhë, drejtuar Komisionit.

Duke marrë në konsideratë afërsinë e kësaj pasurie me vijën bregdetare, Komisioni ngriti dyshime në lidhje me çmimin e pasqyruar në kontratën e shitblerjes, duke e konsideruar si çmim fiktiv.

Subjekti, në shpjegimet e tij, ka argumentuar se kjo pasuri ndodhet në largësi të konsiderueshme nga vija bregdetare dhe është një zonë pa infrastrukturë urbane, duke vënë në dispozicion të Komisionit kontrata shitblerjeje të ngjashme, ku konstatohet i njëjti çmim shitjeje për m<sup>2</sup> dhe njëkohësisht më i lartë se çmimi i referencës, i përcaktuar në Udhëzimin përkatës të Këshillit të Ministrave.

## **Konkluzion**

**Komisioni, pasi mori në analizë dokumentacionin dhe shpjegimet e subjektit, i konsideroi ato të mjaftueshme, duke mos konstatuar ndonjë problematikë në lidhje me këtë pasuri.**

### **5. Automjet tip “Golf”, me targa \*\*\*, në emër të bashkëshortes A.P., me kontratë shitblerje nr. \*\*\*, datë 14.10.2014, me shitës A.S.**

Vlera: 7.000 euro. Pjesa takuese: 50% me bashkëshorten.

Burimi i krijimit: nuk deklarohet burimi i krijimit.

## **Hetim i kryer nga Komisioni**

Në praktikën e përcjellë nga DPSHTRr-ja<sup>31</sup> për automjetin tip “Golf”, me targa \*\*\*, konstatohet se me kontratën e shitblerjes, datë 12.8.2014<sup>32</sup>, shtetasja L.K. ia ka shitur këtë automjet blerësit A.S. për çmimin 9.000 euro.

Me kontratën e shitblerjes, datë 14.10.2014<sup>33</sup>, shtetasi A.S. ia shet këtë automjet blerëses A.P. me çmimin 7.000 euro.

Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, burim i cili nuk është deklaruar në deklaratën “Vetting”, si dhe në dokumentacionin ligjor përkatës.

Subjekti, në përgjigje të tij, ka shpjeguar: “ ...në datën 14.10.2014 është tërhequr nga ‘Raiffeisen Bank shuma 7.100 euro për këtë blerje ... Ndërsa, mënyra e krijimit të kësaj llogarie në ‘Raiffeisen Bank’ dhe lëvizja e saj janë të shpjeguara në deklaratat vjetore, që nga deklarimi për vitin 2013 e në vijim ”.

Pas verifikimit të kryer nga Komisioni në llogarinë rrjedhëse me nr. \*\*\* në \*\*\* në datën 13.10.2014, ka rezultuar një kreditim në shumën 7.094,51 euro.

Në datën 14.10.2014 subjekti ka tërhequr *cash* shumën 7.000 euro, e cila ka shërbyer si burim krijimi për blerjen e automjetit.

Komisioni ka ngritur dyshime në lidhje me çmimin real të përcaktuar në kontratën e shitblerjes së këtij mjeti, për arsye se pas vetëm dy muajsh nga blerja e automjetit për çmimin 9.000 euro, blerësi A.S. ia shet personit të lidhur me subjektin, bashkëshortes A.S. për çmimin 7.000 euro, pra, 2.000 euro më lirë.

<sup>31</sup> Shkresa nr. \*\*\*prot., datë 31.12.2018, e DPSHTRR-së; shkresa nr. \*\*\*prot., datë 14.1.2019; shkresa nr. \*\*\*prot., datë 14.5.2019, e DPSHTRR-së; shkresa nr. \*\*\*prot., datë 14.5.2019, e DPSHTRR-së.

<sup>32</sup> Kontrata e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 12.8.2014.

<sup>33</sup> Kontrata e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 14.10.2014.

Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka argumentuar se nuk kishte dijeni në lidhje me çmimin real të blerjes së këtij automjeti nga shitësi A.S., por se e ka blerë me çmimin real të tregut për këtë lloj automjeti në atë periudhë. Edhe nga dokumentet rezulton se fillimisht ky automjet është blerë në Itali nga L.K. për çmimin 2.100 euro.

### Konkluzion

**Komisioni, pasi mori në analizë dokumentacionin dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, i konsideron ato të mjaftueshme duke mos konstatuar ndonjë problematikë në lidhje me këtë pasuri.**

6. **Automjet tip “Opel”, me targa \*\*\*, në emër të bashkëshortes A.P., shitur në vlerën 200.000 lekë (e blerë me kontratën nr. \*\*\*, datë 7.12.2004, për 240.000 lekë).**

Burim krijimi: kursime nga pagat.

### Hetim i kryer nga Komisioni

Nga dokumentacioni i përcjellë nga DPSHTRr-ja<sup>34</sup> rezulton se në datën 7.12.2004 shtetasi A. R., i ka shitur automjetin “Opel Corsa” blerëses A.P. me çmimin 240.000 lekë e cila në datën 6.12.2005, ia ka shitur këtë automjet blerësit A .K për çmimin 200.000 lekë.

Në deklaratën periodike të pasurisë së vitit 2004, subjekti ka deklaruar: “*Autoveturë ‘Opel Corsa’ benzinë, me dyer me fuqi 1.4, me vlerë 240.000 lekë + 130.000 lekë = 370.000 lekë*”.

Subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit.

Në lidhje me këtë mosdeklarim të burimit të krijimit, subjekti ka deklaruar se të ardhurat nga pagat kanë qenë të mjaftueshme për blerjen e këtij automjeti.

### Analizë në lidhje me burimin e krijimit sipas deklarimeve të subjektit

Përshkrimi	2004
<b>Të ardhurat</b>	<b>2.222,655</b>
Të ardhura nga paga e subjektit	1.559,017
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	653.288
<b>Detyrime</b>	<b>0</b>
<b>Shpenzime</b>	<b>469.820</b>
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	469.820
<b>Pasuri</b>	<b>664.135</b>
Likuiditete	-205.865
Automjet tip “Benz 220”, ***	500.000
Automjet tip “Opel Corsa” ***	370.000
<b>Të ardhura + detyrime - shpenzime – pasuri</b>	<b>1.083,533</b>

<sup>34</sup> Shkresa nr. \*\*\*prot., datë 31.12. 2018, e DPSHTRr-së; shkresa nr. \*\*\*prot., datë.14.1.2019.

Sipas analizës financiare duket se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të përballuar shpenzimet dhe për të krijuar pasuri në vitin 2004.

### **Konkluzion**

**Komisioni, pasi mori në analizë dokumentacionin dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti në lidhje me këtë pasuri, e gjeti atë të plotë duke mos konstatuar ndonjë problematikë.**

**Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë pasur të ardhura të ligjshme, të mjaftueshme për të krijuar këtë pasuri.**

#### **7. Llogari në “Raiffeisen Bank” me gjendje aktuale në datën 19.1.2017, në shumën 30.902 euro**

Burimi i krijimit: kursimet nga pagat dhe nga qiratë ndër vite (të shpjeguara në deklaratimet vjetore); dhe pjesërisht nga anulimi i kontratës së shitjes në Sarandë.

#### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Nga verifikimi i llogarisë bankare nr. \*\*\*, në “Raiffeisen Bank”, në emër të z. Gjovalin Përnoca, në datën 31.12.2016, u konfirmua balanca prej 30.902,93 euro.

Në këtë llogari, gjatë vitit 2013, është depozituar shuma në total prej 45.500 euro, shumë kjo e deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013, e cila më pas është investuar në fondin e investimit në “Raiffeisen Invest”. Në vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016 nga ky investim janë kthyer në llogari shumat, duke krijuar në datën 31.12.2016 këtë balancë.

Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit në lidhje me burimin e krijimit të shumave 3.500 euro, 6.000 euro dhe 4.000 euro, të depozituara në llogarinë rrjedhëse në “Raiffeisen Bank” në datat 21.5.2013, 29.5.2013 dhe 17.6.2013.

Subjekti, në përgjigje të tij, ka deklaruar se: “... depozita e datës 21.5.2013 është krijuar nga kursimet nga pagat dhe qiraja e banesës e muajve janar - prill 2013, ndërsa depozitat e datave 29.5.2013 dhe 17.6.2013, ku janë depozituar respektivisht 6.000 dhe 4.000 euro janë krijuar në sasinë prej 9.000 euro nga marrja e huas nga vëllai një ditë më parë më 28.5.2013, ndërsa, sasia prej 1.000 euro përsëri është plotësuar nga kursimet nga pagat, qiraja e banesës e një muaji (nga 25.5.2013 – 17.6.2013)”.

<b>Përshkrimi</b>	<b>Viti 2013</b>
<b>Të ardhurat</b>	<b>8,715,496</b>
Të ardhura nga paga e subjektit	1,896,890
Të ardhura nga paga bashkëshortes	907,553
Të ardhura nga investimi	3,703
Të ardhura nga shitja e automjetit	1,000,000
Të ardhura nga anulimi i kontratës	4,907,350
<b>Detyrime</b>	<b>0</b>
<b>Shpenzime</b>	<b>3,975,157</b>

Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	1,236,166
Shpenzime jetese për diferencë deklaruar nga subjekti	363,834
Shpenzime udhëtimi	172,458
Shpenzime për shkollën në Angli + UET, K.P.	1,501,649
Shpenzime për hua	701,050
<b>Pasuri</b>	<b>4,856,616</b>
Likuiditete	4,856,616
<b>Të ardhura + detyrime - shpenzime – pasuri</b>	<b>-116,278</b>

### Komisioni arriti në përfundimin se:

Shuma prej 30.902 euro ka si burim krijimi kthimin nga fondi i investimit në “Raiffeisen Invest” në datën 5.10.2016, konfirmuar kjo nga “Raiffeisen Invest”.

Nga analiza financiare e vitit 2013 rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk kanë pasur burime të ligjshme financiare në shumën -116.278 lekë për të përballuar shpenzimet dhe për të kryer investimet përkatëse për këtë vit (nuk është marrë në analizë e ardhura nga qiraja për periudhën 1.3.2013 – 4.2.2014, pasi subjekti ka deklaruar se nuk është paguar as 3 muaj qira; vlera bruto është 17.000 lekë/muaj).

Pas kalimit të barrës së provës subjekti ka shpjeguar, si më poshtë:

*“Në vitin 2013 nuk janë njohur të ardhurat nga qiraja për periudhën 1.3.2013 – 31.12.2013, për 10 muaj (për vlerën prej 17.000 lekësh në muaj x 10 muaj = 170.000 lekë bruto), pasi nuk kam paguar tatimin në burim. Pasi ka vazhduar me shpjegimet për të drejtën që i njeh legjislacioni tatimor për pagesën e tatimit në burim në një kohë të mëvonshme subjekti ka dorëzuar si provë dokumentin ‘urdhërpagesë’ datë 7.8.2019, për 31.710 lekë, si dhe ‘mandatarkëtimin’, datë 7.8.2019, të ‘Raiffeisen Bank’ për 31.910 lekë.*

*Shpenzimet e udhëtimit nuk duhen marrë në konsideratë veçmas, pasi janë të përfshira në shpenzimet totale të deklaruara në vlerën 1.600.000 lekë.*

*Subjekti, sipas analizës financiare të kryer nga eksperti kontabël për vitin 2013, rezulton të jetë me një balancë financiare pozitive prej + 119.645 lekësh, duke përfshirë në këtë analizë edhe huan e dhënë nga shtetasi S.N.”*

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit pas dërgimit të rezultateve të hetimit, arrin në konkluzionin se pretendimi i subjektit për njohjen e të ardhurës nga qiraja në vitin 2013 nuk qëndron, pasi lidhja e marrëveshjes së qirasë midis tij dhe qiramarrësit, shtetasit A. J. është një veprim i drejtpërdrejtë i kryer nga subjekti i rivlerësimit, i cili sipas legjislacionit tatimor ka pasur detyrimin për pagesën e tatimit, detyrim të cilin nuk e ka përmbushur në momentin e krijimit të të ardhurës nga qiraja dhe për më tepër që ky detyrim është paguar për efekt të procesit të rivlerësimit, pas plotësimit të deklaratës “Vetting” dhe pas bërjes me dije nga Komisioni<sup>35</sup>. Në këto kushte kjo e ardhur nuk konsiderohet e ligjshme sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

<sup>35</sup> Shikoni vendimin nr. \*\*\*, datë 16.4.2019 të KPA-së, pika \*\*\*, për subjektin e rivlerësimit, z. A.N.



Analiza e rishikuar për vitin 2013, pas marrjes në konsideratë të shpjegimeve dhe dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit, ndryshon si më poshtë:

<b>Përshkrimi</b>	<b>2013</b>
<b>Të ardhurat</b>	<b>8.715.496</b>
Të ardhura nga paga e subjektit	1.896.890
Të ardhura nga paga bashkëshortes	907.553
Të ardhura nga investimi	3.703
Të ardhura nga shitja e makinës	1.000.000
Të ardhura nga anulimi i kontratës	4.907.350
<b>Detyrime</b>	<b>825.111</b>
Hua S.N.	825.111
<b>Shpenzime</b>	<b>3.975.157</b>
Shpenzime jetese (shpenzimet sipas ILDKPKI -së dhe diferenca mbi këtë vlerë e deklaruar nga subjekti)	1.600.000
Shpenzime udhëtimi	172.458
Shpenzime për shkollën në Angli + UET K.P.	1.501.649
Shpenzime për hua	701.050
<b>Pasuri</b>	<b>4.856.616</b>
Likuiditete	4.856.616
<b>Të ardhura + detyrime - shpenzime – pasuri</b>	<b>708.833</b>

## **Konkluzion**

Komisioni arriti në përfundimin se pagimi i tatimit në burim nga subjekti i rivlerësimit për të ardhurën nga qiraja në vlerën prej 170.000 lekësh, për 10 muaj, pavarësisht deklarimit të subjektit se nuk ka përfituar as 3 muaj qira, është bërë sipas mandatarëkëtitimit datë 7.8.2019, të “Raiffeisen Bank” për vlerën prej 31.910 lekësh, pas plotësimit dhe depozitimit në ILDKPKI të deklaratës “Vetting”, për rrjedhojë, nuk e bindin Komisionin për ligjshmërinë e kësaj të ardhure, pasi duket qartë që kjo pagesë është bërë për efekt të procesit të rivlerësimit.

Analiza financiare e rishikuar nga Komisioni për vitin 2013, pasi mori në konsideratë huan e dhënë nga shtetasi S.N., si dhe nuk mori në konsideratë të ardhurat nga qiraja të subjektit për periudhën e përfituar (2 muaj) dhe pretendimet e subjektit për përfshirjen e shpenzimeve të udhëtimit në shumën e shpenzimeve totale të deklaruara prej tij në vlerën prej 1.600.000 lekësh, rezultoi përfundimisht me një balancë financiare pozitive prej 708.833 lekësh.

## **8. Të ardhurat nga qiraja**

Subjekti deklaroi përfitim nga qiraja për vitet 2009 – 2012, si më poshtë:

- Kontratë qiraje për periudhën 1.9.2009 – 3.1.2012, për gjysmën e shtëpisë, te Rr. “\*\*\*\*” me qiramarrës E. E., në vlerën 27.000 lekë (duhet të jetë lapsus, sepse i korrespondon vlera 17.000 lekë), ku pasi paguhet tatimi mujor 10 %, mbetet shuma 15.500 lekë/muaj. Për 28

muaj shuma totale është 43.400 lekë (duket lapsus i subjektit, pasi nga llogaritja vlera është 434.000 lekë).

- Kontratë qiraje për periudhën 1.3.2014 – 4.2.2014, për gjysmën e shtëpisë, te Rr. “\*\*\*”, nuk rezulton të jetë bërë pagesë tatimi në kohë reale.

Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar se: “... qiramarrësi, ku për 11 muaj, nuk ka paguar as 3 muaj”.

- Kontratë qiraje për periudhën 1.5.2015 e në vazhdim, për gjysmë e shtëpisë te Rr. “\*\*\*”, me qiramarrës J. A., në vlerën 17.000 lekë, ku konfirmohen pagesat e tatimit në burim.

## **Konkluzion**

**Komisioni arriti në përfundimin se për periudhën 1.3.2013 – 4.2.2014, subjekti nuk ka përfituar të ardhurën nga qiraja as për 3 muaj, si dhe pagesa e tatimit është bërë për një të ardhur që as nuk është përfituar dhe, për më tepër, është bërë pas plotësimit të deklaratës “Vetting”, pra, gjatë procesit të rivlerësimit.**

**Komisioni nuk vërejt ndonjë problematikë për periudhat 2009 – 2011 dhe 2015 – 2016, në lidhje me këtë deklaram duke qenë se rezultoi e paguar edhe pagesa e tatimit në burim në periudhat përkatëse.**

### **➤ Në lidhje me kontratën e porosisë për shtëpinë e plazhit të ndodhur në Sarandë**

Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën “Vetting”, ka deklaruar: “...lidhur me shtëpinë e Sarandës, pasi kemi rënë dakord me S.T., kushëri i imi, djali i baxhanakut që banon në Londër, që të blejmë një shtëpi plazhi të përbashkët. Meqë nuk vinte shpejt vetë, sipas bisedës me të më 24.2.2011, kam lidhur kontratë porosie me sipërmarrësin Nj.V., për një banesë me çmimin 50.000 euro, duke i dorëzuar 30.000 euro (këto lekë i kisha pasi ishin të ardhurat e viteve 2007 - 2010 = 4.300.000 lekë ose 30.000 euro).

Në datën 12.8.2011 ka ardhur S.T. (djali i baxhanakut që jeton në Londër) dhe kemi anuluar kontratën e sipërmarrjes dhe po aty kemi lidhur një kontratë tjetër nr. \*\*\* prot., nr. \*\*\* kol., ku porositës ishte Gjovalin Përnoca dhe S.T. për të njëjtën vlerë dhe S. T. më ktheu 5.000 euro dhe më vonë ka likuiduar edhe 20.000 euro, pasi secili kishte detyrimin 25.000 euro.

Me deklaratën noteriale datë 25.6.2013 vërtetohet se nga ne të dy janë shlyer detyrimet ndaj ndërtuesit, por ndërkohë nuk ishte vendosur ashensori, nuk kishte ujë, kishim më pak m<sup>2</sup> se në kontratë, kishte probleme me legalizimin, gjë që na bëri të anulojmë këtë kontratë me deklaratën noteriale të datës 26.6.2013, që e mori përsëri vetë ndërtuesi. **Palët u kthyen në gjendjen e mëparshme dhe për shkak të punimeve shtesë të bëra në papafingo dhe mobilim, hyrja u vlerësua me 70.000 euro, duke na dhënë 35.000 euro secilit (pra, ndërtuesi mori borxh me deklaratë noteriale 5.000 euro që nuk m'i ka kthyer më...).**”

## **Hetim i kryer nga Komisioni**

Subjekti ka depozituar dokumentacionin me përmbajtje, si më poshtë vijon:

Në datën 24.2.2011 është lidhur kontrata e sipërmarrjes<sup>36</sup> me sipërmarrës z. Nj.V. dhe investitor z. Gjovalin Përnoca, për ndërtimin e një hyrje banimi (papafingo) me sip. të

<sup>36</sup> Kontrata nr. \*\*\*, datë 24.2.2011.

përgjithshme 165 m<sup>2</sup>, nga të cilat hyrja e banimit është me sip. 100 m<sup>2</sup> dhe veranda me sip. 65 m<sup>2</sup>, me vlerë totale 50.000 euro. Në kontratë parashikohet se me nënshkrimin e saj është paguar shuma 30.000 euro; shuma 10.000 euro do të jepet kur të vendosen pllakat e hyrjes së banimit brenda datës 20.3.2011; ndërsa pjesa tjetër 10.000 euro në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes. Afati i dorëzimit të hyrjes është deri në datën 30.4.2011.

Në deklaratën noteriale të datës 12.8.2011<sup>37</sup> sipërmarrësi Nj.V. dhe z. Gjovalin Përnoca deklarojnë anulimin e kontratës së sipërmarrjes dhe se ky akt juridik nuk prodhonte asnjë pasojë juridike.

Në datën 12.8.2011 është nënshkruar kontrata e sipërmarrjes<sup>38</sup> me sipërmarrës z. Nj.V. dhe investitorë z. Gjovalin Përnoca dhe z. S.T. për të njëjtin apartament banimi, me vlerë totale 50.000 euro dhe me të njëjtat kushte si kontrata e sipërmarrjes e lidhur në datën 24.2.2011.

Në deklaratën noteriale të datës 25.6.2013<sup>39</sup>, me deklarues shtetasit Nj.V. dhe Gjovalin Përnoca, subjekti deklaron se ai dhe S.T. i kanë likuiduar palës shitëse të gjithë shumën e mbetur *cash* jashtë zyrës noteriale, duke mos pasur më asnjë pagesë dhe asnjë pretendim ndaj palës sipërmarrëse, dhe z. Nj.V. deklaron se nga pala blerëse janë paguar të gjitha detyrimet dhe se me nënshkrimin e kësaj deklarate janë likuiduar totalisht.

Në deklaratën noteriale të datës 26.6.2013<sup>40</sup>, shtetasit Nj.V., Gjovalin Përnoca dhe S. T., ndër të tjera, kanë deklaruar se vlera totale e hyrjes së banimit është 50.000 euro, por, bashkë me punimet e tjera të kryera nga blerësit, vlera e hyrjes së banimit është shtuar dhe me 20.000 euro dhe vlera totale është 70.000 euro.

Me këtë deklaratë palët kanë anuluar kontratën e sipërmarrjes datë 12.8.2011, duke u kthyer në gjendjen e mëparshme, pra, z. Nj.V. u jep shtetasve Gjovalin Përnoca dhe S.T. vlerën prej 70.000 euro dhe këta të fundit lejojnë z. Nj.V. që këtë hyrje t'ua shesë personave të tjerë.

Deklarata noteriale është nënshkruar nga shtetasit Nj.V. dhe Gjovalin Përnoca, ndërsa z. S.T. i nuk ka nënshkrim.

Subjekti i rivlerësimit:

- në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2011 ka deklaruar shpenzime në vlerën 3.500.000 lekë + pajisje dhe riparime të kësaj shtëpie = 800.000 lekë, për shtëpinë e ndodhur në Sarandë;
- në deklaratën “Vetting” ka deklaruar: *“Palët u kthyen në gjendjen e mëparshme dhe për shkak të punimeve shtesë të bëra në papafingo dhe mobilim, u vlerësua me 70.000 euro, duke na dhënë 35.000 euro secilit”*.

Në deklaratën noteriale të pasurisë nr. \*\*\*, datë 26.6.2013, z. Nj.V., ka deklaruar ndër të tjera se: *“Vlera totale e hyrjes së banimit, së bashku me verandën dhe ballkonin është 50.000 euro, por bashkë me punimet e tjera që kanë kryer shtetasit Gjovalin Përnoca dhe S.T., vlera e hyrjes së banimit me verandën është shtuar dhe me 20.000 euro dhe vlera totale është 70.000 euro”*.

<sup>37</sup> Deklarata noteriale nr. \*\*\*, datë 12.8.2011.

<sup>38</sup> Kontratë sipërmarrjeje nr. \*\*\*, datë 12.8.2011.

<sup>39</sup> Deklarata noteriale nr. \*\*\*, datë 25.6.2013.

<sup>40</sup> Deklarata noteriale nr. \*\*\*, datë 26.6.2013.

Komisioni ka konstatuar mospërputhje në lidhje me vlerën e deklaruar nga subjekti si shpenzim në hyrjen e banimit, për arsye se në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011 subjekti deklaroi shpenzime të llojit pajisje dhe riparim në shumën 800.000 lekë, ndërsa në deklaratën “Vetting” kuptohet që punimet shtesë kanë qenë nga 10.000 euro secili, fakt që përforcohet edhe me deklaratën noteriale datë 26.6.2013, ku deklaruesi Nj.V. deklaroi se ... *bashkë me punimet e tjera që kanë kryer shtetasit Gjovalin Përnoca dhe S.T. vlera e hyrjes së banimit me verandën është shtuar dhe me 20.000 euro...*

Komisioni, gjithashtu ka konstatuar se subjekti nuk ka depozituar dokumentacion ligjor në lidhje me punimet e kryera.

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, ka dhënë shpjegime se në lidhje me shtëpinë e plazhit në Sarandë, në deklaratën e vitit 2011 ka deklaruar shpenzime shtesë në shumën 800.000 lekë.

Vlera e shtuar e apartamentit, në momentin e anulimit të kontratës së sipërmarrjes, e vlerësuar nga 10.000 euro për secilin, përfshin punime shtesë në papafingo, mobilim, por edhe rritje të vlerës për shkak të kohës së kaluar që nga blerja e apartamentit dhe njëkohësisht është trajtuar me ndërtuesin dhe është pranuar edhe si një kompensim ose dëmshpërblim, pasi ndërtuesi nuk arriti të përmbushë detyrimet kontraktore.

Komisioni i është drejtuar subjektit të rivlerësimit me pyetësorin nr. 2, ku në lidhje me shtëpinë e plazhit në Sarandë i ka kërkuar që: të depozitojë dokumentacion justifikues ligjor për punimet e kryera shtesë në këtë apartament (referuar shumës 10.000 euro secili) fatura, preventive etj.; të shpjegojë arsyen se përse këto punime shtesë të tjera në këtë apartament (me vlerë rreth 10.000 euro) nuk janë deklaruar në deklaratat periodike; të justifikojë me dokumentacion justifikues ligjor mundësitë financiare të z. S.T.

- Subjekti, në lidhje me punimet e kryera shtesë në këtë apartament ka deklaruar se nuk ka fatura dhe preventive, pasi këto shpenzime janë bërë nga ata vetë dhe jo nga firma.
- Në lidhje me mundësitë financiare të z. S.T. subjekti ka deklaruar se ky person që në vitin 1998 e deri tani ka punuar dhe jetuar familjarisht në Londër, ku ka punuar si barist në lokale të ndryshme dhe vitet e fundit ka një firmë private ndërtimi.

Përveç shpjegimeve të dhëna, subjekti ka depozituar në Komision *statement* bankar, lëshuar nga Lloyds Bank për periudhën 2006 – 2012 (duke i dërguar me *e-mail*). “*Me shkresën shoqëruese të datës 8.6.2019 më ka shkruar (S. T.) se.....asokohe unë punoja në një klub prestigjioz ku një pjesë e mirë të të ardhurave ishin në formë bakshishi dhe ne i merrnim para në dorë, kështu që fatkeqësisht nuk janë të pasqyruar në dokumentet bashkëlidhur.*”

Subjekti vijon të deklarojë se: “*... unë di se atë kohë ai ka banuar në të njëjtën familje me prindërit e tij dhe vëllain e tij ku të gjithë kanë pasur të ardhurat e tyre, pra kanë pasur ekonomi të përbashkët. Nga një mbledhje e thjeshtë e të ardhurave mujore të tij me dokumentacionin e dërguar prej tij deri me datë 1.8.2011 rezultoi se të ardhurat e tij janë plotësisht të mjaftueshme (mbi dyfishin) për përballimin e kësaj shume që ka investuar me kontratën në fjalë.*”

**Analizë financiare në lidhje me mundësinë financiare të shtetasit S.T. në shumën 35.000 euro**

Subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion të Komisionit llogarinë bankare të shtetasit S.T. për periudhën 2006 – 2011. Nga kontrolli i këtyre transaksioneve vihet re se në këtë llogari janë kredituar shuma dhe janë kryer pagesa për shërbime dhe fatura të ndryshme. Për këtë periudhë është tërhequr *cash* shuma prej 980.06 GBP.

Data e veprimit	Vlera në GBP
20.4.2007	41.60
30.4.2007	200.00
2.8.2007	114.50
6.8.2007	113.90
8.8.2007	115.35
28.3.2008	65.56
31.3.2008	131.48
30.7.2008	67.09
31.8.2011	130.58
Total tërheqje	980.06

## Konkluzion

**Shtetasi S.T., në kuptim të pikës 14, të nenit 3, dhe të pikës 4, të nenit 32, ligjit 84/2016, konsiderohet person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit, për shkak të pagesës së një shume prej 5.000 euro nga ana e subjektit, z. Nj.V., për llogari të z. S.T., si dhe për shkak të marrëdhënies së interesit ndërmjet të dyve në kryerjen e një investimi solidar prej tyre për blerjen e apartamentit në Sarandë.**

**Z. S.T. rezulton me burime të pamjaftueshme të ligjshme financiare për pagesën e shumës 35.000 euro, për blerjen e apartamentit në Sarandë dhe kryerjen e investimeve të tjera në të.**

Subjektit i janë kërkuar shpjegime për shprehjen nga ana e tij dhe të vullnetit të z. S.T. në deklaratën noteriale të datës 25.6.2013, ku deklarohet se: “...ne shtetasit Nj.V., Gjovalin Përnoca dhe S. T. anulojmë kontratën e sipërmarrjes”, në një kohë që ky shtetas nuk ka qenë prezent para noterit, si dhe nuk ka lënë akt përfaqësimi në emër të subjektit.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: “Për shkak të moskorrektesës së firmës së ndërtimit, kishim rënë dakord në parim për ta anuluar kontratën, në të kundërt, do t’ia shisnim kujt do. Por, për efekt të dokumentimit të faktit se ndërtuesi i kishte marrë nga ne porositësit të gjithë shumën prej 50.000 euro, u detyrova të shkoj në Fier, ku banon ndërtuesi dhe përpilua deklaratën noteriale të datës 25.6.2013.

Është e vërtetë që në këtë deklaratë noteriale unë kam deklaruar një fakt të pranuar edhe nga ndërtuesi Nj.V., se ‘unë dhe S.T. i kemi likuiduar palës shitëse të gjithë shumën e mbetur e cila është paguar cash jashtë zyrës noteriale’. Por, ky deklaram i imi është i ligjshëm dhe i vërtetë, i cili shpreh dijeninë time për faktin e deklaruar (se ne të dy ia kemi dhënë paratë ndërtuesit),

*por thjesht duke deklaruar një fakt të njëjtë për mua dhe S., unë nuk kam shprehur asnjë vullnet të tij për asgjë.”*

Subjekti, në lidhje me huan prej 5.000 euro, dhënë nga shtetasi Nj.V., ndërkohë që sapo kishin prishur një marrëdhënie kontraktuale si pasojë e mungesës së korrektësisë nga ky shtetas dhe arsyen e moskthimit të saj deri më sot, ka deklaruar se: *“... në datën 26.6.2013, ndërsa po përpilonim tek noteri deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 26.6.2013, të anulimit të kontratës datë 12.8.2011 dhe ndërtuesi Nj.V. i kishte paratë me vete, për t'i dhënë secilit pjesën e tij (nga 35.000 euro), ai gjeti momentin që t'i kërkojë borxh 5.000 euro, me pretendimin se i kishte dalë një nevojë e ngutshme financiare lidhur me fëmijët, por do të m'i kthente në datën 15.7.2013. Unë nuk kisha aspak dëshirë që t'ia jepja, por nëse nuk ia jepja, rrezikoja që të mos binte dakord me anulimin e kontratës dhe do më duhej që të humbja shumë kohë tjetër për të shitur përsëri banesën.... Më vonë, unë disa herë e kam takuar këtë person dhe i kam kërkuar kthimin e borxhit, por më është justifikuar se nuk i ka ecur puna mirë, prandaj nuk ka mundësi, por kur të ketë mundësi, do të m'i kthejë. Nuk ju jam drejtuar organeve gjyqësore, pasi nuk dua konflikte”.*

Komisioni, me pyetësin nr. 5, ka kërkuar shpjegime në lidhje me faktin se në datën 25.6.2013 subjekti, së bashku me z. S.T. dhe sipërmarrësin Nj.V. kanë deklaruar se për apartamentin në Sarandë është likuiduar i gjithë detyrimi, ndërkohë, një ditë më pas, në datën 26.6.2013, me deklaratën noteriale deklarohet se subjekti dhe z. S.T. kanë anuluar kontratën e sipërmarrjes dhe palët të kthehen në gjendjen e mëparshme. Gjithashtu, z. Nj.V. do të kthejë shumën 70.000 euro, pra, në harkun kohor kryhen dy veprime që kundërshtojnë njëra-tjetrën.

Subjekti, në përgjigje të tij, deklaron se: *“Është e vërtetë që në pamje të parë të krijohet mendimi se në datën 25.6.2013 palët deklarojnë se nuk kanë pretendime reciproke dhe një ditë më pas anulohet kontrata..... megjithatë unë i kam shpjeguar dhe më parë se ishim të bindur se marrëdhënia me sipërmarrësin nuk mund të vazhdonte, duke përmendur problematikën e shpjeguar edhe në një pyetësor tjetër.”*

## **Subjekti i rivlerësimit**

### **1. Në lidhje me barrën e provës, të kaluar nga Komisioni, se:**

*Ngrihen dyshime në lidhje me deklaratën noteriale të datës 25.6.2013, ku deklaroni se së bashku me z. S.T. i kemi likuiduar palës shitëse në të ardhmen, të gjithë shumën e mbetur, e cila është paguar cash jashtë zyrës noteriale, ndërkohë që në deklaratë mungon nënshkrimi i z. S.T.*

Subjekti ka shpjeguar se: *“Nuk ka arsye të mendohet se ne nuk ia paskemi likuiduar pjesën e mbetur të parave ndërtuesit, vetëm se mungon firma e S. Pagesën e plotë e ka deklaruar vetë ndërtuesi Nj.V. përpara noterit, në praninë time. Ky ishte edhe qëllimi i përpilimit të kësaj deklarate noteriale, që ndërtuesi të mos kishte asnjë pretendim të mëvonshëm për mospagim nga ana jonë, që ne të ishim të lirë dhe pa pengesa (nga pretendime të mundshme të rreme të ndërtuesit mbi shlyerjen e detyrimeve tona) të anulonim kontratën...”*

### **2. Në lidhje me barrën e provës se:**

Ngrihen dyshime në lidhje me deklaratën noteriale të datës 26.6.2013, ku sipërmarrësi Nj.V., subjekti dhe z. S.T. deklarojnë se anulojnë kontratën e sipërmarrjes dhe se z. Nj.V. u ka dhënë

shumën 70.000 euro për apartamentin, në një kohë kur emri i z. S.T. në deklaratë rezulton si deklarues por në fund tek emri i tij nuk ka nënshkrimin e tij.

Subjekti ka shpjeguar se: *“Nuk është e vërtetë që të mos ketë nënshkruar z. S.T. Në kontratë ka emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e tij, gjë për të cilën, bashkëlidhur do ju nisim të skanuar deklaratën noteriale të datës 26.6.2013.”*

### **3. Në lidhje me barrën e provës se:**

Duket se ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për shpenzimet e kryera për punimet shtesë në vlerën 10.000 euro nga subjekti dhe 10.000 euro nga z. S.T. (deklaruar ky fakt në deklaratën noteriale të datës 26.06.2013), për apartamentin në Sarandë.

Subjekti ka shpjeguar se: *“Së pari, nuk kemi mbajtur evidenca e preventivë punimesh, pasi i kemi bërë me ustallarë të ndryshëm, e disa edhe vetë. Lidhur me kërkesën tuaj për dokumentacionin ligjor justifikues të shumës së shpenzuar më tepër, pra, për vlerën prej 800.000 lekësh, ju shpjegoj se këto të ardhura janë nga pagat e familjes time, të cilat i kam shpjeguar hollësisht në deklaratën e pasurisë për vitin 2011, në faqen 10 të tij.*

*Së dyti, nuk kemi thënë askund (pra, as në deklaratën noteriale të datës 26.6.2013) që vlera e punimeve shtesë të ketë qenë në vlerën 10,000 euro secili, por me punimet tona shtesë (që për mua kanë qenë 800.000 lekë), pa përfshirë kohën e harxhuar dhe kontributin në punë nga vetë unë për rregullimet e kryera, pas kalimit të rreth dy viteve, për këto punime të kryera, si dhe për mos përmbushjen në kohë të detyrimeve të tij kontraktore, jemi kompensuar në masën nga 10.000 euro të tjera secili. Ky kompensim për një vlerë më të madhe për apartamentin (10.000 euro -800.000 lekë) ishte normal që u trajtua edhe si dëmshpërblim, pasi ndërtuesi nuk arriti të përmbushë detyrimet kontraktore, kishte përdorur vlerat monetare të paguara nga ana jonë për rreth dy vjet dhe do të përfitonte të gjithë investimin e kryer (vlerën e shtuar), së bashku me kohën e punës të realizuar nga unë.”*

### **4. Në lidhje me barrën e provës se:**

Duket se ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të vërtetuar pagesën prej 30.000 eurosh që subjekti i ka bërë sipërmarrësit Nj.V. në datën 24.2.2011, datë kjo e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes.

Subjekti ka shpjeguar se: *“...pagesën prej 30.000 euro, bërë sipërmarrësit Nj.V., e provon vetë kontrata e sipërmarrjes, datë 24.2.2011, ku këtë fakt ai e ka pranuar me nënshkrimin e kësaj kontrate, ku pranon se i ka marrë shumën prej 30.000 euro në dorë.”*

### **5. Në lidhje me barrën e provës se:**

Duket se ka mungesë dokumentacioni ligjor justifikues për të vërtetuar pagesën prej 20.000 euro që z. S.T. i ka bërë sipërmarrësit Nj.V. për apartamentin në Sarandë.

Subjekti ka shpjeguar se: *“...me deklaratën noteriale të datës 25.6.2013 unë kam deklaruar se neve ia kemi dhënë të gjithë shumën, si dhe sipërmarrësi Nj.V. ai ka pohuar se e ka marrë prej nesh (më përpara kësaj date) të gjithë shumën e mbetur. Faktin se vërtetë i ka marrë paratë, sipas kontratës, e vërteton edhe përmbajtja e deklaratës noteriale të datës 26.6.2013, ku pikërisht për faktin se kishte marrë paratë dhe nuk kishte bërë punët, u detyrua të na i kthejë.*

*Lidhur me provueshmërinë e aftësisë pagueuse të z. S.T. për të paguar pjesën e tij të kontratës së porosisë për shtëpinë në Sarandë, përveç provave dhe argumenteve të mëparshme, kam marrë deklaratën e z. S.T., të datës 19.8.2019, me të cilën vërteton se (përveçse që kur kanë emigruar në Angli në vitet 2009 – 2011, kur janë krijuar këto të ardhura) ka qenë në të njëjtën familje me prindërit e tij dhe vëllain B.T., se kanë pasur një ekonomi të përbashkët familjare dhe se për përballimin e sasisë prej 25.000 euro për kontratën e porosisë të banesës, ka përdorur edhe nga vlerat monetare të vëllait B.T., të cilat ishin të konsiderueshme.*

*Në funksion të provueshmërisë së këtij fakti, S.T. i është referuar edhe një deklaratë noteriale të vëllait të tij B.T., me nr. \*\*\* kol., datë 15.8.2019, nga e cila provohet se në atë periudhë ata kanë qenë në një familje bashkë edhe me prindërit dhe me ekonomi të përbashkët, se B.T. në atë periudhë ka pasur të ardhura të mjaftueshme nga puna, (e vërtetuar nga listpagesat e vërtetuara me origjinalin), si dhe se këto të ardhura i ka vënë në dispozicion edhe të S. për të përballuar këtë shpenzim. Fakti se ata kanë qenë të gjithë në të njëjtën banesë del edhe nëse do shikoni adresën e njëjtë të shtëpisë së tyre, të deklaruar në deklaratën time të pasurisë për vitin 2013, lidhur me qëndrimin e djalit K.P. për një vit shkollor në Londër, me deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 16.4.2019, të znj. A.S. (gruaja e S.T.), si dhe me listpagesat e fundit të vitit 2010 dhe të vitit 2011, të sjella nga B.T., bashkëlidhur deklaratës së tij noteriale nr. \*\*\* kol., datë 15.8.2019, ku banka ia ka nisur listpagesat në të njëjtën adresë: ‘\*\*\*’, Londër.”*

## **6. Në lidhje me barrën e provës se:**

*Duket se ka mungesë dokumentacioni ligjor justifikues për të vërtetuar pagesën prej 70.000 euro që sipërmarrësi Nj.V. ju ka bërë ju dhe S.T. (referuar deklaratës noteriale të datës 26.6.2013) pas anulimit të kontratës së sipërmarrjes.*

*Subjekti ka shpjeguar se: “Në deklaratën noteriale të datës 26.6.2013, në prani të të dy palëve, është cituar qartë se pas anulimit të kontratës ‘...palët kthehen në gjendjen e mëparshme, pra shtetasi Nj.V., me cilësinë e sipërmarrësit i jep shtetasve Gjovalin Përnoça dhe S.T. vlerën 70.000 euro...”*

### **Konkluzion**

**Komisioni, pasi mori në konsideratë provat, si dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, arrin në konkluzionin se:**

- **Në lidhje me pikën 1 të barrës së provës:**

**Komisioni i konsideron të mjaftueshme shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me këtë konstatim.**

- **Në lidhje me pikën 2 të barrës së provës:**

**Në deklaratën noteriale të datës 26.6.2013, konstatohet firma e shtetasit S.T.**

- **Në lidhje me pikën 3 të barrës së provës:**

**Komisioni, bazuar në deklaratimet e subjektit dhe në dokumentacionin noterial arrin në përfundimin se shuma prej 20.000 euro, kthyer nga 10.000 euro secilit prej shtetasve Gjovalin Përnoça dhe S.T. nga sipërmarrësi Nj.V., pas anulimit të kontratës së sipërmarrjes, është shuma reale e shpenzuar nga këta shtetas për kryerjen e punimeve shtesë në apartament dhe jo shuma prej 800.000 lekësh secili, ashtu siç ka deklaruar**



subjekti i rivlerësimit, duke i vlerësuar jo bindëse shpjegimet e dhëna nga subjekti në lidhje me këtë problematikë.

- Në lidhje me pikën 4 të barrës së provës:

Komisioni i konsideron të mjaftueshme shpjegimet e subjektit në lidhje me këtë problematikë, përderisa z. Nj.V. e ka firmosur kontratën e sipërmarrjes, datë 24.2.2011, ku konfirmon marrjen e shumës prej 30.000 euro nga subjekti i rivlerësimit.

- Në lidhje me pikën 5 të barrës së provës:

Komisioni, pavarësisht deklaramentit të bërë nga sipërmarrësi Nj.V., se e ka marrë të gjithë shumën prej 50.000 euro nga subjekti dhe shtetasi S.T., duke marrë në konsideratë analizën financiare të kryer për z. S.T., vlerëson se nuk kishte burime të ligjshme të mjaftueshme financiare për kryerjen e pagesës prej 20.000 euro z. Nj.V.

Komisioni, në lidhje me dokumentacionin e depozituar dhe deklaramentet e subjektit se në vlerën financiare të paguar nga z. S.T. për pagesën e pjesës takuese të apartamentit në Sarandë, ka ndihmuar edhe i vëllai, B.T., dhe ekonomia e përbashkët familjare që ata kanë në Angli, i konsideron ato jo të pabazuara dhe, për rrjedhojë, nuk i merr në konsideratë, për arsye se ato nuk janë deklaruar nga subjekti dhe personat përkatës në kohë reale, përkundrazi, Komisioni vlerëson se futja në lojë e të ardhurave të shtetasit B.T. është bërë pasi është konstatuar pamundësia financiare e shtetasit S.T. për të paguar pjesën e tij monetare në këtë investim.

- Në lidhje me pikën 6 të barrës së provës:

Komisioni, duke marrë në konsideratë faktin se në deklarament noteriale të datës 26.6.2013 është shprehur vullneti i lirë dhe i pavesuar i të dy palëve, kthimi i shumës 70.000 euro është pasqyruar në deklarament periodike vjetore të pasurisë të vitit 2013, i gjen të mjaftueshme shpjegimet e dhëna nga subjekti për kthimin e palëve në gjendjen fillestare, duke marrë shumën prej 70.000 euro dhe duke i kthyer z. Nj.V. apartamentin, pavarësisht faktit se një transaksion i tillë nuk është kryer në rrugë bankare.

## KONSTATIME TË TJERA

- ❖ Në lidhje me depozitën me vlerë 35.000 USD të vitit 2003, në “Intesa Sanpaolo Bank”

“Intesa Sanpaolo Bank”<sup>41</sup> ka konfirmuar se në emër të znj. A.P. rezulton një llogari e hapur në datën 31.7.2003, në shumën 35.000 USD. Kjo depozitë është maturuar në datën 9.1.2004 dhe vlera e kësaj llogarie është 35.113,83 USD, depozitë e cila mbyllet më pas.

Si subjekti i rivlerësimit, ashtu edhe personi i lidhur me të, bashkëshortja e tij, nuk e kanë deklaruar një depozitë të tillë, si në deklarament e pasurisë së vitit 2003, ashtu dhe në atë periodike të vitit 2004, kur kjo depozitë është mbyllur.

Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime në lidhje me mosdeklarimin e mbylljes së kësaj llogarie në deklarament periodike vjetore të vitit 2004, si dhe të japë shpjegime se për çfarë qëllimi është përdorur kjo shumë e tërhequr nga kjo llogari.

---

<sup>41</sup> Shkresa nr. \*\*\*prot., datë 31.12.2018, e “Intesa Sanpaolo Bank”.

Subjekti, në përgjigje të tij, ka deklaruar se bashkëshortja e tij, znj. A.P., ka pasur një depozitë në Bankën Amerikane nga viti 2002 deri në vitin 2004, në shumën 35.000 USD, por këto vlera monetare kanë qenë të vajzës së vëllait të saj, M.N.V. Subjekti ka vijuar me shpjegimet e tij të detajuara<sup>42</sup>

Subjekti ka depozituar deklaratën noteriale të datës 15.12.2004<sup>43</sup>, ku znj. M.V. ka deklaruar se: *“... në shtator të vitit 2002 kanë qenë vizitorë në Angli halla ime së bashku me bashkëshortin e saj, respektivisht A. dhe Gjovalin Përnoca. Në këtë rast, kur ata u larguan, u kemi dhënë kursimet tona nga puna prej rreth pesë vjetësh në Angli. Unë kam qenë atje së bashku me bashkëshortin tim A.V. Këtë shumë prej 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) USD, halla ime e ka depozituar pranë Bankës Amerikane në datën 20.9.2002 dhe me kërkesën tonë kjo shumë është tërhequr në janar të vitit 2004. Meqenëse unë deri në qershor të këtij viti kam qenë me banim dhe punë në Angli, këto vlera ruheshin për llogarinë tonë pranë bankës. Në qershor të vitit 2004 jemi kthyer në Shqipëri dhe e gjithë vlera e depozituar na është dhënë në dorë, mua dhe bashkëshortit tim. Sikurse bëhet e qartë nga akti noterial i datës 6.7.2004, me nr. \*\*\*, me notere T.M., pjesa që na kishte mbetur në këtë kohë është pjesëtuar vullnetarisht mes meje dhe bashkëshortit tim”.*

Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit në lidhje me: arsyen që znj. M.V. ka dashur ta depozitonte shumën 35.000 USD në institucionet bankare të shtetit shqiptar, ndërkohë që mund t'i depozitonte në vendin ku jetonte; dokumentacionin ligjor që vërteton faktin juridik të martesës (datën e martesës) së znj. M.V. me shtetasin A.V., si dhe zgjidhjen e saj; vënien në dispozicion të dokumentacionit ligjor justifikues të krijimit të shumës 35.000 USD nga M. dhe A.V.; shumën që i është dhënë znj. M. V. në Angli; të konfirmojë shumat që i janë dhënë nga të afërmit e znj. M.V. në Shqipëri, duke specifikuar personat me gjeneralitete të sakta dhe shumat përkatëse; burimin e ligjshëm të krijimit të shumës 35.000 USD dhe dokumentacionin provues ligjor.

Subjekti, në përgjigje të tij, ka deklaruar se: *“M.V. ishte pa dokumente të rregullta qëndrimi në Londër dhe nuk mund t'i depozitonte në bankat atje, sepse nuk kishte dokumentet e duhura për të hapur një llogari bankare, as nuk mund t'i ruante paratë në shtëpi...”*

---

<sup>42</sup> *“... është e vërtetë që në Bankën Amerikane gruaja ime ka pasur të depozituar shumën prej 35.000 USD nga data 20.9.2002 deri në janar 2004, por këto vlera monetare nuk kanë qenë të saj, por të vajzës së vëllait të saj, M.N.V. Unë dhe gruaja, A.P., në shtator të vitit 2002 kemi qenë si vizitorë tek njerëzit e gruas në Londër. Kur po ktheheshim për në Shqipëri, prej mbesës së saj, M.V., dhe bashkëshortit të saj A.V., i janë dhënë gruas A. një pjesë nga kjo shumë parash për t'i ruajtur, si dhe është porositur që të pranojë nga familjarët e saj edhe disa para të tjera të saj dhe t'ia ruante të gjitha bashkë në bankë.*

*Me t'u kthyer në Tiranë, këtë shumë gruaja, A.P. (bashkë me sasi të tjera të sjella nga familjarët e mbesës M.V., sipas porosisë së saj, për t'ia ruajtur, që në total kanë kapur shumën prej 35.000 USD), këtë shumë e ka depozituar në Bankën Amerikane, me konto nr. \*\*\*, me datë 20.9.2002.*

*Në janar 2004 mbesa dhe burri i saj janë kthyer dhe përfundimisht këto para janë tërhequr dhe iu dorëzuan mbesës, M.V., dhe bashkëshortit të saj, A.V.*

*Ky fakt, si më lart (se këto vlera monetare ishin të mbesës dhe të të shoqit, se u janë ruajtur në bankë dhe u janë kthyer po atyre në janar 2004) është provuar edhe me deklaratën noteriale nr. \*\*\*rep., datë 15.12.2004 të vetë mbesës M.V., si dhe është verifikuar nga ILDKPKI-ja në datën 15.12.2004, ku kam dhënë po këto shpjegime përpara inspektorëve (dokumente që po i nis bashkëlidhur).”*

<sup>43</sup> Deklarata noteriale nr. \*\*\* rep., pa nr. kol., datë 15.12.2004, e znj. M.V.

*Për sa i përket pyetjes tuaj për: ‘...dokumentacionin ligjor që vërteton faktin juridik të martesës (datën e martesës) së M.V. me shtetasin A.V., si dhe zgjidhjen e martesës’, ju vë në dispozicion vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. \*\*\*, datë 19.9.2005, etj.*

*Për sa i përket kërkesës për ‘dokumentacionin ligjor justifikues të krijimit të shumës 35.000 USD nga M. dhe A.V.’...gjatë jetës së tyre bashkëshortore kanë krijuar një shumë të hollash nga puna dhe kursimet tona...’ Edhe në deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 17.4.2009, M.V., mes të tjerash ka deklaruar se: ‘...gjatë viteve 1998 - 2004, unë dhe bashkëshorti i atëhershëm A.V. kemi jetuar dhe punuar në Londër.... Me punën tonë të ligjshme kemi fituar dhe kursyer një sasi vlerash monetare, e cila, në vitin 2002, e konvertuar, ishte më e madhe se 35.000 dollarë’. ...ju konfirmoj se në shtator të vitit 2002, unë dhe gruaja A.P., kemi qenë si vizitorë tek njerëzit e saj në Londër dhe atje, mbesa e saj M.V. i ka dhënë A. për t’i sjellë në Shqipëri dhe për t’i ruajtur, sasinë prej 8.000 GBP, si dhe është porositur që të pranojë nga familjarët e saj në Shqipëri edhe disa para të tjera të saj dhe t’ia ruante të gjitha bashkë. A. ka pranuar në parim që gjithë sasinë e lekëve të saj t’ia ruante në Shqipëri, por me vete kemi marrë vetëm 8.000 GBP.*

*Këto para, sipas porosisë së M., kur u kthyem, ia kemi dhënë vëllait të A., P.N. i cili, sipas porosisë së M., i ka konvertuar në dollarë, i ka bashkuar edhe me para të tjera (të cilat në disa raste, M. ia kishte sjellë në Shqipëri gjatë viteve 2001 -2002 me familjarë të saj, për t’ia ruajtur), që bënin gjithsej shumën prej 35.000 USD dhe ia ka sjellë A. të gjitha së bashku, për t’ia ruajtur”.*

Subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës në lidhje me:

- Mosdeklarimin e depozitës prej 35.000 USD, në emër të bashkëshortes, znj. A.P., në deklaratën e vitit 2003, si dhe në deklaratën periodike të vitit 2004, kur kjo depozitë është mbyllur.
- Mungesën e dokumentacionit provues ligjor nga znj. M.V. dhe bashkëshorti, për krijimin e shumës 35.000 USD, ndër vite.
- Mungesën e dokumentacionit provues ligjor:
  - a) të dhënies së shumës 8.000 GBP nga znj. M.V. dhënë bashkëshortes së subjektit, znj. A.P.;
  - b) të shumave të sjella në Shqipëri nga të afërm të tjerë të znj. M.V., që përbëjnë diferencën tjetër (përveç shumës 8.000 GBP) për krijimin e shumës 35.000 USD.

Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të tij, pas kalimit të barrës së provës, ka shpjeguar se kjo pasuri nuk është deklaruar prej tij, pasi nuk ishte pasuri e familjes së tij, por pasuri e cila i ishte lënë në ruajtje nga mbesa e bashkëshortes.

Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, në lidhje me:

1. Mungesën e dokumentacionit provues ligjor nga znj. M.V. dhe bashkëshorti i saj, për krijimin e shumës 35.000 USD, ndër vite, ka shpjeguar:
  - a) nuk ka barrën e provës që të provojë origjinën e parave të tyre, pasi ato ishin në ruajtje;
  - b) në të tria deklaratat noteriale me deklaruese znj. M.V., ka shpjeguar se ato ishin paratë e familjes së tyre, të fituara nga puna e tyre në Londër, nga viti 1998 - 2002.
2. Mungesën e dokumentacionit provues ligjor të dhënies së shumës 8.000 GBP bashkëshortes së tij nga M. V., dhe të shumave të sjella në Shqipëri nga të afërm të tjerë të

znj. M.V., që përbëjnë diferencën tjetër (përveç shumës 8.000 GBP) për krijimin e shumës 35.000 USD, ka shpjeguar:

- a) për shkak të marrëdhënies së tyre të posaçme (mbesa e bashkëshortes së subjektit), nuk kanë bërë asnjë lloj dokumenti, as për marrjen, dhe as për dorëzimin e tyre;
- b) diferencën tjetër znj. M.V. e ka dërguar tek xhaxhai i saj, i cili ia ka dërguar znj. A.P. Pra, normalisht, nuk mund t'u kërkohet dokumentimi i mënyrës së ardhjes së këtyre parave nga znj. M.V. për të xhaxhai i saj.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit pas dërgimit të rezultateve të hetimit, vlerësoi se ato janë kontradiktore, të pabazuara dhe jo bindëse, për arsye se:

- Personi i lidhur me subjektin, bashkëshortja, znj. A.P., nuk ka deklaruar depozitën bankare prej 35.000 USD në deklaratat e pasurisë së viteve 2003 dhe 2004.
- Edhe në rast se do të merret i mirëqenë deklarimi i subjektit se këto para në depozitë bankare janë në pronësi të znj. M.V., kjo e fundit dhe bashkëshorti i saj nuk justifikojnë me burime të ligjshme financiare krijimin e kësaj shume.
- Nuk provohet dhënia e shumës 8.000 GBP bashkëshortes së subjektit nga znj. M.V.
- Nuk provohet, gjithashtu dhënia e diferencës që krijon shumën 35.000 USD nga znj. M.V. personave të tjerë, duke mos u specifikuar emrat e personave, shumat e transportuara nga secili person, periudhat kohore kur ata kanë hyrë në Shqipëri, si dhe nuk vërtetohet grumbullimi i kësaj difference monetare nga xhaxhai i shtetas M.V. dhe dorëzimi i saj te znj. A.P.
- Shtetasja M.V., në deklaratën noteriale datë 15.12.2004, deklaroi se: *“Shumën prej 35.000 USD halla ime e ka depozituar pranë Bankës Amerikane në datën 20.9.2002”*, ndërkohë që nga dokumentacioni bankar rezultoi që shuma 35.000 USD të jetë depozituar në bankë në datën 31.7.2003.
- Subjekti, një herë deklaroi se është depozituar shuma prej 35.000 USD dhe një herë tjetër deklaroi se është depozituar shuma prej 3.200.000 lekësh (8.000 GBP, të dhëna nga M., A. në Londër dhe diferenca e dhënë nga familjarët e M.), me kthimin e tyre nga Londra në shtator të vitit 2002.
- Subjekti, një herë deklaroi se z. P.N. (xhaxhai i M.), i ka sjellë znj. A.P. shumën 35.000 USD për t'ia ruajtur dhe një herë tjetër deklaroi se të hollat e dërguara nga znj. M.V. ishin konvertuar në lekë nga të afërmit.

### **Konkluzion**

**Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk kanë deklaruar depozitën prej 35.000 USD në emër të bashkëshortes, znj. A.P., në deklaratën e pasurisë të vitit 2003 dhe në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2004.**

**Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk provuan me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të krijimit të shumës prej 35.000 USD, të pretenduar si pasuri e znj. M.V. dhe bashkëshortit të saj, si dhe transferimin e saj në Shqipëri.**

**Komisioni, duke marrë shkas nga dokumentacioni dhe deklaratimet kontradiktore të subjektit të rivlerësimit, krijoi bindjen se depozita bankare prej 35.000 USD është pasuri e subjektit dhe e personit të lidhur me të, sikurse rezultoi nga informacioni bankar, dhe**

jo e shtetas M.V. dhe bashkëshortit të saj, duke arritur në konkluzionin se kemi të bëjmë me një pasuri të fshehur nga subjekti i rivlerësimit dhe e personit të lidhur me të.

- ❖ Në lidhje me kontratën e huas pa interes datë 25.5.2011, me huadhënës V.P., vëllai i subjektit, në shumën 15.000 euro, me qëllim blerjen e shtëpisë së plazhit në Sarandë, e kthyer brenda vitit dorazi.

Komisioni i ka kërkuar subjektit dokumentacionin justifikues për mundësitë financiare të vëllait, z. V.P.a, për dhënien e kësaj shume hua, si dhe vënien në dispozicion të një kopjeje të kontratës së huas datë 25.5.2011.

Subjekti, në përgjigje të tij, ka deklaruar se i ka marrë hua të vëllait, z. V.P., shumën 15.000 euro për të paguar këstet e një kontrate porosie për një shtëpi plazhi në Sarandë, por këto para nuk ia ka dhënë sipërmarrësit, pasi nuk kishte ecur me punimet, prandaj ia ka kthyer dorazi të vëllait brenda muajit.

Më tej, subjekti ka deklaruar se: *“Më vonë, në datën 12.8.2011, ka ardhur porositi tjetër S.T. dhe ka bërë likuidimin e vlerës tjetër të pashlyer të detyrimit ndaj firmës.*

*Lidhur me mundësitë financiare të vëllait, mendoj se thjesht marrja e një huaje e papërdorur fare, e kthyer shpejt në kuptim të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 13 dhe 14 të tij, ky fakt nuk më bën person tjetër të lidhur, në kuptim të këtij ligji, pasi në rastin konkret nuk kam asnjë ‘interes pasuror ose marrëdhënie biznesi’.*

*Në qoftë se do të konsiderohet si person tjetër i lidhur, në dijeninë time, burimet e të ardhurave të vëllait kanë qenë nga puna e tij dhe e bashkëshortes së tij në sektorin shtetëror dhe privat.*

*Konkretisht, vëllai është inxhinier mekanik, i profilit transport. Ka punuar në punë shtetërore që nga viti 1978 e deri më 31.12.1998. Më vonë, është punësuar në disa kompani private, nga viti 2007 e në vazhdim, edhe tani. Vëllai ka pasur edhe një aktivitet privat për dhënie leje për drejtim automjesh (autoshkollë), e emërtuar si subjekti \*\*\*, që nga fundi i vitit 1990 deri në vitin 1998, në rrethet Kukës, Mirditë dhe Tiranë, nga ku ka përfituar të ardhura të konsiderueshme.*

*Për sa më lart, lidhur me punësimet e tij, i vërtetoj me librezën e punës dhe librezën e kontributeve të sigurimeve shoqërore të tij. Edhe bashkëshortja e tij, Sh.P., ka përfunduar inxhinierinë tekstile dhe ka punuar në Artizanatin e Kukësit dhe në disa punë në sektorin privat.”*

Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë, në përgjigje të saj<sup>44</sup>, ka konfirmuar se për shtetasin V.B. P. nuk ka të dhëna për aktivitet tregtar të regjistruar.

Drejtorja e Hetimit Tatimor ka konfirmuar se shtetasi V.P. ka qenë i siguruar dhe është paguar nga shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., për pagë bruto në vlerën 40.000 lekë, për periudhën 2012 e në vijim.

Nga verifikimi i faqes zyrtare online të QKB-së, [www.qkb.gov.al](http://www.qkb.gov.al), rezulton se z. V.P. është ortak me 33,33 % të kapitalit të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., shoqëri e regjistruar në datën 14.12.2015, pra, jashtë periudhës ku janë dhënë huat. Pra, përjashtohen të ardhurat nga kjo shoqëri si burim krijimi i shumave të dhëna hua subjektit nga vëllai i tij, z. V.P.

---

<sup>44</sup> Shkresa nr. \*\*\*prot., datë 20.6.2019, e DPT-së, drejtuar Komisionit.

Pas kalimit të barrës së provës në lidhje me mospërputhjen në deklaram, për sa i përket qëllimit të marrjes hua të shumës 15.000 euro, në datën 25.5.2011, nga subjekti, vëllait të tij, z. V.P. dhe provimin e mundësisë financiare të vëllait për të kursyer dhe dhënë hua shumën 15.000 euro subjektit të rivlerësimit, në shpjegimet e tij dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, z. Gjovalin Përnoca ka dhënë argumente të mjaftueshme në lidhje me mospërputhjen e qëllimit të përdorimit të shumës së marrë hua, duke deklaruar se nuk e ka përdorur si burim krijimi për pagesën e këstit të radhës për apartamentin në Sarandë, duke ia kthyer këtë shumë përsëri të vëllait brenda vitit.

Në lidhje me mundësinë financiare të z. V.P. për dhënien hua të shumës 15.000 euro, subjekti ka provuar me dokumentacion provues ligjor ushtrimin e aktivitetit “autoshkollë” dhe se autoshkolla “\*\*\*\*” ka pasur të regjistruar për pajisjen me leje drejtimi 562 kursantë për periudhën 1996 – 1999 dhe 16 kursantë për vitin 2015 dhe sipas përlllogaritjeve të subjektit të ardhurat nga ky aktivitet shkojnë përafërsisht në shumën 7.500.000 lekë, por nuk konfirmohet pagesa e tatimit për të ardhurat e krijuara.

Gjithashtu, nga dokumentacioni ligjor, vërtetohet se të ardhurat e ligjshme të shtetasve V. dhe Sh.P. për periudhën 2000 – maj 2011, janë në shumën 3.382.091 lekë.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit pas dërgimit të rezultateve të hetimit, vlerësoi se ato janë bindëse dhe të plota.

### **Konkluzion**

**Subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me mospërputhjen që ka të bëjë me qëllimin e përdorimit të huas së dhënë nga vëllai V.P., në shumën 15.000 euro, nga ku rezulton se kjo hua nuk është përdorur nga subjekti dhe i është kthyer brenda vitit të vëllait, z. V.P.**

**Duke marrë në konsideratë dokumentacionin dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me burimin e ligjshëm financiar për krijimin e shumës 15.000 euro, në respektim të parimit të proporcionalitetit, i mbajtur parasysh edhe nga Kolegji i Apelit, në vendimmarrjen e tij në lidhje me hetimin e burimeve financiare të personit tjetër të lidhur, Komisioni arrin në konkluzionin se vëllai i subjektit ka pasur në dispozicion të ardhura të mjaftueshme të ligjshme në shumën 3.382.091 lekë, duke justifikuar shumën prej 15.000 euro, dhënë hua subjektit të rivlerësimit.**

**❖ Në lidhje me kontratën e huas datë 28.5.2013, me huadhënës z. V.P., vëllai i subjektit, në shumën 9.000 euro, për depozitim në bankë si garanci bankare për aplikim për vizë në Angli, e kthyer brenda vitit**

Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit në lidhje me dyshimet që kanë të bëjnë me qëllimin e vërtetë të përdorimit të kësaj huaje, si dhe në lidhje me mundësitë financiare të personit tjetër të lidhur, vëllait të subjektit, z. V.P.

### **Konkluzion**

**Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në mënyrë bindëse se shuma 9.000 euro ka qenë e depozituar nga subjekti në “Raiffeisen Invest” (përkatesisht në shumën 6.000 euro në datën 29.5.2013 dhe 4.000 euro në datën 17.6.2013), pikërisht si garanci bankare për aplikimin për vizë studimi nga djali i subjektit.**

**Në lidhje me mundësitë financiare të personit tjetër të lidhur, vëllait të subjektit, z. V.P., Komisioni ka dhënë shpjegime të sipërtrajtuara, duke shtuar edhe argumentin e dhënë nga subjekti i rivlerësimit se vëllai i tij ka pasur në dispozicion edhe huan e kthyer prej tij në vitin 2011, në shumën 15.000 euro.**

- ❖ **Në lidhje me huan prej 4.900 GBP, paguar si këst i fundit i pagesës së shkollës së djalit të subjektit, në dhjetor të vitit 2013 nga vëllai i bashkëshortes, z. S.N., i cili jeton në Londër**

Këtë hua, znj. A.P. ia ka kthyer në janar të vitit 2014 nga depozita në “Credins Bank”, duke i marrë shumën 6.000 euro dhe duke mbyllur llogarinë e saj.

### **Konkluzion**

**Komisioni arriti në përfundimin se subjekti dha shpjegime të plota në lidhje me burimin e krijimit të shumës 4.900 GBP, si dhe kryerjen e kësaj pagese nga kunati i subjektit për llogari të djalit të subjektit, gjithashtu, edhe në lidhje me burimin e krijimit dhe kthimin i këtij detyrimi nëpërmjet tërheqjes bankare nga bashkëshortja e subjektit shtetasit S.N.**

- ❖ **Në lidhje me shumën 11.700 euro, të depozituar në llogarinë e subjektit të rivlerësimit në Bankën Italo-Shqiptare në datën 16.7.2002 dhe shumën 3.200.000 lekë, të depozituar në llogarinë e bashkëshortes së subjektit në këtë bankë në datën 20.9.2002**

Në Bankën Italo-Shqiptare, në datën 16.7.2002, në emër të z. Gjovalin Përnoca ka rezultuar depozitimi i shumës 11.700 euro. Kjo shumë është konvertuar dhe transferuar në llogarinë në lekë dhe në datën 18.4.2003 konfirmohet tërheqja e shumës prej 1.532.684 lekësh (e cila ka si burim shumën e depozituar prej 11.700 euro).

Gjithashtu, për vitin 2002 në Bankën Italo-Shqiptare ka rezultuar edhe një depozitë në emër të znj. A.P. në shumën 3.200.000 lekë.

Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime në lidhje me burimin e krijimit të shumës 11.700 euro dhe të depozitës 3.200.000 lekë.

Subjekti, në përgjigje të tij, ka deklaruar: *“Meqenëse viti 2004 ishte viti i parë i deklarimit të pasurive, për llogarinë time në shkurt 2002 në shumën 3.200.000 lekë, nuk mund të jem i saktë, pasi nuk kam mbajtur shënime, por e ka burimin e vetëm të të ardhurave nga pagat dhe kursimet ndër vite dhe nga shitjet e mëparshme të cituara”.*

Ndërsa, në lidhje me shumën 11.700 euro subjekti deklaroi: *“... kjo llogari i përket një periudhe kur nuk kam pasur detyrim për deklarim, prandaj nuk mund të jem i saktë.....Por një gjë është e sigurtë, se të gjitha pasuritë e mia janë nga pagat dhe blerjet dhe shitjet që nga viti 1992, kur kam dalë në punë...”*

Nga analiza financiare konstatohet se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme financiare për krijimin e shumës prej 11.700 euro, por nuk kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e depozitës në shumën 3.200.000 lekë në datën 20.9.2002, duke rezultuar me mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën –1.878.236 lekë (shihni analizën financiare më poshtë).

<b>Data</b>	<b>Përshkrim i veprimit</b>	<b>Të dala</b>	<b>Të hyra</b>	<b>Gjendja</b>
-------------	-----------------------------	----------------	----------------	----------------

		(pagesa)	(arkëtime)	financiare
	Pagat për periudhën 1982 – 1997		1,129,345	1,129,345
20.12.1993	Blerje banese Rrëshen	28,214		1,101,131
	Shpenzime jetike për periudhën 1982 – 1997	790,542		310,590
<b>6.11.1997</b>	<b>Blerje banese në Shkodër</b>	<b>1,248,167</b>		<b>-937,578</b>
11.11.1997	Shitje banese në Shkodër		4,395,000	3,457,423
27.6.1998	Blerje shtëpie Rr. “****”	3,150,000		307,423
	Pagat për periudhën 1998		497,300	804,723
	Shpenzime jetike për periudhën 1998	260,000		544,723
7.6.1999	Shitje banese Rrëshen		750,000	1,294,723
	Pagat për periudhën 1999 – 31.7.2002		2,563,351	3,858,074
	Shpenzimet jetike për periudhën 1999 – 31.7.2002	1,075,000		2,783,074
<b>16.7.2002</b>	<b>Depozitë në Bankën Italo-Shqiptare (11.700 euro)</b>	<b>1,616,238</b>		<b>1,166,836</b>
	Paga 1.8.2002 – 30.9.2002		204,929	1,371,765
	Shpenzime 1.8.2002 – 30.9.2002	50,000		1,321,765
<b>20.9.2002</b>	<b>Depozitë në Bankën Italo-Shqiptare</b>	<b>3,200,000</b>		<b>-1,878,236</b>
	Paga për periudhën 1.10.2002 – 31.12.2002		337,493	-1,540,743
	Shpenzime 1.10.2002 – 31.12.2002	75,000		-1,615,743

❖ Në lidhje me destinacionin e përdorimit të shumës 3.200.000 lekë (3.316.000 lekë e maturuar në momentin e tërheqjes), të tërhequr në datën 20.3.2003, dhe të shumës 11.700 euro (e konvertuar në shumën 1.532.684 lekë), të tërhequr në datën 18.4.2003.

Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime në lidhje me destinacionin e përdorimit të kësaj depozite prej 3.200.000 lekësh.

Subjekti, në përgjigje të tij, ka deklaruar: “Në deklarin për vitin 2004, kam shpjeguar se kemi të mbartura nga vitet e mëparshme edhe vlerën 12.000 USD, të cilat janë një pjesë nga kjo pasuri. Pjesën tjetër të kësaj vlere monetare e kemi shpenzuar në këtë mënyrë: Meqë banesa jonë në Rr. “\*\*\*\*”, nr. \*\*\*, Tiranë, ishte në gjendje të keqe, sidomos gjatë vitit 2003, kemi shpenzuar për riparimin e banesës”.

Komisioni ka kërkuar shpjegime në lidhje me destinacionin e përdorimit të shumës prej 1.532.684 lekësh (nga konvertimi i shumës 11.700 euro), tërhequr nga llogaria rrjedhëse në datën 18.4.2003, në Bankën Italo-Shqiptare.

Subjekti, në përgjigje të tij, ka deklaruar: “Kjo sasi parash, kur është tërhequr është konvertuar në dollarë amerikanë dhe është mbajtur në shtëpi për nevojat e familjes. Këtë e vërteton deklarata ime e pasurisë e vitit 2003, ku është deklaruar se më 31.12.2003 kam pasur



*gjendje në shtëpi sasinë prej 15.000 USD dhe është shpjeguar se burimi i tyre është nga pagat gjatë viteve”.*

Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka kundërshtuar analizën financiare në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të depozitës në shumën 3.200.000 lekë, në emër të bashkëshortes, duke argumentuar:

*“- Burimi i krijimit të shumës prej 3.200.000 lekësh janë shumat e lëna në ruajtje nga znj. M.V. dhe se me kthimin e tyre nga Londra në shtator të vitit 2002, bashkëshortja e tij ka depozituar shumën prej 3.200.000 lekësh (8.000 GBP të dhëna nga M. në Londër dhe diferenca e dhënë nga familjarët e M.).*

*- Me kërkesë të znj. M.V., sipas deklarimeve të vetë asaj në deklarata noteriale, më kërkoi që këtë shumë ta konvertoja në dollarë dhe në datën 31 korrik 2003 është krijuar depozita në shumën 35.000 USD.”*

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit pas dërgimit të rezultateve të hetimit, vlerësoi se ato nuk janë bindëse, për arsye se:

Pavarësisht deklaramit të subjektit, sipas të cilit shuma prej 35.000 USD, e depozituar në emër të znj. A.P. në datën 20.9.2002, është në pronësi të znj. M.V., shumë kjo e cila sipas pretendimit të subjektit e ka origjinën nga maturimi dhe konvertimi i shumës prej 3.200.000 lekësh, depozituar në datën 20.9.2002 në emër të bashkëshortes së subjektit, Komisioni, bazuar në konkluzionet e pikës d), faqe 20 të këtij vendimi, ka argumentuar dhe krijoj bindjen se shuma prej 3.200.000 lekësh është pasuri në pronësi të subjektit dhe bashkëshortes.

Komisioni, në vazhdim të kësaj analize, krijoj bindjen se destinacioni i përdorimit të shumës prej 3.200.000 lekësh, i depozituar në emër të znj. A.P., ka qenë maturimi, konvertimi dhe depozitimi i saj në shumën 35.000 USD, në datën 31.7.2003, në depozitën bankare në Bankën Amerikane.

### **Konkluzion**

**Komisioni krijoj bindjen se shuma prej 3.200.000 lekësh, e depozituar në emër të znj. A.P. në datën 20.9.2009 në Bankën Amerikane, është pasuri në pronësi të personit të lidhur me subjektin, bashkëshortes A.P., duke e konsideruar të rremë deklarin e subjektit të rivlerësimit se kjo pasuri është e znj. M.V.**

**Nga analiza financiare, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, kanë burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e depozitës prej 11.700 euro në emër të subjektit të rivlerësimit dhe mungesë burimesh të ligjshme në shumën 1.878.236 lekë për krijimin e depozitës në shumën 3.200.000 lekë në emër të bashkëshortes.**

**❖ Në lidhje me tërheqjen *cash* nga llogaria rrjedhëse me nr. \*\*\*, në shumën 14.901 euro, në datën 25.2.2011, në “Raiffeisen Bank”**

Nga verifikimi i transaksioneve bankare në llogarinë rrjedhëse në “Raiffeisen Bank” rezulton se subjekti ka depozituar në datën 22.10.2010, shumën 15.000 euro dhe e ka tërhequr më 25.2.2011. Në këtë llogari nuk rezulton të ketë veprime të tjera.

Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit në lidhje me destinacionin e përdorimit të kësaj tërheqjeje prej 14.901 euro.

Subjekti ka deklaruar: “... kontratën nr. \*\*\*, datë 24.2.2011, ka bërë kontratën e sipërmarrjes, në emrin e tij me ndërtuesin Nj.V. për banesën, me çmim 50.000 euro gjithsej, ku i janë dhënë sipërmarrësit 30.000 euro prej tij (nga kursimet e viteve 2007 - 2010, pjesë e të cilave ishte dhe kjo llogari)”.

**Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar depozitimin e shumës 15.000 euro në “Raiffeisen Bank” si kursime, të cilat kanë shërbyer si burim krijimi për pagesën e apartamentit në Sarandë. Gjithashtu, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011 nuk ka deklaruar tërheqjen e shumës 14.901 euro në datën 25.2.2011, pasqyruar në lëvizjen e llogarisë bankare në “Raiffeisen Bank”.**

Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, ka shpjeguar: “Gjatë viteve 2007 - 2010 në deklaratat vjetore të pasurisë janë deklaruar kursimet e çdo viti, pa dhënë detaje nëse këto shuma kanë qenë të depozituara në bankë apo gjendje cash në shtëpi. Për këtë periudhë totali i të hollave të kursyera ka qenë 4.300.000 lekë (2007 – 900.000 lekë, 2008 – 1.100.000 lekë, 2009 – 1.200.000 lekë dhe 2010 – 1.100.000 lekë). Siç del nga vetë materialet e ILDKPKI-së, pas një viti nga mosdeklarimi i derdhjes së shumës 15.000 në bankë, jam pyetur nga inspektorja e këtij institucioni, znj. Dh.J., dhe ia kam treguar me shkrim rrethanat e mosdeklarimit në kohë. Metodologjia e përdorur në plotësimin e deklaratave vjetore ka qenë gjithmonë duke zbritur nga të ardhurat gjithsej, shpenzimet gjithsej dhe diferenca tregonte kursimet e çdo viti. Megjithatë, kjo është një shkelje që nuk ka të bëjë me fshehje pasurie (nuk fshihen paratë në bankë), pasi si gjendje parash në fund të çdo viti, janë pasqyruar saktësisht, por nuk është specifikuar se këto para ‘gjendje’, janë në bankë apo në banesë.

Në analizën financiare për periudhën 2003 – 2016, gjendja në fund të vitit 2010, si në bankë, ashtu edhe cash, rezulton të jetë 4.300.054 lekë.

Nga sa më lart, duket qartë se kursimet e mija për periudhën 2007 – 2010 kanë qenë gjithsej 4.300.000 lekë, pothuajse sa gjendja në fund të vitit 2010, sipas analizës më lart.

Gjithashtu, edhe në faqen 10 të deklaratës periodike të vitit 2011, deklaroj se kursimet për periudhën 2007 – 2010 janë 4.300.000 lekë, pa detajuar gjendjet në bankë dhe në cash. Në plotësimin e deklaratave vjetore unë gjithmonë jam përpjekur të detajoj çdo transaksion të kryer prej meje, megjithatë nuk kam detajuar shtesat dhe pakësimet në llogaritë bankare, duke menduar gjithmonë që ato janë të pasqyruara në statement, por kam paraqitur gjithmonë gjendjen e kursimeve të mija.”

## **Konkluzion**

**Komisioni i konsideron të mjaftueshme shpjegimet e dhëna nga subjekti në lidhje me mosdeklarimin e llogarisë bankare të shumës 15.000 euro në deklaratat e pasurisë së viteve 2010 dhe 2011.**

### **❖ Analiza financiare për periudhën 2003 – 2016**

Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni përgatiti analizën financiare, mbështetur në: të dhënat e deklarimeve periodike vjetore në ILDKPKI; deklaratën “Vetting”; informacionet e ardhura nga institucionet përkatëse; dhe në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, z. Gjovalin Përnoca, i cili ka qenë subjekt deklarimi pa ndërprerje që prej vitit 2003.

## **Metodologjia e kryerjes së analizës financiare**

Për efekt të pasqyrimit të metodologjisë së ndjekur, Komisioni në këtë analizë financiare është bazuar në deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë, deklaratën “Vetting”, pyetësorët me përgjigjet e subjektit, si dhe korrespondencën e Komisionit me institucionet publike dhe jopublike. Kjo metodologji shërben për të vlerësuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, për të realizuar kursimet, pasuritë e deklaruara, për të paguar shpenzimet, si dhe evidentimin e rasteve kur subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura të ligjshme pasuritë e krijuara (pasuri të luajtshme, të paluajtshme, likuiditete) dhe shpenzimet e kryera.

Analiza financiare e subjektit e rivlerësimit për periudhën e hetuar 2003 – 2016 bazohet në të ardhurat e ligjshme sipas vërtetimeve për të ardhurat nga pagat dhe shpërblimet në vlerë neto, lëshuar nga institucionet publike/private për subjektin<sup>45</sup>, bashkëshorten<sup>46</sup> dhe vajzën<sup>47</sup>, të cilat janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore në zbatim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

Për të ardhurat nga qiraja janë marrë në analizë vlerat sipas kontratave të qirasë<sup>48</sup>, për të cilat subjekti ka provuar me dokumentacion provues ligjor përfitimin e të ardhurës dhe pagesën e tatimit në burim për të ardhurën nga qiraja.

Për të ardhurat nga shitja e pasurive të luajtshme (automjete)<sup>49</sup> janë marrë në analizë vlerat sipas kontratave të shitblerjeve.

Për të ardhurat nga interesat bankare dhe për të ardhurat nga investimi në “Raiffeisen Invest” janë marrë në analizë vlerat sipas dokumentacionit bankar.

Për të ardhurat nga bursa janë marrë në analizë vlerat sipas dokumentacionit bankar, me të cilat provohet përfitimi i shumës.

Për të ardhurat nga anulimi i kontratës<sup>50</sup> së shitblerjes është marrë në analizë vlera sipas dokumentacionit provues dhe deklarimit të subjektit në deklaratën periodike.

---

<sup>45</sup> Vërtetim nr. \*\*\*prot., datë 21.10.2016, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës, për periudhën 1.8.1982 – 5.8.1991; vërtetim nr. \*\*\*prot., datë 25.10.2016, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, për periudhën 5.6.1991 – 1.6.1992; vërtetim nr. \*\*\*prot., datë 24.10.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë; vërtetim nr. \*\*\*prot., datë 23.1.2017, i Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda; vërtetim nr. \*\*\*prot., datë 20.10.2016, i Gjykatës së Apelit Shkodër; vërtetim i ISSH-së për pagën neto mesatare, për periudhën 1.1.1996 – 30.4.1998; vërtetim nr. \*\*\*prot., datë 23.1.2017, i Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda; vërtetimi nr. \*\*\*prot., datë 30.1.2017, i KLD-së, për periudhën 1.4.1998 – 13.12.2001; vërtetim nr. \*\*\*prot., datë 26.10.2016, i Shkollës së Magjistraturës; vërtetim nr. \*\*\*prot., datë 20.10.2016, i KLD-së për periudhën 4.10.2002 – 4.10.2007.

<sup>46</sup> Vërtetim nr. \*\*\*prot., datë 18.1.2017, i SHISH; vërtetim nga QBZ-ja, për periudhën 29.6.2001 – 28.2.2009; vërtetim i ISSH-së për pagën neto mesatare, për periudhën 1.1.1994 – 30.6.1996.

<sup>47</sup> Vërtetim datë 27.1.2017, nga Neë Look T. dhe nxjerrja e llogarisë bankare.

<sup>48</sup> Kontratë qiraje nr. \*\*\*, janar 2010, për dhënie me qira të një banese me sip. 60 m<sup>2</sup>, në katin e dytë të banimit qiramarrësit E.E., për periudhën 1.9.2009 – 3.1.2012; kontratë qiraje datë 1.3.2013 dhe deklaratë për zgjidhjen e kontratës me datë 4.2.2014, me qiramarrës J.A., për të cilën subjekti ka deklaruar se nuk ka marrë as 3 muaj të ardhura nga qiraja dhe për të cilat ka paguar në korrik të vitit 2019 tatimin në burim, e ardhur kjo që nuk u mor ë konsideratë nga Komisioni për shkak të pagimit të saj pas plotësimit të deklaratës “Vetting”; kontratë qiraje nr. \*\*\*, datë 1.5.2015 me qiramarrës J.A., për periudhën 1.5.2015 – 1.5.2017.

<sup>49</sup> Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 7.12.2004; kontratë shitblerjeje mes palëve, datë 20.2.2006; kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 6.6.2007; kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 20.4.2007; kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 15.1.2008; kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 28.1.2008; kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 19.10.2011; kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 7.8.2013; kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 14.10.2014.

<sup>50</sup> Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 26.6.2013.

Për huat e marra nga subjekti në formën e mjeteve monetare, Komisioni ka marrë në analizë vlerat sipas deklarimeve të subjektit, si dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion<sup>51</sup>.

Për huat e dhëna nga subjekti i rivlerësimit personave të tretë, Komisioni ka marrë në analizë vlerat sipas deklarimeve të subjektit, si dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion<sup>52</sup>.

Lidhur me shpenzimet e deklaruara, u verifikuan dhe u krahasuan përputhshmëria e deklarimeve të subjektit në deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë, në deklaratën “Vetting”, si dhe në aktet e tjera në dosjen e Komisionit.

Për analizimin e shpenzimeve u morën në konsideratë sa më poshtë:

- **Shpenzimet e jetesës** u bazuan në vlerat e deklaruara nga subjekti në deklaratat periodike për periudhën 2007 – 2016, si dhe në shpenzimet e përcaktuara në shkresën nr. \*\*\*prot., datë 4.3.2019, të ILDKPKI-së drejtuar Komisionit, për periudhën 2003 – 2006. Shpenzimet jetike janë llogaritur për familje me 5 anëtarë.

- **Shpenzimet për udhëtime jashtë shtetit** u analizuan bazuar në të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, konkretisht lëvizjet hyrje-dalje nëpërmjet sistemit *TIMS* të subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve, si dhe u krahasuan me deklaratat e subjektit, të dhëna në pyetësin nr. 1.

Llogaritja e shpenzimeve i referohet shpenzimeve të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në pyetësorë.

Nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimit kur subjekti/bashkëshortja kanë deklaruar udhëtime për qëllime pune, për të cilat kanë vendosur në dispozicion të Komisionit dokumentacion justifikues ligjor për mbulimin e këtyre shpenzimeve.

- **Shpenzimet e shkollimit** janë marrë në analizë, referuar deklaratimit të subjektit në pyetësor, vërtetimit të lëshuar nga institucioni arsimor, si dhe sipas dokumentacionit financiar të pagesave.

- **Shpenzimet e strehimit**, janë marrë në analizë vlerat referuar deklaratimit të subjektit në deklaratat periodike vjetore, pyetësorë, si dhe sipas dokumentacionit financiar të pagesave.

- **Depozita e shpenzuar** është vlera e depozitës prej 35.000 USD, e cila nga hetimi i Komisionit rezultoi si pasuri e subjektit të rivlerësimit.

- Lidhur me pasuritë e krijuara dhe kursimet e deklaruara, u verifikua dhe u krahasua përputhshmëria e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë, në deklaratën “Vetting”, si dhe në aktet e tjera në dosjen e Komisionit.

Për analizimin e kursimeve *cash* u morën në konsideratë deklaratat e kryera nga subjekti në deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë. Deklarimet e subjektit për gjendjen *cash* të akumuluar, përputhen me gjendjen e kursimeve *cash* të deklaruara nga subjekti në deklaratën “Vetting”.

---

<sup>51</sup> Kontratë e huas nr. \*\*\*, datë 25.5.2011 dhe kontratë e huas me nr. \*\*\* rep., datë 28.5.2013, me huadhënës V.P.; sipas deklaratimit të bërë nga subjekti në deklaratën periodike të vitit 2013 për shumën 4.900 GBP, paguar nga z. S.N.

Në analizë janë marrë në konsideratë gjendja e likuiditeteve në bankë, në fillim dhe në fund të vitit të analizuar, bazuar në të dhënat e pasqyrave të lëvizjeve bankare.

Likuiditetet (*cash*, bankë) janë regjistruar në një nënkategori të pasurisë “kursime (pakësim/shtesa likuiditeti)”. Në këtë kategori është pasqyruar ndryshimi i zërit likuiditete, pra, shtesa ose pakësimi i ndodhur gjatë vitit përkatës në likuiditete, sipas dokumentacionit bankar dhe deklarimeve periodike.

Lidhur me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme<sup>53</sup> të krijuara për periudhën 2003 – 2016, janë marrë në konsideratë vlerat e tyre, referuar kontratave të shitblerjes. Nga analiza e deklaratave të interesave pasurore private/vjetore dhe deklaratës “Vetting” për periudhën e hetimit 2003 – 2016, të kryer nga Komisioni, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, kanë pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme për periudhën 2003 – 2016, në shumën **3.986.945 lekë**.

**Komisioni, me dërgimin e rezultateve të hetimit, i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar me dokumentacion provues ligjor burimin e ligjshëm të të ardhurave për mbulimin e shpenzimeve, krijimin e kursimeve dhe të pasurisë së deklaruar prej tij dhe personit të lidhur me të, për periudhën 2003 – 2016.**

Pas kalimit të barrës së provës subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar rezultatet e analizës financiare të kryer nga Komisioni, duke shpjeguar dhe argumentuar se:

- Shpenzimet jetike të deklaruara nga subjekti kanë marrë parasysh edhe shpenzimet e udhëtimit dhe çdo shpenzim tjetër të kryer.
- Likuiditetet në fund të vitit 2010 paraqiten në total në vlerën 4.300.054 lekë dhe i referohen kursimeve *cash* në shtëpi dhe likuiditeteve në llogaritë bankare.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me shpenzimet jetike të deklaruar prej tij, vlerësoi se ato nuk janë bindëse, pasi subjekti ka cilësuar në deklaratat periodike se i referohet shpenzimeve të ushqimit dhe shkollimit (pa përfshirë shkollën e djalit në Angli), si dhe nuk ka deklaruar si pjesë përbërëse të tyre shpenzimet e udhëtimit vit pas viti, duke mos i marrë në konsideratë këto pretendime në analizën financiare.

Komisioni vlerësoi se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me kursimet e akumuluar deri në fund të vitit 2010, janë të plota dhe bindëse, duke e marrë në konsideratë pretendimin e tij në analizën financiare.

Pretendimet e subjektit në lidhje me analizën financiare për vitet 2005 dhe 2013 janë analizuar dhe vlerësuar përkatësisht në faqen 12-13 dhe 40-41 të këtij vendimi.

---

<sup>53</sup> Kontratë privatizimi datë 20.12.1993; kontratë privatizimi datë 6.11.1997; kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 7.6.1999; kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 11.11.1997; kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 27.6.1998; kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 27.9.2005; kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 9.2.2006; kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 12.8.2011; kontratë sipërmarrjeje nr. \*\*\*, datë 24.2.2011.

**Në përfundim, nga analiza financiare e rishikuar për periudhën 2003 – 2016, pas vlerësimeve që iu bënë nga trupi gjykues shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit si më sipër, rezultoi se subjekti dhe personi i lidhur me të kanë mungesë burimesh të ligjshme financiare në shumën -2.271.477 lekë, si më poshtë vijon:**

Përshkrimi	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
<b>Të ardhurat</b>	<b>1,733,572</b>	<b>2,217,489</b>	<b>2,794,096</b>	<b>5,637,746</b>	<b>2,646,904</b>	<b>2,677,132</b>	<b>2,587,115</b>	<b>2,996,952</b>	<b>3,045,081</b>	<b>2,855,798</b>	<b>8,715,496</b>	<b>2,802,967</b>	<b>2,883,907</b>	<b>3,491,368</b>
Të ardhura nga paga e subjektit	1,051,860	1,559,017	1,510,634	1,662,253	1,633,731	1,503,610	1,761,601	1,910,357	1,958,323	1,912,952	1,896,890	1,811,152	1,813,379	1,868,751
Të ardhura nga paga b/shortes	564,568	653,288	783,182	574,344	813,173	673,522	764,314	902,995	888,158	903,846	907,553	938,584	938,584	942,694
Të ardhura nga paga e vajzës														57,624
Të ardhura nga qiraja e apartamentit							61,200	183,600	183,600				115,600	173,400
Të ardhura nga investimi											3,703	41,231	13,344	448,899
Të ardhura nga bursa Xh.P.									15,000	39,000		12,000	3,000	
Të ardhura nga interesat	117,144	5,184	12,230	1,149										
Të ardhura nga shitja e makinës			400,000		200,000	500,000					1,000,000			
Të ardhura nga shitja e apartamentit në Golem				3,400,000										
Të ardhura nga anulimi i kontratës											4,907,350			
Të ardhura nga kursi i këmbimit			88,050											
<b>Detyrime</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>825,111</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
Hua A.G.														
Hua V. P.														
Hua N.V.														
Hua S.N.											825,111			
<b>Shpenzime</b>	<b>469,820</b>	<b>4,485,620</b>	<b>682,579</b>	<b>652,933</b>	<b>1,131,571</b>	<b>1,082,965</b>	<b>1,404,351</b>	<b>1,800,246</b>	<b>1,774,299</b>	<b>1,610,379</b>	<b>3,975,157</b>	<b>4,157,826</b>	<b>3,855,957</b>	<b>3,623,326</b>
Shpenzime jetese sipas deklarimit të subjektit (shpenzimet sipas ILDKPKI -së dhe diferenca mbi këtë vlerë e deklaruar nga subjekti)	469,820	469,820	547,785	547,785	1,046,934	1,067,567	1,397,492	1,500,000	1,570,000	1,500,000	1,600,000	1,500,000	1,200,000	1,700,000
Shpenzime udhëtimi			134,794	105,148	84,637	15,398	6,859	300,246	144,524	110,379	172,458	70,055	311,089	138,246
Shpenzime për shkollën në Angli + UET K. P.											1,501,649	1,512,660	247,770	244,000
Shpenzime për mirëmbajtjen e tokës bujqësore												250,000		300,000
Shpenzime për shkollën e vajzës në Bruksel													1,546,498	
Shpenzime për strehimin e vajzës në Bruksel													550,600	1,241,080
Depozitë e shpenzuar		3,804,150												
Shpenzime për legalizim									59,775					
Shpenzime për hua											701,050	825,111		
Shpenzime nga kursi i këmbimit		211,650												
<b>Pasuri</b>	<b>702,559</b>	<b>-3,140,015</b>	<b>2,340,049</b>	<b>4,752,748</b>	<b>1,294,266</b>	<b>1,482,136</b>	<b>1,027,796</b>	<b>1,271,102</b>	<b>2,007,874</b>	<b>1,477,243</b>	<b>4,856,616</b>	<b>-589,369</b>	<b>-943,469</b>	<b>73,605</b>
Likuiditete	702,559	-4,010,015	440,049	-1,557,096	794,266	982,136	1,027,796	1,085,102	-3,854,876	1,477,243	4,856,616	-1,570,139	-943,469	73,605
Shtëpi banimi 2+1 Rr. *****														
Automjet tip Benz 220 ****		500,000												
Autoveturë Opel Corsa ****		370,000												
Apartament Golem 1+1			1,900,000											
Apartament 116 m2 + 20 m2 garazh pjesë takuese 50 %				6,109,844										
Autoveturë Volkswagen vit prodhimi 1996 ****				200,000										
Automjet Benz 220 vit prodhimi 1997 ****					500,000									
Automjet KIA RIO ****						500,000								
1000 m2 pyll në fshatën " Mali i Shëngjinit"								186,000						
Banesë në Sarandë në bashkëpronësi me S. T.									4,862,750					
Automjet Benz vit prodhimi 2004									1,000,000					
Autoveturë Volkswagen vit prodhimi 2009 ****												980,770		
<b>Të ardhura + detyrime - shpenzime – pasuri</b>	<b>561,193</b>	<b>871,883</b>	<b>(228,532)</b>	<b>232,066</b>	<b>221,067</b>	<b>112,031</b>	<b>154,968</b>	<b>(74,396)</b>	<b>(737,092)</b>	<b>(231,824)</b>	<b>708,833</b>	<b>(765,490)</b>	<b>(28,580)</b>	<b>(205,563)</b>

## **Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të pasurisë**

Në përfundim të procesit të rivlerësimit për kriterin e pasurisë për subjektin e rivlerësimit, z. Gjovalin Përnoca, Komisioni vlerëson se:

- a) Subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm të pasurive të tij dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të të pikave 1,3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, germave “a” dhe “b”, të nenit 33/5, dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.
- b) Subjekti ka kryer fshehje pasurie, në kuptim të germës “c”, të nenit 33/5, të ligjit nr. 84/2016.
- c) Subjekti ka kryer deklaram të rremë në kuptim të germës “ç”, të nenit 33/5, të ligjit nr. 84/2016.
- ç) Subjekti nuk ka justifikuar me burime të ligjshme blerjen e pasurive të luajtshme apo të paluajtshme prej tij apo e personave të lidhur me të, dhënien e huave prej tij apo e personave të lidhur me të tek të tretët, aftësinë financiare të të tretëve për kthimin e huave, krijimin e likuiditeteve prej tij apo e personave të lidhur me të, si dhe mbulimin e shpenzimeve prej tij, apo e personave të lidhur me të për periudhën e rivlerësimit.
- d) Subjekti nuk paraqiti prova, si dhe nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave dhe pasurive të tij, sipas pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 31.10.2017, ka dërguar në Komision raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Gjovalin B. Përnoca, i deklasifikuar plotësisht me raportin nr. \*\*\* prot., datë 13.6.2019, ku Grupi i Punës ka konkluduar:

*Për subjektin e rivlerësimit, z. Gjovalin B. Përnoca, nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimin të organizuar.*

## **Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të figurës**

Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar prej subjektit të rivlerësimit, deklaratën për kontrollin e figurës, raportin e DSIK-së dhe informacionet nga organet ligjzbatuese, arrin në përfundimin se subjekti ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi.

Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit të ketë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, apo që të jetë i përfshirë ose i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe, si rrjedhojë, e gjen atë të përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

## **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE TË SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

Rivlerësimi profesional, sipas nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, është i bazuar në raportin nr. \*\*\* prot., datë 19.2.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të



subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Në raportin e hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, nga Grupi i Punës janë konstatuar aftësi të mira të subjektit për sa i përket:**

- ✓ *Aftësive profesionale*, ku përfshihen njohuritë ligjore dhe arsyetimi ligjor.
- ✓ *Etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale*, ku përfshihen etika në punë, integriteti dhe paanësia.
- ✓ *Aftësive personale dhe angazhimi profesional*, ku përfshihen aftësia e komunikimit, aftësia për të bashkëpunuar dhe gatishmëria për t’u angazhuar.
- ✓ *Aftësive organizative*, ku përfshihet aftësisë për të përballuar ngarkesën në punë, aftësia për të kryer procedurat gjyqësore si dhe aftësia për të administruar dosjet.

**Grupi i Punës pranë KLGJ-së**, në raportin e hartuar, në analizë të tri dokumenteve të paraqitura nga vetë subjekti, ka konstatuar se:

- në dokumentin nr. 1<sup>54</sup> nuk vërehen gabime dhe materiali është i kuptueshëm;
- në dokumentin nr. 2, vendimi nr. \*\*\*, datë 13.2.2015, i Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë dhe në dokumentin nr. 3, vendimi nr. \*\*\*, datë 10.11.2016, i Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda është konstatuar se në dispozitiv nuk shpjegohet e drejta e rekursit, sipas nenit 435 të Kodit të Procedurës Penale.

Komisioni, referuar gjetjeve të evidentuara në raportin e KLGJ-së dhe, pasi analizoi këto dokumente, i kërkoi subjektit të japë shpjegime në lidhje me to.

Subjekti, në përgjigje të tij, ka shpjeguar se: “...në lidhje me faktin se në vendimet e analizuara, është konstatuar se nuk tregohet e drejta e ankimit për llojin ‘rekurs’, dua të sqaroj se Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda... duke synuar standardizimin e strukturës së vendimeve gjyqësore, i përmbahet në mënyrë rigorozë përmbajtjes së nenit 383 të Kodit të Procedurës Penale, ku përcaktohen elementët e vendimit. ...Në ndryshim nga apeli, në rastin e rekursit neni 435 i Kodit të Procedurës Penale parashikon, në pikën 2 të tij se, ‘akti i rekursit dhe memoriet duhet të nënshkruhen, me pasojë mospranimi, nga mbrojtësi’, element ky që vlerësoj se ka nxitur ligjvënësin të mos e përcaktojë si element të domosdoshëm të vendimit, ‘shpjegimin e të drejtës së ankimit’”.

### **Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues**

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e dhëna, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të plota dhe bindëse, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale dhe konkretisht, nenet 383 dhe 435 të këtij kodi.

**Grupi i Punës pranë KLGJ-së**, në raportin e hartuar prej tij, në lidhje me analizën profesionale të pesë dosjeve të përzgjedhura sipas një sistemi rastësor dhe objektiv, ka konstatuar se:

---

<sup>54</sup> Dokumenti nr. 1 i referohet analizës vjetore për veprimtarinë gjyqësore të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë për vitin 2014, përgatitur nga gjyqtari Gjovalin Përnoca, në cilësinë e kryetarit të gjykatës, më 16.3.2015.

- Në dosjen nr. 1<sup>55</sup> është evidentuar se: mungon relacioni i kryesuesit, gjyqtarit Gjovalin Përnoca; vendimi dhe dosja janë dorëzuar pas 7 ditëve nga shpallja e vendimit, duke tejkaluar afatin 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale; në dosje nuk ka dorëshkrim të vendimit, por ka një kopje të vendimit të zbardhur e hartuar me kompjuter, nënshkruar nga tre anëtarët, sipas nenit 245 të Kodit të Procedurës Penale; si dhe në dispozitiv të vendimit nuk disponohet për shpenzimet procedurale dhe të drejtën e rekursit për palët.
- Në dosjen nr. 2<sup>56</sup> është evidentuar se: në tri seanca gjyqësore, të cilat kanë filluar me vonesë, nuk është relatuar shkaku i vonesës në procesverbal; në dosje mungon dorëshkrimi i gjyqtarit relator, por ka një vendim të zbardhur dhe të nënshkruar nga anëtarët e trupit gjykues; dispozitivi nuk përmban shpenzimet gjyqësore dhe nuk tregon të drejtën e rekursit në gjykatë të lartë.
- Në dosjen nr. 3<sup>57</sup> është evidentuar se: në tri seanca gjyqësore, të cilat kanë filluar me vonesë, nuk është relatuar shkaku i vonesës; nuk ka relacion me shkrim të relatorit, por vetëm vendimi i nënshkruar nga anëtarët e trupit gjykues; në dispozitiv nuk janë shënuar shpenzimet gjyqësore dhe nuk tregohet e drejta e ankimit; në dosje nuk ndodhet e dokumentuar kërkesa e pranimit të dorëheqjes për dy gjyqtarët A.L. dhe S.D., megjithëse nga dhënia e vendimit përfundimtar këta dy gjyqtarë nuk janë pjesë e trupit gjykues kur është dhënë vendimi. Në procesverbalet e seancave gjyqësore, kërkesa për dorëheqje dhe zëvendësimi i tyre me gjyqtarë të tjerë nuk është e pasqyruar në këto procesverbale.
- Në dosjen nr. 4<sup>58</sup> është evidentuar se: dy seanca gjyqësore, të cilat kanë filluar me vonesë, nuk është relatuar shkaku i vonesës; nuk ka relacion me shkrim të relatorit, por vetëm vendimi i nënshkruar nga anëtarët e trupit gjykues; në dispozitiv nuk janë shënuar shpenzimet gjyqësore dhe nuk tregohet e drejta e ankimit; si dhe dosja gjyqësore dhe vendimi janë dorëzuar në sekretari me 16 ditë vonesë, duke tejkaluar afatin 5-ditor të parashikuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.
- Në dosjen nr. 5<sup>59</sup> është evidentuar se: dy seanca gjyqësore, të cilat kanë filluar me vonesë, nuk është relatuar shkaku i vonesës; nuk ka relacion me shkrim të relatorit, por vetëm

<sup>55</sup> Çështja penale nr. \*\*\* regj. them., datë 27.12.2013, regjistrimi, që i përket Prokurorisë për Krime të Rënda, me objekt “caktimin e masës së sigurimit ‘arrest në burg’ ndaj të dyshuarit T. T., për veprën penale të trafikimit të personave të rritur”, të parashikuar nga neni 110/a e 25 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 3.1.2014.

<sup>56</sup> Çështja penale nr. \*\*\* regj. them., datë 19.5.2014 regjistrimi, kundër të pandehurve A. K., dhe T. P., të akuzuar për veprën penale “trafikim të lëndëve narkotike” në bashkëpunim, të mbetur në tentativë, të parashikuar nga nenet 283/a dhe 22 të Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 26.6.2014.

<sup>57</sup> Çështja penale nr. \*\*\* regj., them., datë 2.2.2015 regjistrimi, kundër të pandehurit D. O., i akuzuar për veprën penale “trafikim të lëndëve narkotike” në bashkëpunim të mbetur në tentativë, të parashikuar nga nenet 283/a/1 dhe 22 të Kodit Penal dhe kundër të pandehurit E. Z., i akuzuar për veprën penale “moskallëzim të krimit”, të parashikuar nga neni 300/1 të Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 3.3.2015.

<sup>58</sup> Çështja penale nr. \*\*\* regj. them., datë 24.11.2015 regjistrimi, me kërkues Prokuroria pranë Gjykatës për Krime të Rënda Tiranë, kundër të pandehurit B. S., i akuzuar për veprën penale “vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare e mbetur në tentativë”, të parashikuar nga neni 79/c e 22 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 13.1.2016.

<sup>59</sup> Çështja civile nr. \*\*\* regj. them., datë 10.12.2015 regjistrimi, me kërkues Prokuroria pranë Gjykatës për Krime të Rënda, me objekt sekuestrimin e pasurive të shtetasve N. K., S. G., B. G., dhe I. G. Për ekzekutimin e sekuestros të ngarkohet Zyra e Përmbartimit Durrës. Bazuar në nenet 3 – 15 të ligjit nr. 10192/2009, “Për

vendimi i nënshkruar nga anëtarët e trupit gjykues; në dispozitiv nuk janë shënuar shpenzimet gjyqësore dhe nuk tregohet e drejta e ankimit; si dhe dosja gjyqësore dhe vendimi janë dorëzuar në sekretari me 1 muaj e 5 ditë vonesë, duke tejkaluar afatin 5-ditor të parashikuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

Komisioni, referuar gjetjeve të evidentuara në raportin e KLGJ-së dhe pasi analizoi dokumentacionin e ndodhur në dosjen e aftësive profesionale të subjektit, i kërkoi shpjegimet përkatëse në lidhje me këto konstatime.

- a) Subjekti, në përgjigje të tij, ka shpjeguar se në lidhje me vonesat e fillimit të seancave, ka një shkresë të Inspektoratit të KLD-së të vitit 2016, që çmon si vonesa vonesat mbi 15 minuta.<sup>60</sup>
- b) Subjekti, në lidhje me mungesën e relatimit/relacionit në dosje, në legjislacion nuk parashikohet që ky veprim të përgatitet me shkrim.<sup>61</sup>
- c) Në lidhje me mungesën e dorëshkrimit të vendimit subjekti shpjegon se në asnjë dispozitë të Kodit të Procedurës Penale nuk gjendet termi dorëshkrim i vendimit. Vendimet janë të nënshkruar rregullisht nga gjithë anëtarët e trupit gjykues.<sup>62</sup>
- d) Për sa i përket gjetjes që në vendim nuk disponohen shpenzimet gjyqësore, subjekti shpjegon se i është përmbajtur kërkesave të nenit 383 të Kodit të Procedurës Penale, i cili përcakton elementët e vendimit.<sup>63</sup>
- e) Për sa i përket mospërfshirjes së të drejtës së ankimit në dispozitivin e vendimit, subjekti ka shpjeguar se dhe kjo ka lidhje me elementët e vendimit, në ligj nuk është e përcaktuar domosdoshmërisht e drejta e rekursit.<sup>64</sup>

---

parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 21.1.2016.

<sup>60</sup> Shpjegimet e subjektit për sa i përket vonesave të fillimit të seancave: “...Ju sqaroj se në orën e caktuar për zhvillimin e gjykimit, trupi gjykues (në çdo rast edhe si kryesues) është në dhomë të këshillimit, duke pritur sekretarinë gjyqësore që fton palët/subjektet procedural...Sjell në vëmendjen Tuaj, se Inspektorati i ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ka përfshirë në informacionin periodik edhe problematikat në lidhje me seancat e filluara me vonesë. Pikërisht, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 24.5.2016, Inspektorati ka çmuar se konsiderohen vonesa në fillimin e seancave gjyqësore, vonesat mbi 15 minuta..”

<sup>61</sup> Kodi i Procedurës Penale, neni 426, i tij përcakton veprimet që kryen kryetari i kolegjit të gjykatës së apelit, veprime këto të lidhura me urdhërimi për thirrjen e palëve në proces dhe afatin e arsyeshëm të paraqitjes së tyre...është shtuar një dispozitë e re, neni 426/a, që rregullon shqyrtimin gjyqësor në apel. Por, edhe kjo dispozitë, ndonëse parashikon hapat procedural që ndërmerren gjatë gjykimit në apel, nuk kërkon që ‘relatimi i përmbledhur i dosjes gjyqësore’, të kryhet me një akt të shkruar ‘relacion’ e për më tepër, të përfshihet në aktet e fashikullit të gjykimit. Ky term ‘relatim/relacion’ referohet edhe në ligjin procedural civil, kur parashikon termin ‘relacion’, por nuk kërkon që ky veprim të përgatitet me shkrim, përveç në rastet kur çështje shqyrtohet në apel, në dhomë këshillimi (nenet 464 dhe 465/a të Kodit të Procedurës Civile).

<sup>62</sup> ..Në lidhje me gjetjen për mungesën e dorëshkrimit të vendimit... nuk kemi gjetur në asnjë dispozitë të Kodit të Procedurës Penale, termin ‘dorëshkrim i vendimit’. Vendimet janë nënshkruar rregullisht nga anëtarët e trupit gjykues, konform me kërkesat e nenit 383 të Kodit të Procedurës Penale, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit. Pra, dispozitat procedurale penale referojnë tek vendime të nënshkruara rregullisht, por nuk ka ndonjë term që lidhet me ekzistencën e ‘dorëshkrim të vendimit’.

<sup>63</sup> ..Në lidhje me gjetjen e evidentuar se në dispozitiv nuk disponohet për shpenzimet procedurale, qëndron i njëjti shpjegim si më lart – i jam përmbajtur kërkesave të nenit 383 të Kodit të Procedurës Penale, për elementët e vendimit..

<sup>64</sup> Edhe në këtë rast, me lejoni të theksoj se Kodi i Procedurës Penale në lidhje me elementet e vendimit ndryshon nga Kodi i Procedurës Civile, ku pjesë e dispozitivit/pjesës urdhëruese është edhe e drejta për ankim, neni 310 i Kodit të Procedurës Civile. Në ndryshim nga apeli, në rastin e rekursit neni 435 i Kodit të Procedurës Penale parashikon, në pikën 2 të tij se, ‘akti i rekursit dhe memoriet duhet të nënshkruhen, me pasojë mospranimi, nga

- f) Përsa i përket konstatimit se vendimet nuk janë arsyetuar brenda afatit 5 ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale, subjekti shpjegon se i ka dhënë përparësi cilësisë së argumentimit ligjor, dhe se tashmë neni 431/1 ka përcaktuar afatet procedurale të dorëzimit të vendimit të arsyetuar.<sup>65</sup>
- g) Në lidhje me mosdokumentimin e pranimin të kërkesës për dorëheqje të dy gjyqtarëve, subjekti shpjegon se edhe pse nuk ndodhet e dokumentuar, në dhënien e vendimit përfundimtar këta dy gjyqtarë nuk janë pjesë e trupës. Mospasqyrimi i dokumentimit të dorëheqjes në procesverbale i është dhënë vëmendje më tepër shpalljes së përbërjes së trupit gjykues.<sup>66</sup>

### Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, arrin në përfundimin se:

- a) Subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme për sa i përket “vonesave në çeljen e seancave jo sipas orarit standard të përcaktuar”. Subjekti e argumentoi këtë fakt duke paraqitur dhe një shkresë të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ku njoftonte gjykatat se për shkak të veprimeve teknike procedurale u njihte si vonesa në fillimin e seancave gjyqësore gjyqtarëve rreth 15 minuta vonesa.
- b) Për sa i përket mungesës së relacionit në dosje, si dhe dorëshkrimit të gjyqtarit, subjekti ka dhënë shpjegime të plota dhe të mjaftueshme konform dispozitave të Kodit të Procedurës Penale dhe konkretisht neneve 425 dhe 426 të këtij Kodi. Komisioni vlerëson se me gjithë mungesën e një dorëshkrimi (në fakt është vendim i shtypur në kompjuter me një shkrim të llojit “dorëshkrim”), në dosjen gjyqësore ndodhet vendimi i zbardhur dhe i arsyetuar dhe i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues, gjë për të cilën subjekti ka qenë korrekt për sa i përket aspektit procedural.
- c) Në lidhje me shpenzimet gjyqësore dhe të drejtës së ankimit (rekursit), të cilat nuk janë shënuar nga subjekti i rivlerësimit në vendimet e sipërcituara, Komisioni vlerëson se me gjithë

---

*mbrojtësi’, element ky që vlerësoj se ka nxitur ligjvënësin të mos e përcaktojë si element të domosdoshëm të vendimit, ‘shpjegimin e të drejtës së ankimit’.*

<sup>65</sup> Në lidhje me konstatimin Tuaj se ‘vendimet nuk janë arsyetuar brenda afatit 5 ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale’, dua të theksoj se jam përpjekur gjithmonë t’i jap përparësi cilësisë së argumentimit ligjor. Në çdo rast, pavarësisht kompleksitetit të çështjes, jam përpjekur të respektoj afatin e ankimit/rekursit, duke pasur në konsideratë ushtrimin efektiv të së drejtës së ankimit nga subjektet procedurale. Së fundmi, dua të theksoj edhe faktin se ligjvënësi, ka ndryshuar ligjin procedural penal, ku është shtuar neni 430/1 të Kodit të Procedurës Penale ‘shpallja dhe depozitimi i vendimit’, ka përcaktuar tashmë afatet procedurale brenda të cilave duhet dorëzuar arsyetimi i vendimit.

<sup>66</sup> Në dosje nuk ndodhet e dokumentuar kërkesa e pranimin të dorëheqjes për dy gjyqtarët A. L. dhe S. D., megjithëse nga dhënia e vendimit përfundimtar këta dy gjyqtarë nuk janë pjesë e trupës kur është dhënë vendimi. Në procesverbalet e seancave gjyqësore, kërkesa për dorëheqje dhe zëvendësimi i tyre me gjyqtarë të tjerë nuk është pasqyruar në këto procesverbale.

Në lidhje me këtë konstatim, Ju sqaroj se i kam kushtuar gjithmonë vëmendje maksimale shpalljes së përbërjes së trupit gjykues, duke ftuar palët të parashtrojnë kundërshtitë në rast se kanë. Në rastin konkret, pasi u konsultova me procesverbalin e seancës gjyqësore, rezultoi se trupi gjykues është shpallur si në momentin e verifikimit të shuarjes së masës së sigurimit arrest në burg, ashtu edhe në momentin e shqyrtimit të çështjes në themel. E gjithë procedura ka qenë transparente, e nga ana e subjekteve procedurale të pranishme nuk janë parashtruar kundërshtime në lidhje me përbërjen e trupit gjykues, ku është evidentuar edhe prania e anëtarit të ri të këtij trupi gjykues.

se subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme konform neneve 383 dhe 435 të Kodit të Procedurës Penale, pasi nuk janë pjesë e elementëve të vendimit dhe nuk e bëjnë vendimin e cenueshëm në aspektin procedural.

d) Në lidhje me depozitimimin e vendimit jashtë afatit procedural sipas parashikimeve të nenit 113 të Kodit të Procedurës Penale, Komisioni vlerëson se nuk gjendet i bazuar pretendimi i subjektit se vonesa në dorëzimin e dosjes dhe të vendimit të arsyetuar ka ardhur si pasojë e cilësisë në arsyetim të vendimit. Subjekti nuk ka respektuar afatet procedurale të përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale. Po kështu, i pabazë është dhe pretendimi i subjektit se neni 430/1 i Kodit të Procedurës Penale i jep relatorit të çështjes një afat më të gjerë se ai 5 ditor, një afat 30 ditor, apo dhe duke e tejkaluar atë në raste përjashtimore për vendimin e shpallur të përmbledhur dhe të arsyetuar, pasi neni 430/1 është shtuar në Kodin e Procedurës Penale, me ndryshimet e reja shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017, ndërkohë që vendimet e subjektit për të cilat janë bërë gjetjet janë të viteve 2013 dhe 2015.

e) Në lidhje me mungesën e dokumentimit të kërkesës së pranimit të dorëheqjes së dy gjyqtarëve të çështjes, konstatohet se ka mangësi procedurale, pasi kërkesa për dorëheqje është një veprim procedural i cili konkretizohet nga një vendimmarrje e gjyqtarit që pranon ose jo dorëheqjen (në rastin konkret subjekti), sipas parashikimeve të nenit 17 të Kodit të Procedurës Penale. Po kështu, veprimet për dorëheqjen e dy gjyqtarëve duhet të ishin pasqyruar në procesverbalet e seancave përkatëse, gjë e cila nuk rezulton si veprim i kryer nga subjekti i rivlerësimit.

#### **TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLD-së**

- ✓ Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtarin Gjovalin Përnoca *nuk rezulton asnjë ankesë në Inspektoratin e KLD-së.*
- ✓ Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Gjovalin Përnoca përgjatë periudhës së rivlerësimit *nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.*

#### **TË DHËNA NGA PROKURORIA E PËRGJITHSHME**

- **Drejtoria Gjyqësore pranë Prokurorisë së Përgjithshme**, në përgjigje të saj<sup>67</sup>, ka bashkëngjitur informacionin e përcjellë nga Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria e Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore.
- **Spektori i protokollit dhe arkivit pranë Prokurorisë së Përgjithshme**, në përgjigje të tij<sup>68</sup>, ka konfirmuar se nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e kallëzimeve dhe procedimeve penale të Prokurorisë së Përgjithshme, nuk ka çështje penale apo kallëzim penal të filluar ndaj shtetasit Gjovalin Përnoca.
- **Drejtoria e Përgjimit të Komunikimeve Elektronike dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informative**, në përgjigje të saj<sup>69</sup>, ka konfirmuar se nuk ka ardhur informacion

<sup>67</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 11.6.2019, e Drejtorisë Gjyqësore drejtuar Komisionit.

<sup>68</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 29.5.2019, drejtuar Drejtorisë Gjyqësore.

<sup>69</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 10.6.2019, drejtuar Komisionit.

nga agjencitë ligjzbatuese që të bëjë fjalë për *indicie* apo cenim të figurës së subjektit Gjovalin Përnoca.

- **Prokuroritë e rretheve**, në përgjigje të tyre<sup>70</sup>, kanë konfirmuar se pranë tyre nuk rezultoi që subjekti Gjovalin Përnoca të ketë qenë person nën hetim, i pandehur apo i dyshuar në procedime apo kallëzime penale të hetuara.

## DENONCIMET NGA PUBLIKU

Ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Gjovalin Përnoca, janë depozituar katër denoncime nga publiku.

- 1. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 12.2.2018, i shtetasit B.K.**, i cili ankohet ndaj subjekteve B. N., A. B., Dh. H., S. D., S. B., N. D., D. Sh., dhe subjektit Gjovalin Përnoca. Në denoncimin e tij ai shkruan: *“I denoncoj të gjithë këta gjyqtarë për shkelje ligjore, pasi nuk përgjigjen kallëzimit penal të bërë nga prokurori i përgjithshëm nën kompetencat e presidentit ku kemi kërkuar zbardhjen e vendimit \*\*\*, nëse ky vendim është dhënë në zbatim të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale dhe atëherë të kaloj në ndjekje penale unë me djalin dhe nëse ndodh e kundërta të ndiqen penalisht të gjithë personat përgjegjës”*.

Denoncuesi nuk i ka bashkëngjitur asnjë dokumentacion mbështetës denoncimit të bërë.

### Vlerësimi i denoncimit nga Komisioni

Komisioni, pasi analizoi materialin e vënë në dispozicion nga denoncuesi, vëren se nuk identifikon qartë problematikën e tij.

Komisioni konstaton se nuk ka *indicie* apo prova konkrete të dhëna nga denoncuesi për ta ngarkuar subjektin me përgjegjësi disiplinore.

- 2. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 3.8.2018, i shtetasit M.H.**, i cili ngre ankesa ndaj 10 subjekteve, përfshirë dhe subjektin Gjovalin Përnoca.

Denoncuesi është përfaqësuesi i një agjencie investigative “\*\*\*\*”, i cili këtë ankesë e ngre në emër të shtetasës B. L., e cila është paraqitur pranë kësaj agjencie për të analizuar çështjen e bashkëshortit të saj SH. L., dhe të një personi tjetër R. K., që akuzohen për vrasje të mbetur në tentativë. Në denoncim ai i referohet një situatë ku avokati mbrojtës i SH. L., dhe R. K., u kishte thënë familjarëve të tyre se që të merrnin pafajësinë kishte folur me gjykatësit dhe se ata duhet të paguanin shumën 60.000 euro, nga 30.000 euro secili. Shtetasja B. L., nxori shtëpinë në shitje dhe vetëm prej këmbënguljes së agjencisë nuk u konsumua veprimi korruptiv. Pasojat ishin se në gjykimin në shkallë të parë tek Gjykata e Krimeve të Rënda, ku prokuroria kërkoi 35 vjet për secilin të pandehur, trupa gjykuese dha dënimin 10 vjet për shtetasin SH. L., dhe 25 vjet burgim për shtetasin R. K., dhe me vendimin e datës 20.4.2016, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda u vendos 10 vjet burg për shtetasin SH. L., dhe 20 vjet burgim për shtetasin R. K. Denoncuesi shkruan se *u ndëshkuam dhe në apel se nuk iu përgjigjëm kërkesës së avokatit*.

---

<sup>70</sup> Shkresat e dërguara nga prokuroritë e rretheve.

Si përfundim, denoncuesi shkruan në denoncimin e tij se kemi të bëjmë me shtrëngim për dhënie pasurie, se ndryshe, sipas tij, si shpjegohen vendimet e gjykatave në një çështje ku të gjitha provat të bëjnë të kuptosh që kemi të bëjmë me ngjarje të simuluar.

Denoncuesi i ka bashkëngjitur disa dokumente denoncimit të tij<sup>71</sup>, që kryesisht i referohet veprimeve të bëra nga prokuroria.

Nga denoncimi kuptohet se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka kërkuar për të dy të pandehurit për veprën penale “vrasje e punonjësit të policisë”, e mbetur në tentativë, dënimin e tyre me 35 vjet burg për secilin.

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda i ka dënuar të pandehurit me 10 vjet burg SH. L., dhe 25 vite burg R. K. Ndërsa, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ka lënë në fuqi vendimin me 10 vjet burg për SH. L., dhe ndryshuar në 20 vjet burg për R. K.

Nga vendimet gjyqësore kuptohet se gjykatat kanë caktuar një masë dënimi tjetër më të butë nga ai maksimal që ka kërkuar prokuroria, duke krijuar kështu bindjen se nuk ka aspak lidhje, dhe për më tepër as nuk provohet pretendimi i denoncuesit se shtetases B. Sh., i janë kërkuar shuma në euro nga gjyqtarët nëpërmjet avokatit mbrojtës. Denoncuesi nuk ka përmendur ankesë konkrete për subjektin e rivlerësimit.

Denoncuesi nuk ka paraqitur asnjë provë që të provojë se nga trupat gjyqësore janë kërkuar shuma parash në euro, por kjo mbetet vetëm në kuadër deklarativ të bërë nga bashkëshortja e njërit prej të dënuarve.

### **Vlerësimi i denoncimit nga Komisioni**

Komisioni, pasi analizoi materialin e vënë të dërguar nga denoncuesi, vëren se ai nuk identifikon qartë problematikën e tij, për sa i përket subjektit të rivlerësimit dhe roli i tij në këtë çështje, përveçse subjekti mund të ketë qenë pjesë e trupës gjyqësore në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda që ka marrë vendimin.

Gjithashtu, denoncuesi nuk paraqiti asnjë provë që të vërtetojë që nga trupat gjyqësore (e të dy shkallëve të gjykimit dhe nga prokuroria) apo nga vetë subjekti i rivlerësimit, personalisht, të jenë kërkuar shuma në euro nëpërmjet avokatit mbrojtës, për marrjen e një vendimi pafajësie në favor të të pandehurve.

Komisioni konstaton se nuk ka *indicie* apo prova konkrete të dhëna nga denoncuesi për ta ngarkuar subjektin me përgjegjësi disiplinore.

3. **Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 13.7.2018, i shtetasit N.D.,** i cili, ndër të tjera, denoncon edhe trupën gjyqësore të Gjykatës së Apelit Korçë, të drejtuar nga subjekti Gjovalin Përnoça për gjykim jo të drejtë, të njëanshëm, duke pretenduar në denoncim se: “..*kërkova*

---

<sup>71</sup>(a) Informacion për shkeljet e bëra nga prokurori i çështjes B. H., duke e akuzuar se i ka mbajtur dy të dënuarit në arrest me burg pa prova, si dhe ka fabrikuar provat; (b) procesverbal të prokurorisë për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale; (c) vendim nga prokurori mbi kërkesën e mbrojtësit të të hetuarit Sh. L.; (ç) memorie e avokatit B. M., drejtuar Prokurorisë së Krimeve të Rënda, prokurorit B. D.; (d) përgjigje e Prokurorisë Krimeve të Rënda drejtuar agjencisë “\*\*\*”; (e) oponencë e një aktekspertimi; (f) procesverbal i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

*ballafaqim të dy akteve noteriale dhe nuk u pranuan sepse këtu më tepër se korrupsion nuk ka sesi shpjegohet ndryshe.”*

Denoncuesi ka bashkëngjitur vendimet e gjykatave, ku ai ka qenë palë në gjykim me cilësinë e të paditurit.

Gjykata e Shkallës së Parë Korçë, me vendimin datë 7.9.2016 në çështjen me paditës I. D., dhe të paditur N.D., me objekt “a) konstatimin e pavlefshmërisë absolute të deklaratës së heqjes dorë nga pronësia e O. D., në favor të N.D., me nr. \*\*\*, datë 26.3.2000, për pasurinë \*\*\*; b) njohje si trashëgimtar i O. D., në raportin \*\*\* me paditësin dhe \*\*\* për të paditurin”, ka vendosur: *Rrëzimin e padisë së paditësit I. D., për sa i përket njohjes si trashëgimtar i O. D., dhe pranimin e padisë, për sa i përket konstatimit të pavlefshmërisë absolute të deklaratës së heqjes dorë nga pronësia të O. D., në favor të N.D.*

Ndaj këtij vendimi paditësi I. D., ka bërë ankim në Gjykatën e Apelit Korçë.

Gjykata e Apelit Korçë, ku subjekti Gjovalin Përnoca ka qenë kryesues i trupës gjyqësore, me vendimin e datës 22.9.2017, ka vendosur ndryshimin e vendimit të datës 7.9.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, “konstatimin absolutisht të pavlefshëm të veprimit juridik akt heqje dorë nga pronësia” dhe zgjidhjen e pasojave juridike, duke anuluar çdo veprim juridik të kryer në bazë të këtij akti dhe duke përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë të shtetasve O. D., I. D., me \*\*\* pjesë, dhe shtetasit N.D. me \*\*\* pjesë etj. Nga dokumentacioni i depozituar nga denoncuesi nuk konstatohet që ndaj këtij vendimi të jetë bërë rekurs në Gjykatën e Lartë.

Komisioni vëren se nga verifikimi në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë [www.gjykataelartë.gov.al](http://www.gjykataelartë.gov.al) rezulton që në datën 24.4.2018 është regjistruar për t’u gjykuar çështja me paditës I. D., dhe të paditur N.D., me objekt “konstatimin e pavlefshmërisë së deklaratës së heqjes dorë nga pronësia e O. D., në favor të N.D. me nr. \*\*\* kol, datë 26.3.2000, për pasurinë nr. \*\*\*”. Njohje si trashëgimtare të O. D në raportin \*\*\* për paditësin dhe \*\*\* për të paditurin.

Denoncuesi nuk identifikon qartë se çfarë shkelje është bërë nga subjekti dhe trupa përbërëse e tij në lidhje me çështjen që ai pretendon. Nisur nga vendimet gjyqësore, duket se subjekti nuk ka qenë dakord me përfundimin e çështjes, pra, nuk ka qenë dakord me vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit Korçë, ndryshe nga vendimmarrja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Denoncuesi nuk ka depozituar prova apo të japë *indicie* provuese se vendimmarrja nga Gjykata e Apelit Korçë, ku subjekti ka qenë pjesë e trupës gjyqësore, është vendimmarrje korruptive.

### **Vlerësimi i denoncimit nga Komisioni**

Komisioni, pasi analizoi materialin e dërguar nga denoncuesi, vëren se denoncuesi nuk identifikon qartë shkeljen që i është bërë nga Gjykata e Apelit Korçë. Referuar dy vendimeve të gjykatave në të dy shkallët e gjykimit, problematika e tij lidhet me vendimmarrjen e cila pasqyrohet me vendime gjyqësore (në rastin konkret mbetet shqyrtimi në Gjykatën e Lartë që rezulton të jete bërë rekurs) dhe të dy gjykatat kanë dhënë vendimet e tyre që duket se kanë prekur interesin e denoncuesit.



Në lidhje me pretendimin e denoncuesit për sa i përket vendimmarrjes së trupës gjyqesore, ku subjekti ka qenë anëtar Komisioni, mban në konsideratë nenin 72, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”<sup>72</sup>, duke mos pasur kompetencë ligjore për të gjykuar mbi korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin me logjikën e gjyqtarit që vlerësohet.

Nga hetimi nuk rezultuan *indicie* apo prova për të ngarkuar subjektin e rivlerësimit me përgjegjësi disiplinore.

**4. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 15.3.2019, i shtetasve R.P. dhe S.P., ndaj subjekteve E. T., I. M., dhe subjektit Gjovalin Përnoça.**

Denoncuesja shpjegon se me vendimin datë 19.7.1996, ish-Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve (KKKP) Korçë, ka vendosur kthimin si të lirë të truallit me sip. 4.390 m<sup>2</sup> në emër të trashëgimtarëve të N. R., në Çiflik të Korçës. Në vitin 1997 bashkëshorti i denoncueses, së bashku me një shtetas tjetër, i janë drejtuar gjykatës për anulimin e vendimit të mësipërm të KKKP-së Korçë. Shtetasi S.P. ka ndërtuar në vitin 1995 shtëpinë me leje ndërtimi nga Këshilli i Rrethit Korçë në truall me sip. 540 m<sup>2</sup> mbi sipërfaqen 4.390 m<sup>2</sup>.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 14.10.1997, ka vendosur rrëzimin e padisë, ndërkohë Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 10.4.1998, ka prishur vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke njohur pronësinë mbi sipërfaqen prej 540 m<sup>2</sup> secilit prej paditësve dhe kompensimin e ish-pronarëve.

Gjykata e Lartë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 18.2.1999, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Në vitin 2006 trashëgimtarët e ish-pronarit N. R. kanë kërkuar në gjykatë nga shtetasi S.P. “lirim dhe dorëzim truallit me sip. 540 m<sup>2</sup>”.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 19.2.2007, ka vendosur: *Pranimin e padisë së paditësit N. R. dhe lirimin dhe dorëzimin e truallit 540 m<sup>2</sup> nga S.P., si i zënë padrejtësisht, duke urdhëruar Zyrën e Përmbartimit të kryejë ekzekutimin e vendimit.*

Kjo çështje është pezulluar me vendim të ndërmjetëm të datës 8.5.2007, deri në zgjidhjen e kërkesës së shtetasit S.P. për legalizim të ndërtimit pranë Zyrës së ALUIZNI-t Korçë.

Me VKM-në nr. \*\*\*, datë 7.7.2010, është vendosur miratimi i kalimit të parcelës ndërtimore në favor të zotëruesve infomalë.

Me vendimin nr. \*\*\*, datë 20.6.2011, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur: *Pranimin e padisë dhe konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitjes datë 14.10.2010, të parcelës ndërtimore të lidhur midis S.P. dhe ALUIZNI-t.*

Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 11.5.2012, vendosi prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pushimin e çështjes.

---

<sup>72</sup> Neni 72/4, i ligjit nr. 96/2016, “Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin me logjikën e gjyqtarit që vlerësohet.”

Për këtë shkak çështja u rikthye nga pezullimi dhe Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.1.2013, ka vendosur: *Ndryshimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 19.2.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, duke vendosur rrëzimin e padisë së N. R. ndaj të paditurit S.P., si të pa bazuar në ligj.*

Ndaj këtij vendimi ka paraqitur rekurs N. R. në Gjykatën e Lartë, e cila, me vendimin nr. \*\*\*, datë 19.5.2016, ka vendosur: *Prishjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 28.1.2013, të Gjykatës së Apelit Korçë dhe dërgimin e çështjes në po atë gjykatë me trup tjetër gjykues.*

Në arsyetimin e saj, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se ankimi i paraqitur nga paditësi N. R. përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile, që motivojnë cenimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 28.1.2013, të Gjykatës së Apelit Korçë, e cila ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 19.2.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Gjykata e Lartë çmon se vendimi i Gjykatës së Apelit është marrë në shkelje të dispozitave procedurale në lidhje me përbërjen e trupit gjykues, i cili ka realizuar edhe vendimmarrjen në atë shkallë të gjykimit, duke mos garantuar kështu moscenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim për të garantuar një proces të rregullt gjyqësor, pasi në dy seanca nga përfaqësuesi i paditësit N. R. është kërkuar përjashtimi i dy anëtarëve të trupit gjykues, me pretendimin se kanë dhënë mendim për çështjen, duke disponuar me vendimin nr. \*\*\*, datë 1.7.2004, të Gjykatës së Apelit Korçë.

Po kështu, Gjykata e Lartë vlerëson se pezullimi i gjykimit të çështjes objekt rekursi nga Gjykata e Apelit nuk është bërë në respektim të nenit të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 26 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimet...", pasi pezullimi është bërë me qëllim përfundimin e procedurës së legalizimit, ndërkohë që ligji parashikon që nëse ka konflikt gjyqësor për pronësinë është procedura e legalizimit ajo që pezullohet dhe jo anasjelltas.

Gjykata e Lartë përfundon arsyetimin se në rishqyrtim Gjykata e Apelit duhet të përsërisë pjesërisht hetimin gjyqësor që ka të bëjë me identifikimin e përfundimit të procesit të legalizimit nga pala e paditur, si dhe përfundimin e shqyrtimit të konfliktit administrativ mes palëve ndërgjyqëse, me objekt kontestimin e procesit të legalizimit dhe në përputhje me kërkesat e ligjit procedural të materialit dhe pas kryerjes së hetimit të plotë dhe të gjithanshëm, në interpretim të duhur të dispozitave ligjore dhe normave të tjera, të arrijë në përfundime të drejta dhe objektive për zgjidhjen e konfliktit.

Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 12.12.2017, ka vendosur: *Lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 19.2.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.* Ky vendim është dhënë nga gjyqtarët E. T., I. M., dhe subjekti i rivlerësimit, z. Gjovalin Përnoca.

Denoncuesja kundërshton këtë vendimmarrje të Gjykatës së Apelit Korçë, pasi gjykata nuk duhet të kishte lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, me arsyetimin se me VKM-në e vitit 2010 ishte kaluar trullit në pronësi të bashkëshortit të saj, S.P., si dhe kontratës së kalimit të trullit në pronësi të tij. Sipas denoncueses, gjykata ka dhënë këtë vendim në shkelje flagrante me ligjin.

Komisioni verën se ankesa që ngre denoncuesja ka të bëjë me vendimmarrjen dhe jo me shkelje procedure nga Gjykata e Apelit Korçë. Vendimi i dhënë nga Gjykata e Apelit

Korçë, ku subjekti ka qenë pjesë e trupës gjyqësore, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, të dhënë në vitin 2007 në disfavor të denoncuceses.

Gjithashtu, edhe Gjykata e Lartë, në vendimin datë 19.5.2016, i ka dhënë të drejtë pretendimeve të ngritura në rekurs të shtetasit N. R., kundërshtar i z. S.P.

Bazuar në këtë vendim të gjykatës, procedurat e legalizimit nuk duhej të vijonin nga Zyra e ALUIZNI-t Korçë, për sa kohë që gjatë këtij procesi administrativ ishte dhe një proces gjyqësor që po zhvillohej.

Pra, ankesa e denoncuceses ka të bëjë me vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit Korçë, ku anëtar i trupit gjykues ka qenë edhe subjekti i rivlerësimit.

Ndërkohë, denoncuesja vijon procesin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë për pezullimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Korçë, për të shmangur ekzekutimin e vendimit.

### **Vlerësimi i denoncimit nga Komisioni**

Komisioni, pasi analizoi materialin e depozituar nga denoncuesja, vëren se problematika e prezantuar është e natyrës gjyqësore, ku çështja e saj është gjykuar nga dy herë në të tria shkallët e gjyqësorit, ku pjesë e trupit gjykues në vendimin nr. \*\*\*, datë 12.12.2017, të Gjykatës së Apelit Korçë, është edhe subjekti i rivlerësimit.

Nga ankesa e denoncuceses kuptohet se ajo nuk është dakord me përfundimin e gjykimit.

Në lidhje me pretendimin e denoncuesit për sa i përket vendimmarrjes së trupës gjyqësore ku subjekti ka qenë anëtar trupe, Komisioni mban në konsideratë nenin 72, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”<sup>73</sup>, duke mos pasur kompetencë ligjore për të gjykuar mbi korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin me logjikën e gjyqtarit që vlerësohet.

Nga analiza situatës së shpjeguar nga denoncuesja, nuk rezultuan *indicie* apo prova që të ngarkojnë subjektin me përgjegjësi disiplinore.

### **Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues**

Komisioni, pasi analizoi informacionin dhe dokumentacionin që përmbanin këto denoncime, vlerësoi se në to nuk konstatoi *indicie* apo problematika që çojnë në paaftësi profesionale të subjektit të rivlerësimit.

### **Konkluzione për rubrikën e vlerësimit profesional**

Nga vlerësimi tërësor i kriterit profesional janë konstatuar mangësi dhe problematika në aspektin procedural nga subjekti i rivlerësimit, por trupi gjykues vlerëson se ato nuk janë deri në atë masë që të plotësojnë qëllimin e nenit E të Aneksit të Kushtetutës apo pikës 4, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i

---

<sup>73</sup> Neni 72/4, i ligjit nr. 96/2016: “... Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin me logjikën e gjyqtarit që vlerësohet.”

rivlerësimit, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, arrin një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në pikën 2, të nenit 4, nenin 58, pika 1, germa “c”, si dhe në pikën 3, të nenin 61, ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti nuk ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë,

### **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Gjovalin Përnoca, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë.
2. Vendimi i arsyetuar u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 13.9.2019.

### **KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Xhensila PINE**  
**Kryesuese**

**Olsi KOMICI**  
**Relator**

**Suela ZHEGU**  
**Anëtar**

*Sekretare gjyqësore*  
*Fiorela Mandro*

## MENDIM PARALEL

Unë, komisioner Olsi Komici, në cilësinë e anëtarit/relatorit të trupit gjykues, kam votuar pro qëndrimit të mbajtur në vendimmarrjen e shumicës, në lidhje me të gjitha argumentet e arsyetuara në vendim, të cilat legjitimojnë marrjen e vendimit përfundimtar për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Gjovalin Përnoca, por jam shprehur kundër qëndrimit të shumicës së trupit gjykues, e cila e ka vlerësuar si të ligjshëm privatizimin nga subjekti i rivlerësimit të apartamentit në qytetin e Shkodrës, me arsyetimin si më poshtë:

Kjo pasuri është përfituar nga kontrata e përkohshme datë 25.9.1996, e shitjes së apartamentit, e lidhur ndërmjet Entit Kombëtar të Banesave Shkodër, në cilësinë e shitësit, dhe z. Gjovalin Përnoca, në cilësinë e blerësit, për blerjen e apartamentit 2+1 me sip. 69.20 m<sup>2</sup> në Rr. “\*\*\*”, Shkodër, duke u paguar si paradhënie shuma prej 35.000 lekësh.

Në datën 6.11.1997 është lidhur kontrata përfundimtare e shitjes së apartamentit me pagesë të menjëhershme. Vlera e apartamentit është 11.625 USD ose 1.703.062 lekë (konvertuar me kursin ditor 146.5 lekë). Pas aplikimit të zbritjes së cmimit me 30 %, për shkak të pagesës së menjëhershme, blerësi ka paguar çmimin përfundimtar 1.248.167 lekë, ose 8.603 USD, konvertuar me kursin ditor së pagesës së faturës nr. \*\*\*, datë 25.9.1996 dhe faturës nr. \*\*\*, datë 11.11.1997.

Bazuar në ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, subjekti i rivlerësimit ka përfituar një apartament në qytetin e Rrëshenit në bazë të kontratës për privatizimin e banesës datë 20.12.1993, lidhur ndërmjet Ndërmarrje Komonale Banesa Rrëshen dhe subjektit të rivlerësimit, z. Gjovalin Përnoca.

Pas kalimit të barrës së provës në lidhje me dyshime mbi ligjshmërinë e procesit të privatizimit të apartamentit në qytetin e Shkodrës, subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumente për të mbështetur shpjegimet e tij (shihni shpjegimet e subjektit në faqet 32, 33 të vendimit).

Në kontratën e përkohshme datë 25.9.1996, për shitje apartamenti, lidhur ndërmjet degës së EKB-së Shkodër dhe subjektit, në pikën 1/e përcaktohet se: *“Blerësi detyrohet të paraqesë në degën e Entit të Banesave përpara lidhjes së kontratës këto dokumente: pika e) dokumentin i cili vërteton që qytetari nuk ka përfituar nga ligji i privatizimit të banesave shtetërore”*.

Në praktikën e depozituar në Komision nga EKB-ja nuk rezulton që të jetë depozituar një dokument i tillë nga subjekti sipas përcaktimeve të kontratës së mësipërme në pikën 1/e, madje nuk rezulton të ketë as ndonjë korrespondencë të kryer nga EKB-ja për të kryer këtë verifikim.

Subjekti nuk dokumentoi përbërjen e trungut të tij familjar në datën 1.12.1992, personat në moshë madhore të të cilit janë edhe përfitues të apartamentit në bazë të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992.

Ligji nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, në nenin 23 të tij parashikon se: *“Me zbatimin e këtij ligji, në asnjë rast qytetari nuk mund të bëhet njëkohësisht pronar i dy banesave shtetërore”*.

Në pikën 1/a të VKM-së nr. 49, datë 29.1.1993, “Për përcaktimin e kritereve për të pastrehët”, përcaktohet se: *“Të quhen të pastrehë: a) Qytetarët që nuk kanë kontratë me ndërmarrjen komunale të banesave, si: të qarkulluarit e të transferuarit, të cilët e kanë zgjidhur kontratën e qirasë.”* Për këtë arsye, subjekti nuk e gëzon statusin e të transferuarit sikurse ai ka pretenduar, për arsye se nuk rezulton që të ketë pasur një kontratë qiraje me autoritetet shtetërore që më pas ta ketë zgjidhur atë, për më tepër që ka pasur njëkohësisht një apartament tjetër në pronësi të përfutur nëpërmjet procedurave të privatizimit në një qytet tjetër.

Rezultoi që subjekti i rivlerësimit të ketë përfutur dy herë nga ligji nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, duke privatizuar fillimisht apartamentin në qytetin e Rrëshenit nga ish-Ndërmarrja Komunale Banesa, nëpërmjet kontratës së privatizimit lidhur në datën 20.12.1993 dhe gjatë kohës që e ka pasur në pronësi këtë apartament ka privatizuar edhe një apartament tjetër në qytetin e Shkodrës nëpërmjet EKB-së me kontratën e përkohshme të shitblerjes datë 25.9.1996 dhe kontratës përfundimtare datë 11.11.1997.

**Për sa më sipër, arrij në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë përfutur dy herë nga aplikimi i ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, në mënyrë jo të ligjshme, dhe për rrjedhojë në shkelje të etikës së gjyqtarit.**

**Privatizimi i apartamentit në qytetin e Shkodrës është bërë në kundërshtim me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, në një kohë kur subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kishin përfutur po me të njëjtin ligj një apartament tjetër në qytetin e Rrëshenit, të cilin e kishin ende në pronësi.**

Për këto arsye, jam shprehur kundër qëndrimit të mbajtur nga shumica e trupit gjykues për këtë pikë, qëndrim i cili nuk ka ndikuar në votën time për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, për të gjitha shkaqet e tjera të konsumuara dhe të shpallura në vendim.

**Relator**

**Olsi KOMICI**